



# NDJEKJA DHE GJYKIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK



Autorët: Gzim Shala dhe Mirvet Thaqi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Jeton Hasani dhe Albulena Nrecaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

*Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:

Dhjetor, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

## **Lista e shkurtesave**

AKK	Agjencia Kundër Korrupsion
DKR	Departamenti i Krimeve të Rënda
DPKPP	Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRPRK	Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës
LKZK	Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSh	Prokurori i Shtetit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
PTh	Prokuroria Themelore
GjTh	Gjykata Themelore

## **Përmbajtja**

1. Përmbledhje ekzekutive .....	5
2. Korniza ligjore për luftimin e korrupsionit në prokurimin publik .....	7
3. Ngarkesa e sistemit të drejtësisë me lëndë të korrupsionit në prokurim publik .....	7
4. Trajtimi i rasteve të prokurimit nga AKK.....	8
5. Profesionalizmi i sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të prokurimit .....	9
6. Bashkëpunimi i sistemit prokurorial me institucionet e tjera në luftimin e krimeve në prokurimin publik .....	12
7. Heshtja e sistemit prokurorial përballë raporteve të ZKA-së .....	14
8. Sekuestrimi dhe konfiskimi në rastet e prokurimit publik.....	15
9. Zvarritjet e gjyqimit të rasteve të prokurimit publik.....	15
10. Rekomandimet .....	17
11. Annex 1: Trajtimi i rasteve gjyqësore të korrupsionit në prokurimin publik .....	18

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Përballë potencialit të madh korruptiv në fushën e prokurimit publik, sistemi i drejtësisë ende nuk i është qasur me seriozitet parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në këtë fushë. Gjetjet e IKD dhe INPO tregojnë për një politikë jo adekuate të hetimit dhe ndjekjes penale nga Prokurori i Shtetit dhe për trajtim të ngadalshëm të këtyre rasteve nga sistemi gjyqësor.

Përgjatë vitit 2020 dhe gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2021, përkitazi me aktakuzat e Prokurorit të Shtetit janë nxjerrë gjithsej nëntë (9) vendime gjyqësore. Në gjashtë (6) prej këtyre rasteve, aktakuzat e Prokurorit të Shtetit kanë dështuar që të provohen në gjykatë.

Gjatë kësaj periudhe kohore, Prokurori i Shtetit nuk ka treguar rol proaktiv, duke mos ngritur asnjë aktakuzë me vetiniciativë. IKD gjen se përkundër faktit se në Republikën e Kosovës funksionojnë mekanizma dhe institucione të shumta për të iniciuar dhe raportuar rastet e korrupsionit në prokurimin publik, përjashtimisht Policisë së Kosovës në një (1) rast, asnjë institucion tjetër nuk ka deponuar gjatë vitit 2020 ndonjë kallëzim penal në Prokurorin e Shtetit lidhur me korrupsionin në fushën e prokurimit publik. Për më tepër, nisur nga fakti se institucionet shtetërore janë edhe autoritete kontraktuese, që vazhdimisht udhëheqin me procedura të ndryshme të prokurimit, angazhimi dhe denoncimi i korrupsionit pothuajse nuk ka ekzistuar gjatë vitit 2020. Ndërsa, gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, kjo praktikë ka filluar të ndryshojë ku krahas Policisë së Kosovës, e cila ka parashtruar shtatë (7) kallëzime penale të kësaj natyre, pesë (5) nga qytetari, tre (3) nga i dëmtuari si dhe kemi një (1) kallëzim penal të deponuar nga Agjencia Kundër Korrupsion, një (1) në kompetencë dhe një (1) nga Inspektorati Policor i Kosovës.<sup>1</sup>

Pas analizimit të aktakuzave në rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin në fushën e prokurimit publik, IKD dhe INPO gjejnë se mungesa e përdorimit adekuat të ekspertizës së institucioneve të tjera si prova me rastin e ngritjes së aktakuzave për rastet e korrupsionit në fushën e prokurimit publik evidentohet si çështje problematike. Përpos faktit se kjo ekspertizë rrallë herë aplikohet, edhe në rastet kur këto akte akuzuese referohen në dokumente të tilla, mungon arsyetimi i detajuar se si këto prova ndikojnë në vërtetimin e fakteve relevante mbi të cilat është ngritur aktakuzat e të cilat duhet të shërbejnë si bazë për vërtetimin e fajësisë së të akuzuarve për keqpërdorime me fonde publike.

Në anën tjetër, përballë pasqyrimin të shumë keqpërdorimeve në fushën e prokurimit publik nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Prokurori i Shtetit nuk ka ngritur asnjë aktakuzë bazuar në këto raporte, derisa një raport të kësaj zyre e ka përdorur si provë në një (1) aktakuzë. Një e metë në politikën e hetimit të kriminalitetit në fushën e prokurimit publik është edhe mos realizimi i ekspertizave të prokurimit.

Në hetimin e korrupsionit në fushën e prokurimit publik, IKD po ashtu gjen mos fokusim të sistemit të drejtësisë në luftimin e kësaj forme të kriminalitetit përmes konfiskimit të pasurisë. Sa i përket aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2020, IKD dhe INPO pas analizimit të këtyre

---

<sup>1</sup> Shënim: Të dhënat lidhur me kallëzimet penale të ushtruara gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 janë të shënuara si total për lëndët me PP dhe PPN.

aktakuzave gjejnë se Prokurori i Shtetit në asnjë nga aktakuzat e analizuara, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë për konfiskim të pasurisë së përfituar me vepër penale. Ndërsa, sa i përket aktakuzave të ushtruara nga Prokurori i Shtetit në vitin 2021, rezulton se vetëm në një rënë prej tyre është propozuar konfiskimi i një veture në pronësi të të pandehurit.

Sipas gjetjeve të IKD-së nga monitorimi sistematik i rasteve të korrupsionit, ajo çka vërehet në rastet e korrupsionit të ndërlidhura me prokurim publik është mungesa e efikasitetit me të cilën gjykatat në Kosovë i kanë trajtuar këto raste. Rastet e respektimit të afateve ligjore në trajtimin e këtyre rasteve nga gjykatat paraqiten vetëm si përjashtuese. IKD dhe INPO në këtë raport kanë identifikuar katër (4) raste të kësaj natyre në të cilat gjatë vitit 2020 nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore. Dy (2) prej këtyre aktakuzave janë të ngritura në vitin 2016, një (1) aktakuzë e ngritur në vitin 2017 dhe e fundit e ngritur në vitin 2019.

Në këtë aspekt duhet përmendur aktakuzën e ngritur më 14 qershor 2016 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ndaj ish-ministrit të shëndetësisë Ferid Agani dhe ish-sekretarit të përgjithshëm të MSH-së Gani Shabani, për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Ndaj Aganit dhe Shabanit, Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 prill 2019 kishte shpallur aktgjykim dënues. Mirëpo, ky vendim i nxjerrë nga shkalla e parë ishte anuluar nga Apeli dhe kjo çështje penale ishte kthyer në rigjykim. Pas kthimit të këtij rasti në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk kishte caktuar asnjë seancë gjyqësore për trajtimin e këtij rasti për gati 15 muaj, respektivisht seanca e parë ishte caktuar më 23 mars 2021.

## **2. Korniza ligjore për luftimin e korrupsionit në prokurimin publik**

Në rendin juridik të Republikës së Kosovës, shfrytëzimi i fondeve publike rregullohet me ligj të veçantë, i cili shërben si bazë për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për shfrytëzimin e fondeve publike, të cilat kriterë dhe procedura më pas detajohen me legjislacion sekondar.<sup>2</sup> Keqpërdorimet në këtë fushë paraqesin vepër penale.<sup>3</sup>

Nisur nga fakti se këto vepra penale janë pjesë e kapitullit 34, përkatësisht kapitullit që përcakton veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, në këto raste penale mund të aplikohet edhe Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.<sup>4</sup>

## **3. Ngarkesa e sistemit të drejtësisë me lëndë të korrupsionit në prokurim publik**

Statistikat e sistemit prokurorial për vitin 2020 flasin për pasivitet dhe mungesë të rezultateve në luftën kundër korrupsionit në fushën e prokurimit publik. Në fakt, këto statistika flasin edhe për një mungesë të theksuar të denoncimeve në këtë fushë nga ana e institucioneve të tjera në Prokurorin e Shtetit.

Prokurori i Shtetit e ka filluar vitin 2020 me katër (4) lëndë të trashëguara nga viti 2019, në të cilat lëndë kanë qenë të përfshirë 11 persona. Dy (2) prej këtyre lëndëve janë të parashtruara në PSRK, derisa dy (2) të tjera në PTh në Prizren. Kjo e fundit, gjatë vitit 2020 nga Policia e Kosovës kishte pranuar edhe një lëndë të re të kësaj natyre. Gjatë vitit 2020, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur gjithsej katër (4) raste të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, në të cilat raste bëjnë pjesë shtatë (7) persona. Lidhur me mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve, bazuar në të dhënat statistikore të Prokurorit të Shtetit, kallëzimet penale nga regjistri PP ndaj katër (4) personave janë hudhur dhe ndaj një (1) personi janë pushuar hetimet. Gjatë vitit 2020, Prokurori i Shtetit ka ngritur dy (2) aktakuza në rastet e veprave penale të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, të cilat aktakuza janë ngritur pas zhvillimit të hetimeve. Të dy (2) këto aktakuza janë ngritur nga Prokuroria Themelore në Prizren. Sa i përket lëndëve nga regjistrat PPN, 13 informata kanë qenë të pambyllura në fillim, 10 informata të reja janë pranuar në punë, janë përfunduar tre të tilla, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 20 informata PPN me 40 persona.

Referuar statistikave zyrtare të PSh, në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2021, Prokurori i Shtetit ka trashëguar katër (4) lëndë të korrupsionit në prokurim publik, në të cilat raste janë të përfshirë 11 persona. Dy (2) prej këtyre lëndëve janë të deponuara në PSRK dhe dy (2) të tjera në PTh në Prizren. Për dallim nga viti 2020, gjatë kësaj periudhe kohore kemi ngritje të lëndëve të reja të pranuar, ku gjatë kësaj periudhe evidentohen tetë (8) raste të reja të pranuar. Statistikat e PSh thonë se në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2021 janë zgjidhur gjithsej katër (4) lëndë të kësaj natyre dhe një (1) sosh është dërguar në kompetencë. Në fund të kësaj

---

<sup>2</sup> Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Neni 1.1.

<sup>3</sup> Kodi nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës. Neni 415, 416 dhe 417.

<sup>4</sup> Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Neni 4.1. dhe 2.1.1.2; Shih për më tepër Shala, Gzim; Nrecaj, Albulena: “Korrupsioni në prokurimin publik”, Prishtinë, Qershor. 2020. F.8-10. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/Korrupsioni-ne-Prokurimin-Publik-1-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2021).

periudhe kanë mbetur të pazgjidhura tetë (8) raste me 21 persona. Në periudhën Janar-Qershor 2021, sipas statistikave rezulton se janë pushuar hetimet ndaj dy (2) personave, ndërsa janë nxjerrë 12 vendime për fillim të hetimeve. Gjatë kësaj periudhe kohore, PSh ka ngritur tri (3) aktakuza për këto vepra penale, pas zhvillimit të hetimeve, ku dy nga këto akuza janë ngritur nga Prokuroria e Ferizajt, ndërsa një nga ajo e Gjilanit.

Bazuar në të dhënat zyrtare, IKD gjen se të gjitha rastet e Prokurorit të Shtetit për të cilat gjatë vitit 2020 është shpallur vendim gjyqësor, kanë dështuar të provohen në gjykatë. Gjatë vitit 2020 janë nxjerrë katër (4) vendime gjyqësore përkitazi me aktakuzat e Prokurorit të Shtetit, ku të gjitha këto vendime kanë të bëjnë me aktakuzat e ngritura nga Prokuroria Themelore në Prizren. Në një (1) prej këtyre rasteve është hudhur aktakuza derisa në tri (3) raste të tjera është nxjerrë aktgjykim lirues. Për të gjitha këto raste, Prokurori i Shtetit ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

Bazuar në këto të dhëna, IKD dhe INPO gjejnë se përkundër potencialit të madh korruptiv në fushën e prokurimit publik, aktiviteti i Prokurorit të Shtetit në këtë fushë është shumë pasiv në inicimin dhe hetimin e rasteve me vet-iniciativë. Kjo për arsye se bazuar në të dhënat zyrtare të këtij institucioni, asnjë rast i kësaj natyre nuk është iniciuar me vetiniciativë nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Lidhur me suksesin e aktakuzave të ngritura lidhur me këto vepra penale, në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2021, në pesë (5) vendime gjyqësore të shpallura nga gjykatat, në tre (3) raste të akuzuarit janë shpallur fajtorë, në një (1) rast i akuzuari është liruar nga akuza dhe në një (1) rast aktakuza është hudhur para shqyrtimit gjyqësor.

IKD ka kërkuar qasje në statistikat e gjykatave lidhur me rastet e korrupsionit në fushën e prokurimit publik gjatë vitit 2020, por se përgjigja e të njëjtëve ka qenë se gjykatat nuk gjenerojnë statistika të ndara për korrupsionin në fushën e prokurimit publik.<sup>5</sup> Ndërsa, sa i përket periudhës Janar-Qershor 2021, referuar përgjigjes zyrtare të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), rezulton se gjatë kësaj periudhe është zgjidhur vetëm një lëndë, e bartur nga viti paraparak, ndërsa lëndë të pranuar dhe të mbetura në punë nuk ka.<sup>6</sup>

#### **4. Trajtimi i rasteve të prokurimit nga AKK**

Në kuadër të AKK-së funksionon edhe Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik (DPKPP), brenda departamentit për parandalimin e korrupsionit.

Në fushën e parandalimit, ky divizion gjatë vitit 2020 ka pranuar gjithsej gjashtë (6) informata. Tre (3) prej këtyre rasteve janë zgjidhur duke ofruar opinione parandaluese tek autoritetet kontraktuese.<sup>7</sup>

<sup>5</sup> Përgjigje për IKD. KGJK. 24 shkurt 2021.

<sup>6</sup> Përgjigje për IKD. KGJK. 4 tetor 2021.

<sup>7</sup> Përgjigje për IKD. AKK. 12 maj 2020.

Në aspekt të hetimit në procedurë paraprake, AKK në vitin 2020 ka trashëguar gjithsej 15 raste, derisa ka pranuar edhe nëntë (9) raste të reja. Të gjitha këto raste janë zgjidhur nga AKK gjatë vitit 2020.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së këtyre rasteve, bazuar në përgjigjen e AKK-së, 12 raste janë mbyllur, janë dërguar tetë (8) kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore derisa katër (4) raste janë proceduar në polici dhe prokurori.

Me këtë rast, IKD dhe INPO gjejnë se ka mospërputhje në mes të dhënave të AKK dhe Prokurorit të Shtetit. Kjo pasi përderisa në AKK thonë se gjatë vitit 2020 katër (4) raste i kanë proceduar në polici dhe prokurori, në të dhënat e Prokurorit të Shtetit nuk figurojnë asnjë rast i iniciuar nga AKK gjatë vitit 2020.

IKD ka dërguar kërkesë për informata në adresë të AKK-së dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, me qëllim të qartësimit të këtyre kundërthënieve.

Përkitazi me këtë çështje, AKK në përgjigjen e saj sërish ka konfirmuar të dhënë se ka proceduar në Prokurori dhe Policinë e Kosovës – Departamenti për Hetime dhe Krime Ekonomike i Kosovës katër (4) raste nga fusha e prokurimit publik. Për më tepër, kjo Agjenci ka sqaruar se këto të dhëna burojnë nga evidencat me të cilat ajo disponon.<sup>8</sup>

Ndërsa, në përgjigjen e pranuar nga KPK lidhur me këtë problematikë, të njëjtit mospërputhjen e këtyre të dhënave e kanë arsyetuar me faktin se aplikacioni i modeluar nga Zyra Statistikore ku përfshihen të dhëna lidhur me veprat në fushën e prokurimit, është përcjellë me disa të meta, si pasojë e vështirësisë në gjenerimin e raporteve statistikore me informata të llojllojshme gjatë gjithë procedurës së zgjidhjes së tyre. Për më tepër, ky aplikacion i cili gjeneron të dhëna për veprat në fushën e prokurimit sipas tyre, nuk ka mundësi të përcjellë historikun e të gjitha informatave gjatë procedurës së rrjedhës së lëndës nga parashtruesi deri në vendim të gjykatës, e se informatat lidhur me cilësimin e veprës penale janë ndër shkaktarët e pasqyrimin joadekuat të këtyre veprave penale. Andaj, referuar kësaj përgjigje rezultoi se puna e pasqyrimin të të dhënave të tilla do të përcillet me probleme të ngjashme, deri në funksionalizimin e plotë të SMIL-it (Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve).<sup>9</sup>

Sa i përket vitit 2021, IKD ka kërkuar vazhdimisht të dhëna statistikore nga AKK, por të njëjtit nuk i kanë përcjellë këto të dhëna, përkundër obligimit të tyre ligjor sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

## **5. Profesionalizmi i sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të prokurimit**

Vet mënyra se si ndërtohet vepra bazë e korrupsionit, sipas të cilës bëhet ndjekja dhe gjykimi i rasteve të keqpërdorimeve në fushën e prokurimit publik, kërkon njohuri dhe kuptim për këtë fushë, jo vetëm të Kodit Penal të Republikës por edhe njohuri dhe kuptim të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, varësisht nga njohja e

<sup>8</sup> Përgjigje për IKD. AKK. 23.03.2021

<sup>9</sup> Përgjigje për IKD. KPK. 13.04.2021.

këtyre rregullave, përkatësisht profesionalizmit në fushën e prokurimit publik, varet edhe cilësia e ndjekjes dhe gjyqimit të këtyre rasteve.

Gjatë vitit 2020, në DKR-të e të gjitha PTh-ve në Republikën e Kosovës kanë qenë të angazhuar gjithsej 43 prokurorë, derisa në PSRK kanë qenë të angazhuar gjithsej 17 prokurorë (së bashku me kryeprokurorin). Pra, gjatë kësaj periudhe kohore, kanë qenë gjithsej 60 prokurorë me kompetencë për të trajtuar rastet e keqpërdorimeve në fushën e prokurimit publik.

Në raportin e kaluar mbi korrupsionin në prokurimin publik,<sup>10</sup> IKD dhe INPO kishin gjetur se përgjatë tri (3) viteve, sistemi prokurorial nuk kishte arritur që ta trajnonte në fushën e prokurimit publik as gjysmën e prokurorëve të cilët kanë kompetencë për trajtimin e rasteve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, me ç'rast i kishte rekomanduar sistemit prokurorial që të rrisë numrin e trajnimeve në fushën e prokurimit publik për prokurorët të cilët kanë për detyrë trajtimin e këtyre rasteve.

IKD gjen se sistemi prokurorial ka implementuar pjesërisht këtë rekomandim, në kuptim të ngritjes së numrit të trajnimeve në fushën e prokurimit publik të mbajtura për prokurorët me kompetencë për trajtimin e këtyre rasteve. Në këtë drejtim, IKD dhe INPO gjejnë se gjatë vitit 2020 janë trajnuar gjithsej 14 prokurorë, ndërsa gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 janë trajnuar pesë (5) prokurorë.

Lidhur me këto trajnime, IKD dhe INPO gjejnë se përkundër faktit se ka një ngritje të numrit të prokurorëve të trajnuar në fushën e prokurimit publik, ky numër i trajnimeve ende nuk është i mjaftueshëm dhe kjo nisur nga numri i prokurorëve me kompetencë për të trajtuar këto raste si dhe nga kompleksiteti i këtyre rasteve.

Në anën tjetër, IKD dhe INPO gjejnë se këto trajnime nuk janë shtrirë në të gjitha prokuroritë, por se janë koncentruar në disa prokurori. Nga 14 trajtimet e kësaj natyre të organizuara gjatë vitit 2020, në pesë (5) prej tyre kanë marrë pjesë prokurorët e PTh në Prishtinë, në katër (4) prokurorët e PTh në Ferizaj, në tri (3) prokurorët e PTh në Prizren dhe në dy (2) prokurorët e PSRK-së. Lidhur me këtë tematikë, gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, në dy (2) trajnime të organizuara kanë marrë pjesë prokurorët nga PTh në Prizren, ndërsa në një (1) trajnim kanë marrë pjesë prokurorët e PTh në Prishtinë, prokurorët e PTH në Ferizaj dhe PTH në Gjiilan.

Në sistemin prokurorial gjatë vitit 2020 rezulton se kanë qenë të angazhuar vetëm gjashtë (6) ekspertë që merren edhe me fushën e korrupsionit në prokurim publik. Mirëpo, këta ekspertë janë të angazhuar vetëm në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa instancat tjera të sistemit prokurorial nuk kanë ekspertë të tillë. Një situatë identike sa i përket angazhimit të ekspertëve nga lëmi i prokurimit e ka përcjellë sistemin prokurorial edhe gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2021, ku gjashtë (6) ekspertë të tillë janë të angazhuar vetëm brenda PSRK-së. Sa i përket prokurorëve të tjera në përgjigjen e pranuar nga KPK thuhet se “*Secila*

---

<sup>10</sup> Shala, Gzim; Nrecaj, Albulena: “Korrupsioni në prokurimin publik”, Prishtinë, Qershor. 2020. F.15. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/Korrupsioni-ne-Prokurimin-Publik-1-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2021).

*prokurori angazhon ekspert të jashtëm në bazë të nevojave dhe angazhimi i tyre bëhet duke u bazuar në aktet juridike që e rregullojnë këtë fushë”.*<sup>11</sup>

Sa i përket sistemit gjyqësor, në përgjigjen e KGJK-së për këtë raport thuhet se “Gjatë viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020 janë realizuar 10 trajnime të ndërlidhura me prokurim publik. Në këto trajnime janë trajnuar 47 gjyqtarë. Prej tyre dy aktivitete trajnuese ( Kontratat në prokurimin publik si dhe Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në) janë dedikuara për gjyqtarët e departamentit administrativ ndërkaq 7 aktivitetet tjera kanë qenë të dedikuara për gjyqtarët e fushës penale. Numri prej 47 gjyqtarë nënkupton që një gjyqtarë ka marrë pjesë në disa sesione trajnuese”.<sup>12</sup>

Ndërsa, gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, referuar përgjigjes së pranuar nga KGJK rezulton “Gjyqtarët e të tri niveleve janë trajnuar nga fusha e prokurimit publik, përkatësisht kanë ndjekur trajnimin dy ditor: “Program i Specializuar - Mashtrim dhe Korrupsioni në Prokurim Publik Sesioni I”, i cili është organizuar nga Akademia e Drejtësisë, me datë 30.03.2021 - 31.03.2021. Në këtë trajnim janë trajnuar 22 gjyqtarë”.<sup>13</sup>

Lidhur me këto të dhëna, fillimisht nuk është e qartë se sa prej gjyqtarëve me mandat për të trajtuar rastet e korrupsionit në fushën e prokurimit publik janë trajnuar nga KGJK përgjatë katër (4) viteve të fundit. Por se, IKD dhe INPO gjejnë se as për katër (4) vite, sistemi gjyqësor nuk ka arritur që në fushën e prokurimit publik të trajnojë të gjithë gjyqtarët me kompetencë në trajtimin e rasteve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik. Kjo pasi gjatë vitit 2020, në të gjitha DKR-të e GjTh-ve, në DKR të GjA-së dhe në Departamentin Special të GjTh në Prishtinë dhe GjA kanë qenë të angazhuar gjithsej 68 gjyqtarë. Ndërsa, gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2021, kanë qenë të angazhuar gjithsej 59 gjyqtarë në të gjitha DKR-të e GjTh-ve, Departamentin Special (DS) të GjTh në Prishtinë, DKR dhe DS të GjA-së.

Gjatë vitit 2020, referuar bazës së të dhënave të regjistruara në Divizionin e Trajnimeve të Policisë së Kosovës rezulton vetëm një (1) trajnim i mbajtur në fushën e korrupsionit në prokurimin publik, ku pjesëmarrës ka qenë vetëm një zyrtar. Ndërsa, shumë aktivitete dhe trajnime të planifikuara të kësaj natyre, bazuar në përgjigjen zyrtare të pranuar nga Zyra për Informim e PK, thuhet se kanë dështuar që të realizohen për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19.<sup>14</sup> Sipas të dhënave të zyrës për informim nga PK, rezulton se gjatë periudhës gjashtë (6) mujore Janar-Qershor 2021, në fushën e korrupsionit që ndërlidhet me prokurimin publik janë organizuar tri (3) trajnime virtuale përmes platformës online me gjithsej 16 pjesëmarrës.<sup>15</sup>

---

<sup>11</sup> Përgjigje për IKD. KPK. 1 tetor 2021.

<sup>12</sup> Përgjigje për IKD. KGJK. 23 shkurt 2021.

<sup>13</sup> Përgjigje për IKD. KGJK. 17 shtator 2021.

<sup>14</sup> Përgjigje për IKD. Zyra Informimit DPP. 23 prill 2021.

<sup>15</sup> Përgjigje për IKD. Zyra Informimit DPP. 20 tetor 2021.

## **6. Bashkëpunimi i sistemit prokurorial me institucionet e tjera në luftimin e krimeve në prokurimin publik**

Sipas Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, njëra ndër detyrat dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit është edhe bashkëpunimi me Policinë, Gjykatat dhe institucionet e tjera.<sup>16</sup> Krahas këtij përcaktimi të përgjithshëm, dispozitat ligjore i mundësojnë Prokurorit të Shtetit që me rastin e zhvillimit të hetimeve, të bashkëpunojë me institucionet e tjera, me qëllim të ngritjes së kualitetit të hetimit. Për më tepër, të gjitha institucionet shtetërore, janë të obliguara që t'i përgjigjen kërkesave të Prokurorit të Shtetit.

Në anën tjetër, sa i përket veprave penale të korrupsionit, veçanërisht atyre të ndërlidhura me prokurim publik, bashkëpunimi me institucionet e tjera ligj zbatuese, me qëllim të ngritjes së cilësisë së hetimit, është i një rëndësie të veçantë. Ky lloj bashkëpunimi përpos që ngrit potencialin e zbulimit të këtyre veprave penale, ngritë edhe cilësinë e ndjekjes penale si dhe aktivizon të gjitha institucionet shtetërore relevante në zbulimin e këtij lloj kriminaliteti.

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet e tjera, IKD ka gjetur se në trajtimin e rasteve të korrupsionit të ndërlidhura me prokurim publik, mungon bashkëpunimi i Prokurorit të Shtetit me institucionet e tjera, dhe kjo si në kuptim të parashtrimit të kallëzimeve penale nga institucionet e tjera, por edhe në kuptim të përdorimit të burimeve dhe ekspertizës së institucioneve të tjera gjatë hetimit të këtyre rasteve.

Sa i përket parashtrimit të rasteve, IKD gjen se përkundër faktit se në Republikën e Kosovës funksionojnë mekanizma dhe institucione të shumta për fuqizimin e zbatimit të ligjit, përjashtimisht Policisë së Kosovës në një (1) rast, asnjë institucion tjetër nuk ka parashtruar gjatë vitit 2020 ndonjë kallëzim penal në Prokurorin e Shtetit lidhur me korrupsionin në fushën e prokurimit publik. Për më tepër, nisur nga fakti se institucionet shtetërore janë edhe autoritete kontraktuese, që vazhdimisht udhëheqin me procedura të ndryshme të prokurimit, potenciali i denoncimit të korrupsionit në fushën e prokurimit publik nga institucionet shtetërore është shumë i lartë. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndodhur gjatë vitit 2020.

Në këtë mënyrë, përkundër faktit se akterë brenda sistemit prokurorial zhvillojnë vazhdimisht takime me udhëheqës të institucioneve të tjera, ku zotohen për fuqizim të bashkëpunimit ndërinstytucional, kjo nuk është përkthyer në bashkëpunim në luftimin e e korrupsionit në fushën e prokurimit publik.

Ndërsa, gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, ka një progres në këtë drejtim, ku krahas Policisë së Kosovës, e cila ka parashtruar shtatë (7) kallëzime penale të kësaj natyre, kemi një (1) kallëzim penal të deponuar nga Agjencia Kundër Korrupsion, një (1) nga Inspektorati Policor i Kosovës, tre (3) nga i dëmtuari, pesë (5) nga qytetari dhe një (1) në kompetencë.

Krahas kësaj, mungesa e bashkëpunimit të PSh me institucione të tjera në këtë fushë shprehet edhe në mos aplikimin e dokumenteve të institucioneve të tjera si prova me rastin e ngritjes dhe përfaqësimit të aktakuzave në gjykatë.

---

<sup>16</sup> Ligji nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit. Neni 7.1.10.

Lidhur me këtë fushë, raporti paraprak i IKD dhe INPO lidhur me korrupsionin në fushën e prokurimit publik gjente se vetëm në tri (3) raste si provë është propozuar raporti i brendshëm i auditimit, në dy (2) raste vendimet dhe konkluzionet e OSHP-së, në një (1) rast opinionin i AKK-së dhe në një (1) rast informacionet nga OLAF (European Anti-Fraud Office).

Pas analizimit të aktakuzave në rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin në fushën e prokurimit publik, IKD gjen se mungesa e përdorimit adekuat të ekspertizës së institucioneve të tjera si prova me rastin e ngritjes së aktakuzave për rastet e korrupsionit në fushën e prokurimit publik evidentohet si problematikë edhe në periudhën kohore që i referohet ky raport. Përpos faktit se kjo ekspertizë rrallë herë aplikohet, edhe në rastet kur këto aktet akuzuese referohen në dokumente të tilla, mungon arsyetimi i detajuar se si këto prova ndikojnë në vërtetimin e fakteve relevante mbi të cilat është ngritur aktakuza e të cilat duhet të shërbejnë si bazë për vërtetimin e fajësisë së të akuzuarve për keqpërdorime me fonde publike.

Po ashtu, një e metë në politikën e hetimit të kriminalitetit në fushën e prokurimit publik është edhe mos realizimi i ekspertizave të prokurimit, përmes të cilave do të provohej keqpërdorimi me para publike dhe dëmtimi i buxhetit të shtetit. Ngase në raste të tilla, përmes këtyre ekspertizave në mënyrë të saktë do të bëhej precizimi i dëmit i cili pretendohet se është shkaktuar me vepër penale, obligim ky i prokurorisë sipas nenit 136.1.1.1 të KPPK-së.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se mos bashkëpunimi i Prokurorit të Shtetit me institucionet e tjera në trajtimin e këtyre rasteve paraqet cilësi të dobët dhe orientim jo të duhur të hetimeve penale. Aq më tepër, duke u nisur nga natyra karakteristike që kanë veprat penale të korrupsionit në përgjithësi, e ato të ndërlidhura me prokurim publik në veçanti. Mos shfrytëzimi i mundësive ligjore për të bashkëpunuar me institucionet e tjera, krahas mungesës së trajnimeve të prokurorëve në fushën e prokurimit publik, paraqet një trajtim symbyllazi me këto raste, i cili nuk garanton një hetim të mirëfilltë penal dhe rrjedhimisht as aktakuza të qëndrueshme.

Për këto arsye, IKD i rekomandon Prokurorit të Shtetit që në secilin rast, të trajtojë të gjitha pistat e hetimit të një rasti të korrupsionit, të ndërlidhur me prokurim publik. Ky trajtim gjithëpërfshirës është i pamundur të bëhet pa bashkëpunimin institucional të Prokurorit të Shtetit me institucionet e tjera. Andaj, IKD i bënë thirrje prokurorëve që në secilin rast të kësaj natyre, të shfrytëzojnë ekspertizën e institucioneve të specializuara në fushën e prokurimit publik, në mënyrë që në këto raste të ndërtohet hetime dhe aktakuza të qëndrueshme dhe profesionale.

## 7. Heshtja e sistemit prokurorial përballë raporteve të ZKA-së

Në raportet vjetore të publikuara nga ZKA pas auditimit të institucioneve publike, ky institucion vazhdimisht ka gjetur parregullsi të shumta financiare, me ç'rast janë pasqyruar edhe parregullsitë në fushën e prokurimit publik. Po ashtu, edhe në raportet vjetore të këtij institucioni evidentohen parregullsi të shumta në fushën e prokurimit publik, si lidhje e kontratave duke anashkaluar procedurat e prokurimit, shpërblimi me kontrata i operatorëve ekonomikë që nuk i kanë plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë së dosjes së tenderit, pagesa për punë të pakryera dhe pa dëshmi të mjaftueshme etj.<sup>17</sup>

Për të gjitha këto gjetje të trajtuara përgjithësisht në raportin vjetor të auditimit dhe të detajuara në raportet individuale të auditimit të institucioneve publike, Prokurori i Shtetit ka heshtur, duke mos trajtuar asnjë prej tyre.

Nga analizimi i të gjitha aktakuzave për rastet e korrupsionit, të ndërlidhura me Prokurim Publik, IKD dhe INPO ka gjetur se Prokurori i Shtetit në asnjë rast të vetëm nuk ka ngritur me vetiniciativë aktakuzë duke u bazuar në raportet e ZKA-së.

Në anën tjetër, krahas heshtjes së Prokurorit të Shtetit përballë këtyre raporteve në kuptimit të inicimit të procedurave penale, IKD ka gjetur se Prokurori i Shtetit ka injoruar këto raporte edhe në kuptim të aplikimit të të njëjtave si prova në procedurë penale. Ky fakt ishte evidentuar edhe në raportin e kaluar të IKD-së dhe INPO-s lidhur me korrupsionin në fushën e prokurimit publik.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson kjo mënyrë e veprimit nga sistemi prokurorial ia humbë edhe vetë kuptimin veprimtarisë së një institucioni siç është në rastin konkret ZKA. Vënia në pah e shkeljeve të vazhdueshme nga ana e ZKA-së dhe mos trajtimi i këtyre rasteve nga Prokurori i Shtetit paraqet një neglizhencë të paarsyeshme dhe mungesë të llogaridhënies së Prokurorit të Shtetit në drejtim të luftimit të korrupsionit, veçanërisht korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik. Përderisa kërkesa është për hetime gjithëpërfshirëse në drejtim të luftimit të këtij lloj kriminaliteti, Prokurori i Shtetit nuk ka shfrytëzuar pothuajse asetin kryesor në këtë fushë, e që është veprimtaria dhe ekspertiza e ZKA-së.

Për këto arsye, IKD i rekomandon Prokurorit të Shtetit që në trajtimin e këtyre rasteve, domosdoshmërisht të trajtojë edhe raportet e ZKA-së dhe parregullsive të ngritura nga ZKA, me dyshime për përmbajtje të elementeve të veprave penale, ti trajtojë dhe tu jap epilog, dhe jo që këto raporte të detajuara të ZKA-së, të cilësohen si inekzistente nga ana e Prokurorit të Shtetit.

---

<sup>17</sup> “Raporti Vjetor i Auditimit. 2018”. ZKA. Gusht 2019. (shih linkun <http://ëëë.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/08/RVA-2018-Shqip-2.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 19 maj 2020).; “Raporti Vjetor i Auditimit 2019”. ZKA. Gusht 2020. (Shih linkun [http://ëëë.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/09/RaportiVjetor\\_ALB\\_FINAL\\_PRESS\\_01.pdf](http://ëëë.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/09/RaportiVjetor_ALB_FINAL_PRESS_01.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 16 mars 2021). ; “Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Raportin Financiar Vjetor të Qeverisë për Buxhetin e Republikës Së Kosovës”. Gusht 2021. (Shih linkun [https://ëëë.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/08/RaportiVjetoriAuditimit\\_2020\\_Shqip.pdf](https://ëëë.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/08/RaportiVjetoriAuditimit_2020_Shqip.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 7 dhjetor 2021).

## **8. Sekuestrimi dhe konfiskimi në rastet e prokurimit publik**

Në raportin e kaluar mbi korrupsionin në fushën e prokurimit publik, IKD dhe INPO kishin gjetur se përjashtimisht një rasti ku kemi sekuestrim, në asnjë prej aktakuzave të analizuara nga IKD, Prokurorët e Shtetit nuk kanë bërë kërkesa për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Ndërsa, sa i përket aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2020, IKD dhe INPO pas analizimit të këtyre aktakuzave gjen se Prokurori i Shtetit në asnjë nga aktakuzat e analizuara, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë për konfiskim të pasurisë së përfituar me vepër penale. Ndërsa, sa i përket aktakuzave të ushtruara nga Prokurori i Shtetit në vitin 2021, rezulton se vetëm në njërin prej tyre është propozuar konfiskimi i një veture në pronësi të të pandehurit.

Sa i përket rasteve të korrupsionit, IKD në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar mungesën e rezultateve të sistemit të drejtësisë në fushën e konfiskimit përfundimtar. Një mungesë të tillë e rezultateve vazhdon të identifikohet si problematikë edhe në rastet e korrupsionit, të ndërlidhura me prokurim publik.

Kjo mënyrë e veprimit ndërton argumentin se sistemi i drejtësisë nuk është i vëmendshëm sa i përket domosdoshmërisë së luftimit të korrupsionit në prokurimin publik përmes konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Në këtë drejtim, arsyetimi i Prokurorit të Shtetit se në shumë raste ky konfiskim mund të bëhet edhe pa kërkesë të Prokurorit të Shtetit, pasi konfiskimi obligohet me ligj, nuk e amniston Prokurorin e Shtetit nga përgjegjësia për mungesë të rezultateve. Për më tepër, përgjegjësia kryesore bie pikërisht mbi Prokurorin e Shtetit, i cili përfaqëson aktakuzën në Gjykatë.

Duke e njohur rëndësinë e konfiskimit në fushën e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit, në rastin konkret atij të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, IKD i bënë thirrje sistemit të drejtësisë që të ndryshojë qasje në këtë fushë, duke rritur fokusin në konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

## **9. Zvarritjet e gjyqimit të rasteve të prokurimit publik**

Sipas gjetjeve të IKD-së nga monitorimi sistematik i rasteve të korrupsionit, ajo çka vërehet në rastet e korrupsionit të ndërlidhura me prokurim publik është mungesa e efikasitetit me të cilën gjykatat në Kosovë i kanë trajtuar këto raste.

Sipas KPPRK, shqyrtimi fillestar mbahet brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës. Në 24 rastet e korrupsionit që ndërlidhen me prokurim publik që IKD ka monitoruar gjatë vitit 2020, në 21 prej tyre gjykatat kanë mbajtur shqyrtimet fillestar jashtë afatit ligjor, derisa ky afat ligjor është respektuar në vetëm tre (3) raste. Sa i përket aktakuzave të ushtruara gjatë vitit 2021 rezulton se në tre (3) raste shqyrtimi fillestar ishte mbajtur jashtë afatit ligjor, ndërsa në dy (2) të tjera brenda këtij afati.

Tutje, sipas KPPRK-së, shqyrtimi i dytë duhet të caktohen brenda një afati nga 30 deri në 45 ditë pas mbajtjes së shqyrtimeve fillestar.<sup>18</sup> Për këtë, IKD gjen se në të paktën 13 raste që IKD i monitoruar, shqyrtimet e dyta janë mbajtur jashtë afateve ligjore, derisa në vetëm një (1) rast, seanca e shqyrtimit të dytë është mbajtur brenda afateve ligjore.

IKD dhe INPO ka identifikuar katër (4) raste të kësaj natyre në të cilat gjatë vitit 2020 nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore. Dy (2) prej këtyre aktakuzave janë të ngritura në vitin 2016, një (1) aktakuzë e ngritur në vitin 2017 dhe e fundit e ngritur në vitin 2019.

Nga rastet që IKD dhe INPO kanë monitoruar gjatë vitit 2020, në tre (3) prej tyre procedura tashmë ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm. Në këtë numër të ulët, ka ndikuar reduktimi i punës së sistemit gjyqësor, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19. Ndërsa, në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2021, me aktgjykim të formës së prerë kanë përfunduar katër (4) raste.

Nga analiza e rasteve të korrupsionit, të ndërlidhura me prokurim publik, që janë trajtuar në kuadër të këtij raporti, bie në sy edhe papërgjegjësia e gjykatave në procedimin efikas dhe brenda një afati të arsyeshëm të këtyre rasteve gjatë kësaj periudhe raportuese. Në këtë aspekt duhet përmendur aktakuzën e ngritur më 14 qershor 2016 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ndaj ish-ministrit të shëndetësisë Ferid Agani dhe ish-sekretarit të përgjithshëm të MSH-së Gani Shabani, për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Ndaj Aganit dhe Shabanit, Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 prill 2019 kishte shpallur aktgjykim dënues. Mirëpo, ky vendim i nxjerrë nga shkalla e parë ishte anuluar nga Apeli dhe kjo çështje penale ishte kthyer në rigjykim. Pas kthimit të këtij rasti në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk kishte caktuar asnjë seancë gjyqësore për trajtimin e këtij rasti për gati 15 muaj, respektivisht seanca e parë ishte caktuar më 23 mars 2021.

---

<sup>18</sup> Shënim: Megjithëse, mbajtja e këtyre shqyrtimeve nuk është obligim për gjyqtarët, pasi të njëjtit mund të vendosin për kërkesat për hudhje të aktakuzave dhe kundërshtim të provave edhe pa mbajtje të seancës në fjalë.

## 10. Rekomandimet

1. Prokurori i Shtetit të ketë rol proaktiv në hetimin e rasteve të korrupsionit në prokurim publik duke inicuar raste edhe me vetiniciativë.
2. Institucionet e tjera të kenë rol proaktiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në fushën e prokurimit publik, duke inspektuar me kujdes këtë fushë dhe duke denoncuar rastet e keqpërdorimeve tek Prokurori i Shtetit.
3. Prokurori i Shtetit të shfrytëzojë ekspertizën e institucioneve të tjera me rastin e trajtimit të rasteve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, duke trajtuar dokumentet e institucioneve të tjera, në veçanti të ZKA.
4. KGJK, KPK dhe Akademia e Drejtësisë të trajtojnë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët me kompetencë në trajtimin e rasteve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik.
5. Prokurori i Shtetit të trajtojë raportet e ZKA-së të cilat paraqesin dyshim të bazuar për keqpërdorime në fushën e prokurimit publik. Prokurori i Shtetit të themelojë një njësi/komision për shqyrtimin preliminar të këtyre raporteve, e cila njësi/komision do të bënte shqyrtimin preliminar të këtyre raporteve dhe rastet me dyshim të bazuar do të procedonte në prokuroritë kompetente.
6. Parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, prokurorët dhe gjyqtarët t'i qasen edhe përmes konfiskimit të pasurisë.

## **11. Annex 1: Trajtimi i rasteve gjyqësore të korrupsionit në prokurimin publik**

IKD gjatë vitit 2020 dhe periudhës kohore Janar-Dhjetor 2021 në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës ka monitoruar gjithsej 164 seanca në 31 raste të korrupsionit, të ndërlidhura me prokurim publik. Nga ky total i seancave të monitoruara, 40 prej tyre kanë dështuar të mbaheshin, ndërsa 124 janë mbajtur.

Sa i përket rasteve që janë ende në shqyrtim në shkallë të parë, IKD gjen se dy (2) prej këtyre rasteve janë në fazën e shqyrtimit fillestar, një (1) ka përfunduar fazën e shqyrtimit të dytë, derisa 14 raste të tjera janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Në gjashtë (6) raste të tjera, Gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime liruese, pesë (5) nga të cilat më pas janë vërtetuar edhe në shkallë të dytë gjatë kësaj periudhe raportuese. Në gjashtë (6) raste të tjera gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime dënuese, dy (2) nga të cilat janë vërtetuar, derisa katër (4) janë nxjerrë në shkallë të parë, në një (1) rast është nxjerr aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale dhe në një (1) rast të tjetër është hedhur aktakuza në nëntor të vitit 2021.

Në këto raste, IKD gjen se në një rast ka arritur parashkrimi ndaj një të akuzuari për marrje ryshfeti, derisa në një rast tjetër aktakuza ishte hudhur poshtë pas mbajtjes së seancës fillestare, për shkak se gjykata kishte vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushen elementet e veprës penale që i ngarkohej atij.

Në vijim, IKD ka trajtuar dhe analizuar në detaje rastet në të cilat ka pasur zhvillime procedurale gjatë vitit 2020 dhe 2021, derisa rastet më të vjetra janë të pasqyruara në raportin e kaluar të IKD dhe INPO mbi korrupsionin në fushën e prokurimit publik.

### **1. Rasti Ferid Agani etj.**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PS.nr.75/2019

**Kryetar/e i Trupit Gjyqësor:** Kujtim Krasniqi (Shadije Gërguri gjatë gjykimit të parë)

**Prokuror/e:** Florije Salihu-Shamolli (Aktakuza është ngritur nga Prokurori Besim Kelmendi)

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Të akuzuar:** Ferid Agani; Gani Shabani

**Faza e procedurës:** Rigjykim.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021, kanë kaluar **1997 ditë**.)

Më 14 qershor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, ish-sekretarit të përgjithshëm të MSh-së, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrje e ryshfeti”, “dhënie e ryshfeti”, “trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “shmangia nga tatimi”. Në këtë çështje penale hetimet fillimisht janë zhvilluar ndaj 116 personave fizik dhe katër personave juridik. Pas hetimeve, për 56 persona fizik nuk ishin plotësuar kushtet ligjore që të përfshihen në këtë aktakuzë, andaj për të njëjtit edhe kishin pushuar hetimet.

Ngritja e aktakuzës nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ishte bërë në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, gjetje kjo të cilën e ka ngritur IKD në raportet paraprake.

Përkundër se aktakuza ishte ngritur nga prokurori Besim Kelmendi, i njëjti nuk e kishte përfaqësuar aktakuzën. Gjatë gjykimit, katër prokurorë tjerë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e kishin përfaqësuar këtë aktakuzë.

Aktakuza ishte dorëzuar në gjykatë në muajin qershor 2016, por leximi i saj nuk ishte bërë një kohë të gjatë, meqë prokuroria nuk i kishte dorëzuar provat për të gjithë të pandehurit në gjuhën që ata e kuptojnë. Kjo kishte rezultuar me pesë (5) seanca të shtyra. Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 19 maj 2017, si dhe më 25 maj 2017 për njërin nga të akuzuarit që kishte munguar në seancën e 19 majit. Kërkesat e mbrojtësve të të akuzuarve për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, ishin refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë më 31 korrik 2017, kurse, pas ankesave që mbrojtësit kishin ushtruar në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit, në tetor 2017 e kishte kthyer rastin në rivendosje.<sup>19</sup>

Pas kthimit të rastit në rivendosje, më 26 shkurt 2018, kryetarja e trupit gjykues, Shadije Gërguri, për qëllim të efikasitetit të çështjes, e kishte veçuar procedurën në tri pjesë. Nga ajo kohë, Ferid Agani dhe Gani Shabani gjykohen veçmas si një rast (Stenta 1). Gani Bajraktari dhe të akuzuarit tjerë, kryesisht mjekë, që bëjnë pjesë në dispozitivat III dhe IV të aktakuzës, janë duke u gjykuar veçmas (Stenta 2), kurse, Ali Hocaoglu dhe të akuzuarit tjerë që përfshihen nga dispozitivi katër deri në dispozitivin 10 të aktakuzës do të gjykohen veçmas (Stenta 3). Asnjë nga të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 26 shkurt 2018, kurse, kërkesat e tyre për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave ishin refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Në rastin “Stenta 1”, trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësja Shadije Gërguri, më 24 prill 2019 kishte shpallur aktgjykim dënues, me ç’rast Agani ishte dënuar me dy (2) vjet e gjashtë (6) muaj burg kurse Shabani me dy (2) vjet burg.<sup>20</sup> Mirëpo, ky aktgjykim ishte anuluar nga ana e Gjykatës së Apelit, pas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarve dhe rasti ishte kthyer në rigjykim.<sup>21</sup>

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Kallëzimi penal në rastin “Stenta” është ngritur më 26 maj 2014, kurse aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte nxjerr më 16 qershor 2014. Aktakuza është ngritur më 14 qershor 2016.

---

<sup>19</sup> “Apeli e kthen në rivendosje rastin “Stenta”. Betimi për Drejtësi, 2 nëntor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-stenta/>) Qasur për herë të fundit, 8 maj 2020

<sup>20</sup> “Rasti Stenta 1, ish-ministri Ferid Agani dhe ish-sekretari Gani Shabani dënohen me mbi 4 vjet burgim efektiv” Betimi për Drejtësi, 24 prill 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-ish-ministri-ferid-agani-dhe-ish-sekretari-gani-shabani-denohen-me-mbi-4-vjet-burg-efektiv/>) Qasur për herë të fundit, 8 maj 2020.

<sup>21</sup> “Apeli e kthen në rigjykim dhe rivendosje rastin ndaj ish-ministrit, Ferid Agani dhe ish-sekretarit, Gani Shabani”. Betimi për Drejtësi, 24 dhjetor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-dhe-rivendosje-rastin-ndaj-ish-ministrit-ferid-agani-dhe-ish-sekretarit-gani-shabani/>) Qasur për herë të fundit, 8 maj 2020.

Shqyrtimi fillestar në rastin “Stenta” ishte caktuar më 21 tetor 2016, respektivisht me katër muaj vonesë apo jashtë afatit të përcaktuar me KPPK. Karakteristikë për këtë rast është edhe seanca e shtyrë më 28 shkurt 2017, në të cilën gjyqtarja e rastit, Shadije Gërguri, kishte sqaruar se prokuroria me shkresë të veçantë ka njoftuar gjykatën se Afrim Bekteshi kishte qenë i përfshirë në hetimet për këtë rast, por ndaj tij nuk ishin gjetur elemente të veprës penale dhe i njëjti nuk ishte pjesë e akuzës.

Mënyra e ngritjes së aktakuzës dhe tërheqja nga ndjekja penale ndaj Afrim Bekteshit, dëshmon jo-seriozitetin e prokurorisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Po ashtu, arsyetimi i prokurorisë për gabim teknik në ngritjen e aktakuzës, bie në kundërshtimin me obligimin ligjor që ka Prokurori i Shtetit sipas nenit 48 të KPPK-së, i cili përcakton se është detyrim i prokurorit që gjatë hetimit të veprave penale, të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet, duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit.

Më 18 prill 2019, ishte dhënë fjala përfundimtare e palëve, ku prokurorja Florije Salihu-Shamolli kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, kurse mbrojtja lirimin e tyre, ndërsa më 24 prill, gjykata e shkallës së parë i kishte shpallur fajtorë të akuzuarit për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Agani ishte dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim efektiv, ndërsa i akuzuari tjetër, Gani Shabani ishte dënuar me dy vjet burgim efektiv. Nga ngritja e aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, kanë kaluar 1,165 ditë. Më 22 nëntor 2019, në Gjykatën e Apelit, ishte mbajtur seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit, në të cilën seancë të akuzuarit Ferid Agani dhe Gani Shabani, kishin kërkuar që shkalla e dytë t’i shpallë ata të pafajshëm ose që rasti ndaj tyre të kthehet në rigjykim. Në anën tjetër, prokuroria kishte kërkuar që ndaj të njëjtëve të rritet dënimi i shqiptuar nga shkalla e parë. Me 24 dhjetor 2019, përmes një komunikatë për media, Apeli kishte njoftuar se Departamenti Special i gjykatës së shkallës së dytë, i ka aprovuar ankesat e avokatëve mbrojtës të dy të akuzuarve kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas komunikatës, Gjykata e Apelit, pasi ka shqyrtuar më vëmendje aktgjykimin e shkallës së parë, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve si dhe shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar, mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, për çka duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Pasi kishin kaluar më shumë se 15 muaj që nga kthimi i këtij rasti në rigjykim, kjo gjykatë më 23 mars të këtij viti ka filluar ta trajtojë këtë rast.<sup>22</sup> Seanca e radhës e caktuar më 6 maj 2021 kishte dështuar të mbahej për shkak se prokurorja e rastit Florije Salihu-Shamolli ishte e angazhuar në një gjykim tjetër.<sup>23</sup> Gjykimi në këtë rast ka vazhduar me mbajtjen e gjykimeve në datat 31 maj, në të cilën seancë gjykata mori vendim që të kufizojë publikimin e dëshmive të dëshmitarëve deri në përfundim të procedurës së provuarit, dhe 30 qershor të këtij viti.

---

<sup>22</sup> “Fillon rigjykimi në rastin “Stenta”, avokatët mbrojtës thonë se do të dëshmohet pafajësia e të akuzuarve, pritet të dëshmojë edhe Curr Gjocaj”, Betimi për Drejtësi, 23 mars 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fillon-rigjykimi-ne-rastin-stenta-avokatet-mbrojtes-thone-se-do-te-deshmohet-pafajesia-e-te-akuzuarve-prietet-te-deshmoje-edhe-curr-gjocaj/>). (Qasur për herë të fundit më 24 mars 2021).

<sup>23</sup> “Prokurorja e angazhuar në rastin “Ukë Rugova 2”, dështon të vazhdojë gjykimi i rastit “Stenta”, Betimi për Drejtësi, 6 maj 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-e-angazhuar-ne-rastin-uke-rugova-2-desh-ton-te-vazhdoje-gjykimi-i-rastit-stenta/>). (Qasur për herë të fundit më 12 nëntor 2021).

Ndërsa, seanca e caktuar për tu mbajtur më 25 gusht ishte shtyrë pasi prokurorja e rastit kishte deklaruar se nuk ishte e përgatitur që të paraqesë provat materiale.<sup>24</sup> Në seancën e 10 shtatorit përfaqësuesi ligjor nga Avokatura Shtetërore ka deklaruar se nuk kanë arritur që të bëjnë precizimin e dëmit që pretendohet të jetë shkaktuar.<sup>25</sup> Ndërsa në seancën e 15 tetorit, rrjedha e rigjykitimit ka vazhduar me administrimin e provave materiale.<sup>26</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 4,555,553.00 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

## **2. Rasti Ilir Tolaj etj.**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.382/15

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Valbona Musliu-Selimaj

**Prokuror/e:** Florije Salihu-Shamolli (Paraprakisht Admir Shala)

**Të akuzuar:** Ilir Tolaj; Bekim Fusha; Zenel Kuqi; Valentina Haxhija-Pacolli; Remzije Thaçi; Florije Tahiri. Kanë qenë të përfshirë edhe Arion Lleshi dhe Shpend Agani, por të njëjtit kanë arritur marrëveshje për praninë të fajësisë.

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashttrim”, “Përdorimi i paautorizuar i firmës, i markës apo i modelit të huaj”, “Shmangia nga tatimi në bashkëkryerje”.

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të dytë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit kanë kaluar **1, 999 ditë**)

PSRK më 23 prill 2013, kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve në rastin kundër Ilir Tolajt, ish-Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të tjerëve. Më 6 korrik 2015, PSRK kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Ilir Tolajt, Bekim Fushës, Zenel Kuqit, Valentina Haxhijajt, Remzije Thaçit dhe Florije Tahirit për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas PSRK, Ilir Tolaj si Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Bekim Fusha si ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit Farmaceutik në MSH dhe Zenel Kuqi si menaxher i Prokurimit në MSH, gjatë periudhës kohore 23 maj 2011 deri më 31 dhjetor

---

<sup>24</sup> “Shtyhet për shtator rigjykimi ndaj Ferid Aganit, prokurorja s’ishte e përgatitur t’i paraqesë provat materiale”, Betimi për Drejtësi, 25 gusht 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-per-shtator-rigjykimi-ndaj-ferid-aganit-prokurorja-sishte-e-pergatitur-ti-paraqese-provat-materiale/>). (Qasur për herë të fundit më 12 nëntor 2021).

<sup>25</sup> “Rasti “Stenta 1”, përfaqësuesi i Avokaturës Shtetërore thotë se nuk e kanë precizuar dëmin e shkaktuar”, Betimi për Drejtësi, 10 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-perfaqesuesi-i-avokatures-shteterore-thote-se-nuk-e-kane-precizuar-demin-e-shkaktuar/>). (Qasur për herë të fundit më 12 nëntor 2021).

<sup>26</sup> “Prokuroria pa raport mbi CD-të e dorëzuara si provë, ndërpritet seanca e rigjykitimit në rastin “Stenta 1”, Betimi për Drejtësi, 15 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-pa-raport-mbi-cd-te-e-dorezuara-si-prove-nderpritet-seanca-e-rigjykimit-ne-rastin-stenta-1/>).

2011, në bashkëveprim i kanë sjellë përfitime kompanisë “KMI” SHPK Drenas, me pronar Arian Lleshin dhe Shpend Aganin, në vlerë prej 400 mijë eurosh.

Valentina Haxhijaj, Remzije Thaçi dhe Florije Tahiri akuzohen se si anëtare të Komisionit për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të kontratës, i kanë mundësuar kompanisë “KMI” të bëjë manipulim me sasinë e barërave. Me këtë, në vazhdimësi, ato akuzohen se kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Zenel Kuqi akuzohet se si menaxher i prokurimit, gjatë periudhës ndërmjet 23 majit 2011 dhe 31 dhjetorit 2011 i ka tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë materiale nga kompania “ACG” dhe “Standart”, për aktivitetin e prokurimit “Renovimi gjeneral i aneksit të Emergjencës ekzistuese në QKUK”. Kompania “Alb Architect” në aktivitetin e prokurimit “Renovimi gjeneral dhe adaptimi i katit përdhësë në Klinikën Interne, në repartin e ri për dializë në QKUK”, si dhe kompania “Life Farm” për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me infuzione”, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës, në vlerën totale prej 277,307.97 eurove.

Në aktakuzën e njëjtë ishin të përfshirë edhe dy biznesmenët Arion Lleshi dhe Shpend Agani, mirëpo të dy kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorinë. Si rrjedhojë, gjykata i kishte shpallur fajtor dy biznesmenët, duke i dënua me nga dy vjet burgim me kusht dhe me nga 1,000 euro gjobë. Sipas aktgjykimit të GjTh në Prishtinë, të njëjtit, po ashtu obligohen që t’i kthejnë shtetit dëmin e shkaktuar prej 400 mijë eurove. Sipas prokurorisë, Lleshi dhe Agani akuzoheshin se kanë bërë paraqitje të rreme apo kanë fshehur fakte, gjë kjo e cila ka rezultuar në dëmtimin e buxhetit të MSH-së, si dhe të njëjtit i janë shmangur pagimit të tatimeve dhe kontributeve të tjera për punëtorë, të përcaktuara me ligj.

Me 6 qershor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte shpallur të pafajshëm Ilir Tolajn dhe pesë (5) zyrtarët tjerë të MSH-së.<sup>27</sup>

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë në Gjykatën e Apelit kishte ushtruar PSRK. Më 17 tetor 2019, në seancën e mbajtur në Gjykatën e Apelit, PSRK kishte kërkuar që ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Ilir Tolaj dhe pesë zyrtarë të tjerë të kësaj ministrie, të gjykohen sërish për akuzat për korrupsion, në rastin e asgjësimit të barnave pa afat. Por, si të panevojshëm rigjykimin e klientëve të tyre, e kanë parë mbrojtësit e të akuzuarve, të cilët, Gjykatës së Apelit i kanë propozuar që të refuzojë ankesën e PSRK-së dhe të vërtetojë aktgjykimin lirues që e kishte marrë gjykata e shkallës së parë.

Duke aprovuar pjesërisht ankesën e prokurorisë, Apeli e kishte ndryshuar aktgjykimin e Themelores. Apeli e kishte dënua Tolajn me tre (3) vjet burg, Kuqin me dy (2) vjet e (8) muaj burg, dhe Fushën me dy (2) vjet e (4) muaj burg. Kurse, me nga gjashtë (6) muaj burgim me

---

<sup>27</sup>“Ilir Tolaj dhe të tjerët shpallen të pafajshëm për korrupsion në rastin e asgjësimit të barnave pa afat”. Betimi për Drejtësi, 6 qershor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ilir-tolaj-dhe-te-tjeret-shpallen-te-pafajshem-per-korrupsion-ne-rastin-e-asgjesimit-te-barnave-pa-afat/>) Qasur për herë të fundit, 8 maj 2020.

kusht, në një periudhë verifikimi prej një (1) viti, Apeli i kishte dënuar të akuzuarat Valentina Haxhijaj, Florije Tahiri dhe Remzije Thaqi.<sup>28</sup>

Ndërsa, më 21 gusht 2020, Gjykata Supreme ka marr vendim që ta kthej në rivendosje në Gjykatën e Apelit këtë çështje penale, me pretendimin se vendimi i nxjerrë nga shkalla e dytë ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.<sup>29</sup> Pas kthimit të rastit në rivendosje, Apeli për herë të dytë kishte shqyrtuar ankesën e PSRK-së të drejtuar kundrejt aktgjykimit lirues të GjTh në Prishtinë, dhe ankesat e mbrojtjes, të cilët kërkonin refuzimin si të pabazuar të ankesës së prokurorisë, dhe vërtetim të aktgjykimit lirues të shkallës së parë.<sup>30</sup>

Gjykata e Apelit, për dallim nga hera e parë kur e kishte dënuar ish-sekretarin e MSH, Ilir Tolaj, në dhjetor të vitit të kaluar kishte liruar përfundimisht nga akuzat për korrupsion Tolajn dhe të tjerët.<sup>31</sup>

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:**

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Ilir Tolajt dhe të tjerëve ishte caktuar në GjTh në Prishtinë me vonesë prej katër muajsh, respektivisht ishte caktuar më 8 dhjetor 2015. Kjo seancë ishte shtyrë dhe ishte mbajtur vetëm më 20 janar 2016.

Shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 26 shkurt 2016. Edhe shqyrtimi kryesor në këtë rast është caktuar me vonesa, respektivisht mbi gjashtë muaj pas shqyrtimit të dytë. Seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor ishte caktuar më 9 shtator 2016, por e njëjta ishte shtyrë për 15 shtator 2016.

Deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në këtë rast janë caktuar 25 seanca gjyqësore, pesë nga të cilat kishin dështuar.

**Dëmi i pretenduar:** 476,307.97 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka kërkesë

---

<sup>28</sup> “Apeli ndryshon aktgjykimin e Themelores, ish-sekretari i MSh-së Ilir Tolaj dënohet me tre vjet burg efektiv për korrupsion”. Betimi për Drejtësi, 5 shkurt 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ndryshon-aktgjykimin-e-themelores-ish-sekretari-i-msh-se-ilir-tolaj-denohet-me-tre-vjet-burg-efektiv-per-korrupsion/>) (Qasur për herë të fundit, 8 maj 2020).

<sup>29</sup> “Supremja e kthen në Apel për rivendosje lëndën ndaj Ilir Tolajt dhe të tjerëve”, Betimi për Drejtësi, 21 gusht 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-e-kthen-ne-apel-per-rivendosje-lenden-ndaj-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

<sup>30</sup> “Pas kthimit në rivendosje nga Supremja, Gjykata e Apelit sërish shqyrton ankesën e Prokurorisë Speciale në rastin ndaj Ilir Tolajt dhe të tjerëve”, Betimi për Drejtësi, 25 nëntor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rivendosje-nga-supremja-gjykata-e-apelit-serish-shqyrton-ankesen-e-prokurorisë-speciale-ne-rastin-ndaj-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

<sup>31</sup> “Pasi e kishte dënuar herën e parë, Apeli e liron nga të gjitha akuzat për korrupsion Ilir Tolajn”, Betimi për Drejtësi, 24 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pasi-e-kishte-denuar-heren-e-pare-apeli-e-liron-nga-te-gjitha-akuzat-per-korrupsion-ilir-tolajn/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

### **3. Rasti Sami Lushtaku etj.**

#### **Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.18/15

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Beqir Kalludra (Më herët ka qenë gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula)

**Prokuror/e:** Florije Salihu-Shamolli (Më herët ka qenë prokurori i EULEX-it Paul Flynn)

**Të akuzuar:** Sami Lushtaku; Esat Tahiri; Milazim Lushtaku; Driton Pruthi; Arben Gjukaj; Hysni Hoxha; Azem Duraku.

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, “Shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”, “Mashttrim”, “Lidhja e kontratës së dëmshme”.

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të dytë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit kanë kaluar **2,125 ditë**)

Më 2 shtator 2012, ishte ngritur kallëzim penal kundër Kryetarit të Skenderajt, Sami Lushtaku. Më 5 tetor 2012, prokurori i EULEX-it kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimit, kurse më 16 janar 2015 kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Sami Lushtakut, Esat Tahirit, Milazim Lushtakut, Driton Pruthit, Arben Gjukajt, Hysni Hoxhës dhe Azem Durakut për veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit” dhe “mashttrim”.

Ata akuzohen në lidhje me tenderin milionësh për sigurimin fizik të objekteve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Sami Lushtaku akuzohet për veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”, Arben Gjukaj e Hysni Hoxha për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku për veprat penale “mashtrimi” dhe “falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, Driton Pruthi për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit” dhe “lidhja e kontratës së dëmshme”, si dhe Azem Duraku për veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Aktakuza në rastin kundër Sami Lushtakut dhe të tjerëve ishte ngritur me 16 janar 2015. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar dhe mbajtur në kohë rekord, vetëm pas katër ditëve nga ngritja e aktakuzës, respektivisht më 20 janar 2015 dhe shqyrtimi i dytë me 11 shkurt 2015.

Përderisa, shqyrtimi i parë dhe i dytë ishin caktuar dhe mbajtur brenda afateve ligjore të përcaktuara me KPPK, mbajtja e shqyrtimit kryesor në këtë rast ishte shtyrë për më shumë se një vit, duke u mbajtur tek më 24 shkurt 2016.

Kjo lëndë ka kaluar nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula, tek gjyqtari vendor Beqir Kalludra, po ashtu edhe nga prokurori Paul Flynn te prokurorja Florije Salihu-Shamolli.

Nga 24 shkurti i vitit 2016, kur ishte mbajtur seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor, e deri më tash janë caktuar 20 seanca gjyqësore, dhjetë nga të cilat kishin dështuar të mbareshin. Më 2 nëntor 2018, ky gjykim kishte dështuar të mbahej për shkak se kryetari i trupit gjykues Beqir Kalludra, duhej të merrte pjesë në një trajnim të etikës.

Kurse, seanca e paraparë për datën 14 dhjetor 2018 kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së të akuzuarit Sami Lushtaku, për të cilin gjykatësi Kalludra kishte thënë se do të lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim.

Ndërsa, për shkak të mungesës së mbrojtësve të të akuzuarve kishte dështuar të mbahej seanca e paraparë për 9 janar. Kjo për arsye se Oda e Avokatëve të Kosovës kishte hyrë në bojkot të përgjithshëm deri në tërheqjen e urdhëresës dhe rekomandimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që kishte të bëjë me kufizimin e avokatëve dhe palëve të tjera në objektet e gjykatave pa ftesë ose pa leje të kryetarit të gjykatës përkatëse. Seanca e paraparë të mbahej më 23 prill 2019, në të cilën synohej të jepej fjala përfundimtare, kishte dështuar të mbahej për shkak se prokurorja e rastit, Florije Shamolli, nuk ishte e gatshme të jep fjalën përfundimtare pasi sipas saj në PSRK, kanë qenë të angazhuar me rastin e kthimit jashtëzakonshëm të disa qytetarëve të Kosovës nga Siria.

Seanca e fundit që ishte mbajtur në këtë rast është ajo e 3 majit 2019, ku prokuroria kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, kurse, mbrojtësit e të akuzuarve, kishin kërkuar lirimin e tyre nga akuza. Gjithashtu, mbrojtësi i të akuzuarit Esat Tahiri, kishte deklaruar se për njërin nga veprat penale që akuzohet i mbrojturi i tij, e që është “falsifikim i dokumentit” është arritur parashkrimi, andaj ai i kishte propozuar gjykatës që për atë veprë të shqiptojë aktgjykim refuzues.

Pas 34 seancave gjyqësore, prej të cilave 20 ishin mbajtur dhe 14 ishin shtyrë, është caktuar që shpallja e aktgjykimit të mbahet më 20 maj 2019, duke mos respektuar afatin e përcaktuar me ligj, sipas të cilit shpallja e aktgjykimit duhet të bëhet tre ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Më 20 maj, gjykatësi Beqir Kalludra, kishte vendosur që ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe të gjithë të akuzuarit e tjerë të lirohen nga akuzat që rëndojnë mbi ta.<sup>32</sup>

Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Kalludra, nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale më të cilat ngarkohen. Kurse, ndaj Esat Tahirit dhe Milazim Lushtakut, ishte shpallur aktgjykim refuzues për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, me arsyetimin se është arritur parashkrimi absolut. Të njëjtit ishin liruar sa i përket veprës penale të mashtrimit, kurse Tahiri edhe për shtytje për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Gjykatësi Kalludra, në shpalljen e aktgjykimit ishte deklaruar edhe për dëmin në këtë rast, që sipas tij është diskutuar edhe në media. Ai kishte vlerësuar se nuk mund të qëndrojë një aktakuzë e cila nuk ka përcaktuar në mënyrë të saktë vlerën e dëmit, që i është shkaktuar

---

<sup>32</sup> “Sami Lushtaku dhe të tjerët lirohen nga akuzat në rastin KEK 2”. Betimi për Drejtësi, 20 maj 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtaku-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuzat-ne-rastin-e-njohur-kek-2/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

buxhetit të shtetit. “Është fol edhe në media për dëmin, nëse e keni aktakuzën para vete faqja 5 pika 5, shuma 6 milion e 182 mijë, e njëjta faqe pika 3 është 100 mijë. Te pika tjetër është 50.000 mijë. Ju lutem shumë, kjo nuk duhet me ndodh. 6 milion është vlera e tenderit, dëmi duhet te ishte diferenca mes kompanive. Nuk mund të qëndroj një aktakuzë e tillë diku 100 mijë diku 6 milion”, kishte thënë gjykatësi në arsyetimin e tij pas shpalljes së aktgjykimit.

Pas ankesës së PSRK-së, rasti ka kaluar në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit në nëntor të vitit të kaluar kishte nxjerrë vendim me të cilin e kishte vërtetuar aktgjykimin lirues të nxjerrë në shkallë ndaj Lushtakut dhe të tjerëve. Sipas Apelit, nga provat që ishin administruar në shkallë të parë, me të drejtë kjo e fundit kishte konstatuar se nuk janë konsumuar elementet e veprave penale që u viheshin në barrë të akuzuarve<sup>33</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 6,182,609.76 euro.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

#### **4. Rasti Jeton Menxhiqi etj.**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.98/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Alltën Murseli (Më parë gjykuar nga Beqir Kalludra)

**Prokuror/e:** Fitore Sadikaj

**I akuzuar:** Jeton Menxhiqi.

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **975 ditë**)

Ndryshe, pas një muaji e gjysmë të transmetimit të emisionit “Betimi për Drejtësi” për korrupsionin në prokurimin e Policisë së Kosovës, ku ishte përfshirë zyrtari policor Jeton Menxhiqi, Prokuroria Themelore në Prishtinë, në prill të vitit 2019, ka ngritur aktakuzë për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Sipas aktakuzës së ushtruar më 2 prill 2019 thuhet se më 8 gusht 2017, në ndërtesën e Policisë së Kosovës në Prishtinë, i pandehuri Jeton Menxhiqi, në cilësinë e personit zyrtar, si anëtar i komisionit në tenderin “Furnizim me rroba elegante”, në numër të prokurimit 214/17/048/111, i cili përfaqësonte Drejtorinë e Hetimeve Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, ka shfrytëzuar detyrën zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër.

Në aktakuzë thuhet se rasti ka ndodhur në atë mënyrë që në tenderin “Furnizim me rroba elegante”, i paraparë në vlerë prej 730 mijë euro, komisioni gjatë punës në përbërje nga i

---

<sup>33</sup> “Rasti “KEK 2”, Apeli vërteton aktgjykimin lirues për Sami Lushtakun dhe të tjerët”, Betimi për Drejtësi, 9 nëntor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-kek-2-apeli-verteton-aktgjykimin-lirues-per-sami-lushtakun-dhe-te-tjeret/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

pandehuri Menxhiqi, Sabide Beqiri dhe Naim Lahu, pas kontrollit kishin konstatuar se asnjëri nga operatorët ekonomikë, nga tetë sa kishin konkurruar, nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara në tender.

Gjithnjë sipas aktakuzës, atëherë i pandehuri me qëllim që t'i bëjë të mundur operatorit ekonomik "Artius Group SHPK", që ta fitojë tenderin edhe pse nuk i kishte plotësuar kushtet, më 8 gusht 2017 derisa ishte duke qëndruar në një zyrë me çelësin mbi tavolinë dhe në mënyrë të kundërligjshme, pa prezencën e anëtarëve të tjerë të komisionit, e në kohë të pauzës shkon në Zyrën e Prokurimit merr paketën e "Artius Gropu", ndërron mostrat e rrobave elegante dhe i vendos mostrat e tjera, të cilat i kishte sjellë nga jashtë me një çantë krahu dhe pas pak e kthen paketën në Zyrën e Prokurimit.

Në aktakuzë thuhet se i pandehuri kishte vepruar në këtë mënyrë me qëllim që "Artius Group", të fitonte tenderin në mënyrë të kundërligjshme në vlerë prej 506 mijë e 216 euro e 20 centë.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me rastin trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës në këtë rast më 2 prill 2019, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte tentuar të mbahej më 10 qershor 2020, apo 436 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Mirëpo, kjo seancë nuk kishte arritur të mbahej, për shkak të mungesës së të akuzuarit Menxhiqi.<sup>34</sup>

Seanca fillestare në këtë çështje penale arriti të mbahej më 30 mars 2021, në të cilën seancë Menxhiqi u deklarua i pafajshëm për veprën që i vihej në barrë. Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 12 maj 2021, ku mbrojtja kishte kërkuar hudhjen e aktakuzës.

Më pas, Gjykata Themelore në Prishtinë në maj të këtij viti, e kishte refuzuar kërkesën për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit Menxhiqi. Kundër këtij vendimi, mbrojtja brenda afatit ligjor kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, me ç'rast kjo e fundit e ka refuzuar ankesën si të pabazuar.<sup>35</sup> Aktualisht, gjykata po procedon me dëgjimin e dëshmitarëve.

**Dëmi i pretenduar:** 506,216.20 Euro.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>34</sup> "Dështon të nis gjykimi për tenderin e rrobave në Polici, aktakuza e të cilit rast ishte ngritur pas transmetimit të hulumtimit të "Betimi për Drejtësi", Betimi për Drejtësi, 10 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-te-nis-gjykimi-per-tenderin-e-rrobave-ne-polici-aktakuza-e-te-cilit-rast-ishte-ngritur-pas-transmetimit-te-hulumtimit-te-betimi-per-drejtesi/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2021).

<sup>35</sup> "Konfirmohet aktakuza për korrupsion me tenderin e rrobave në Polici, e cila ishte ngritur pas transmetimit të hulumtimit të "Betimi për Drejtësi", Betimi për Drejtësi, 16 korrik 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-per-korrupsion-me-tenderin-e-rrobave-ne-polici-e-cila-ishte-ngritur-pas-transmetimit-te-hulumtimit-te-betimi-per-drejtesi/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2021).

## **5. Rasti Durim Sheremeti etj.**

**Gjykata Themelore në Pejë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.108/21

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Sami Sharaxhiu

**Prokuror/e:** Agron Galani

**Të akuzuar:** Durim Sheremeti; Gëzim Shala; Gëzim Lajqi; Ruzhdi Zhara; Ilir Kelmendi

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashttrim”

**Faza e procedurës:** Rigjykim.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **917 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 30 maj 2019, Durim Sheremeti akuzohet se ka nënshkruar raportin për pranimin e mallit, lidhur me tenderin për blerjen e makinës për mirëmbajtjen e barit artificial për Qendrën Sportive në Brestovik në Pejë, në vlerë prej 11 mijë e 929.41 euro, pa pasur mandat dhe kompetencë për të nënshkruar. Në aktakuzë thuhet se ai kishte nënshkruar pranimin e mallit në emër të Organit Mbikëqyrës –menaxherit të projektit Faik Zekaj, pa pasur kompetencë për këtë edhe pse me vendim të Kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri, menaxher i projektit për këtë tender ishte Faik Zekaj.

Sipas aktakuzës, menaxheri i projektit për tender Faik Zekaj, kishte refuzuar të nënshkruajë këtë pranim, pasi ai kishte qenë në dijeni se makina e barit që është sjellë nga operatori ekonomik nuk është sipas projektit të kërkesës, parametrave dhe specifikave të përcaktuara në tender. Aktakuza përshkruan se makina e barit e sjellë nga operatori ekonomik, ishte në vlerë prej dymijë euro dhe me këtë veprim është dëmtuar buxheti i Komunës për shumën prej 9.929.41 euro, duke i mundësuar përfitim operatorit ekonomik, këtu të pandehurit Ilir Kelmendi, shumën prej 9 mijë 929.41 euro.

Dispozitivi i dytë i aktakuzës i ngarkon zyrtarët komunalë Gëzim Lajqi, Ruzhdi Zhara dhe Gëzim Shala, se me 19 shtator 2017, si zyrtarë komunalë në Komunën e Pejës, në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranimin e mallit, lidhur me tenderin për makinën e barit, me dashje nuk i përmbushin detyrat e tyre zyrtare. Sipas aktakuzës, ata pa pasur një vendim në formë të shkruar se janë caktuar anëtarë të komisionit për pranimin e mallit lidhur me tenderin “Kontratë, Blerja e Makinës për Mirëmbajtje të Barit Artificial për Qendrën Sportive Brestovik” dhe të njëjtit nuk kishin kontrolluar fare nëse malli (furnizimi) i pranuar i plotësonte kushtet e specifikuara në kontratë dhe atë pa prezencën e menaxherit të projektit Faik Zekaj dhe pa prezencën e operatorit fitues, nënshkruajnë pranimin e mallit të makinës.

Sipas aktakuzës, të pandehurit nënshkruajnë pranimin e mallit edhe pse kanë qenë në dijeni se ata duhet të bëjnë verifikimin nëse makina e barit e sjellë nga operatori ekonomik i plotësonte kushtet në kontratë dhe në vlerë monetare, me ç’rast i shkaktojnë dëm Komunës se Pejës, 9 mijë e 929.41 euro, kurse përfitimin biznesmenit Ilir Kelmendi, në shumë prej 9 mijë 929.41 euro. Kurse, i pandehuri Ilir Kelmendi, akuzohet nga Prokuroria Themelore në Pejë se ka kryer veprën penale të mashtimit, ashtu që si pronar firmës “Green Construcion-Shpk”, duke paraqitur fakte të rreme të me qëllim të përfitimit ë kundërligjshëm të dobisë pasurore.

Sipas aktakuzës, pasi i pandehuri Kelmendi kishte fituar tenderin nga Komuna e Pejës, ai nuk i përmbahet kushteve të tenderit ku në shënimin e Komunës së Pejës është paraparë vendi i origjinës së makinës të jetë Turqia dhe firma e makinës së barit të jetë prodhuese e “Uçegen Firça”, ashtu që ai nuk e ka sjellë makinën sipas kontratës së firmës “Uçegen Firça”, por të firmës “Alpina”, e cila sipas aktakuzës, makina e barit e sjellë nga i pandehuri ishte me çmim të tregut prej dy mijë euro dhe nuk ka ofruar as dorëzuar dëshmi për blerjen e makinës dhe me këtë veprim i ka shkaktuar dëm Komunës së Pejës, prej 9.929.41 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me rastin trajtimin e rastit**

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar nga ana e Policisë së Kosovës më 29 tetor 2018. Ndërsa, aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë më 26 shkurt 2019. Aktakuza ishte ngritur më 30 maj 2019.

Shqyrtimi fillestar ishte caktuar fillimisht të mbahej më 29 gusht 2019, mirëpo kishte dështuar të mbahet pasi kishte munguar përfaqësuesi i Komunës së Pejës si palë e dëmtuar.<sup>36</sup> Pas kësaj shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 1 tetor 2019, apo 125 ditë pas afatit ligjor prej 30 ditëve që parashihet të mbahet shqyrtimi fillestar pas ngritjes së aktakuzës.<sup>37</sup> Kurse, shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 5 nëntor 2019. Pasi që shkalla e parë më 6 nëntor 2019, kishte refuzuar kërkesat për hudhje të aktakuzës, të akuzuarit ishin ankuar në Gjykatën e Apelit. Megjithatë, edhe shkalla e dytë e kishte lënë në fuqi aktakuzën.

Pas vendimit të Apelit, shqyrtimi gjyqësor ishte caktuar të mbahet më 25 shkurt 2020, mirëpo seanca në fjalë ishte shtyrë me kërkesën e mbrojtjes së të akuzuarit Sheremeti i cili kishte kërkuar më shumë kohë për të përgatitur mbrojtjen.<sup>38</sup> Seancat tjera ishin caktuar për 2 dhe 3 prill 2020, mirëpo edhe ato janë shtyrë shkakui i pandemisë së Covid-19.

Procesi gjyqësor ndaj Sheremetit dhe të tjerëve mori epilog më 1 mars 2021, me ç’rast këta të akuzuar u shpallën fajtorë për korrupsion nga Gjykata Themelore në Pejë. Ndaj Sheremetit, kjo gjykatë ka shqiptuar gjashtë muaj burgim efektiv, me mundësi që i njëjti të shndërrohet në gjobë në shumën prej 7,000 euro. Krahas burgimit, Sheremetit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratë për dy vite. Të akuzuarit Lajqi, Zhara dhe Shala u dënuan me nga 6 muaj burgim me kusht, në afat verifikimi prej 1 viti. Kurse, Kelmendi u dënua me 6 muaj burgim dhe 2 mijë euro gjobë, ku me pëlqimin e tij, dënimi me burgim u shndërrua në dënim me gjobë në shumën prej 5 mijë euro.<sup>39</sup> Por, të pakënaqur me

---

<sup>36</sup> “Dështon të nis gjykimi ndaj shefit të kabinetit të Kryetarit të Pejës dhe tre zyrtarëve tjerë komunal” Betimi për Drejtësi, 27 gusht 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-te-nis-gjykimi-ndaj-shefit-te-kabinetit-te-kryetarit-te-pejes-dhe-tre-zyrtareve-tjere-komunale/>). Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>37</sup> “Gjykimi për blerjen e kosës për bari, shefi i kabinetit të Kryetarit të Pejës dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi, 1 tetor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-blerjen-e-koses-per-bari-shefi-i-kabinetit-te-kryetarit-te-pejes-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). Qasur për herë të fundit, 8 maj 2020.

<sup>38</sup> “Kërkohet kohë për përgatitjen e mbrojtjes, shtyhet gjykimi ndaj zyrtarëve të Pejës”. Betimi për Drejtësi, 25 shkurt 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kerkohet-kohe-per-pergatitjen-e-mbrojtjes-shtyhet-gjykimi-ndaj-zyrtareve-te-pejes/>). Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>39</sup> “Shpallen fajtorë ish-shefi i Kabinetit të Kryetarit të Pejës dhe tre zyrtarët komunalë të akuzuar për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 1 mars 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-fajtores-ish-shefi-i-kabinetit-te-kryetarit-te-pejes-dhe-tre-zyrtaret-komunale-te-akuzuar-per-korrupsion/>).

këto dënime kishin mbetur mbrojtja e të akuzuarve, Sheremeti dhe Kelmendi, kurse me lartësinë e dënimit për Sheremetin edhe Prokuroria Themelore në Pejë. Seanca në Gjykatën e Apelit për këtë rast ishte mbajtur më 21 maj të këtij viti, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Në qershor të këtij viti, Gjykata e Apelit e kishte kthyer këtë rast në rigjykim.<sup>40</sup> Seanca e parë pas kthimit të rastit në rigjykim ishte caktuar për datën 16 shtator, por e njëjta ishte anuluar për shkak të situatës së krijuar me pandeminë.<sup>41</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 9,929.41 euro

**Sekuestrimi dhe konfiskimi:** Nuk ka informacion.

## 6. Rasti Ismet Mazreku

**Gjykata Themelore në Gjakovë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.152/20

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Nikollë Komani

**Prokuror/e:** Ramiz Buxhala

**I akuzuar:** Ismet Mazreku

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim nga Gjykata Supreme.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në vendimin e Gjykatës Supreme kanë kaluar **902 ditë**)

Prokuroria Themelore në Gjakovë, më 13 mars 2019 kishte ngritur aktakuzë ndaj Ismet Mazreku, i cili akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, shef i Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të kundërligjshme të dobisë pasurore për vete apo tjetrin.

Në aktakuzë thuhet se në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, me rastin e inicimit të “kërkesës për furnizim me kablllo elektrike” për nevojat e fshatit Gajrak të Komunës së Malishevës, dhe menaxhimit të kontratës së prokurimit, në vlerë prej 8.728.90 euro, nga kompania N.T.SH “Leoni” me seli në Malishevë, të cilën edhe pse e ka pranuar, duke konfirmuar në bazë të raportit të 27 tetorit 2015, nuk vërtetohet se e njëjta është investuar në fshatin Gajrak të Komunës së Malishevës.

Gjykata Themelore në Gjakovë, më 20 janar 2020, e kishte shpallur fajtor të akuzuarin Ismet Mazreku dhe të njëjtin e kishte dënuar me gjashtë (6) muaj burgim. Pas shpalljes së aktgjykimit, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim i ishte zëvendësuar me gjobë në shumën prej

---

[shefi-i-kabinetit-te-kryetarit-te-pejes-dhe-tre-zyrtaret-komunale-te-akuzuar-per-korrupsion/](#). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

<sup>40</sup> “Apeli e kthen në rigjykim rastin ku ish-shefi i kabinetit të kryetarit të Pejës dhe tre zyrtarë komunal akuzohen për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 17 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-ku-ish-shefi-i-kabinetit-te-kryetarit-te-pejes-dhe-tre-zyrtare-komunal-akuzohen-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 12 nëntor 2021).

<sup>41</sup> “Shkaku i pandemisë, anulohet seanca ndaj ish-shefit të kabinetit të kryetarit dhe tre zyrtarëve në Pejë”, Betimi për Drejtësi, 16 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shkaku-i-pandemise-anulohet-seanca-ndaj-ish-shefit-te-kabinetit-te-kryetarit-dhe-tre-zyrtareve-ne-pejes/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

3400 euro. I akuzuari Mazreku ishte obliguar që të dëmtuarën, përkatësisht Komunës së Malishevës, t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën prej 8,728.90 euro.<sup>42</sup>

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me rastin trajtimin e rastit**

Agjencia Kundër Korrupsion kishte ushtruar kallëzim penal ndaj të akuzuarit Mazreku më 23 korrik 2018. Aktvendimi për fillim të hetimeve në këtë rast ishte nxjerrë më 22 gusht 2018. Ndërsa, aktakuza ishte ngritur nga ana e prokurorit Ramiz Buzhala më 13 mars 2019.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte caktuar të mbahej më 18 prill 2019, apo gjashtë (6) ditë pas afatit ligjor të paraparë. Megjithatë, edhe ajo seancë kishte dështuar të mbahet pasi kishte munguar mbrojtësi të akuzuarit.<sup>43</sup> E njëjta, ishte mbajtur pastaj të nesërmen, me 19 prill 2019 ku Mazreku ishte deklaruar i pafajshëm për akuzën me të cilën ngarkohej.

Shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 25 maj 2019, ku mbrojtja kishte kërkuar hudhjen e aktakuzës, kërkesë kjo që ishte refuzuar nga ana e gjykatës. Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar me 2 shtator 2019 ndërsa deri në shpalljen e aktgjykimi ishin mbajtur pesë (5) seanca gjyqësore.

Fillimisht, Gjykata Themelore në Gjakovë e kishte dënuar Mazrekun me gjashtë muaj burgim, ish-shefin e Shërbimeve Publike në Malishevë. Por ky dënim me pëlqimin e të akuzuarit ishte zëvendësuar me gjobë në lartësi 3,400 euro.<sup>44</sup> Më pas, ky vendim ishte vërtetuar edhe në shkallë të dytë, në qershor të vitit 2020.<sup>45</sup>

Ndërsa, Gjykata Supreme në korrik të vitit të kaluar, kishte anuluar aktgjykimet e nxjerra nga themeloria dhe apeli, duke e kthyer kështu rastin në rivendosje në shkallë të parë. Edhe pas rigjyimit, GjTh në Gjakovë më 21 dhjetor 2020 kishte shpallur aktgjykim dënues ndaj Mazrekut, i cili pas rikualifikimit të veprës penale, u dënua për falsifikim të dokumentet zyrtar. Ndaj tij, së pari u shqiptua dënimi prej 6 muajve burg, por i cili me pëlqimin e të akuzuarit u zëvendësua me gjobë në shumën prej 3,400 euro.<sup>46</sup> Ky aktgjykim i nxjerrë në shkallë të parë ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 29 janar 2021. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, ndërsa pas shqyrtimit të së

---

<sup>42</sup> “Ish-zyrtari i Malishevës dënohet me 3400 euro gjobë për kabllon elektrike të vendosur në fshatin Gajrak”. Betimi për Drejtësi, 20 janar 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zyrtari-i-malisheves-denohet-me-3400-euro-gjobe-per-kabllon-elektrike-te-vendosur-ne-fshatin-gajrak/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>43</sup> “Dështon seanca ndaj ish-Shefit të Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës”. Betimi për Drejtësi, 18 prill 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-seanca-ndaj-ish-shefit-te-sherbimeve-publike-ne-komunen-e-malisheves/>) Qasur për herën e fundit më 8 maj 2020.

<sup>44</sup> “Ish-zyrtari i Malishevës dënohet me 3400 euro gjobë për kabllon elektrike të vendosur në fshatin Gajrak”, Betimi për Drejtësi, 20 janar 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zyrtari-i-malisheves-denohet-me-3400-euro-gjobe-per-kabllon-elektrike-te-vendosur-ne-fshatin-gajrak/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

<sup>45</sup> “Apeli vërteton dënimin ndaj ish-shefit të Shërbimeve Publike në Malishevë lidhur me kabllon e vendosur në fshatin Gajrak”, Betimi për Drejtësi, 11 qershor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-ndaj-ish-shefit-te-sherbimeve-publike-ne-malisheve-lidhur-me-kabllon-e-vendosur-ne-fshatin-gajrak/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

<sup>46</sup> “Pas rigjyimit, dënohet sërish me 3 mijë e 400 euro gjobë ish-shefi i Shërbimeve Publike në Malishevë”, Betimi për Drejtësi, 21 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjyimit-denohet-serish-me-3-mije-e-400-euro-gjobe-ish-shefi-i-sherbimeve-publike-ne-malisheve/>). (Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021).

njëjtës, Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj të datës 30 gusht 2021 ka refuzuar si të pabazuar të njëjtën.

**Dëmi i pretenduar:** 8,728.90 euro

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka pasur kërkesë.

## **7. Rasti Islam Vrenezi etj.**

**Gjykata Themelore në Gjakovë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.70/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Drilon Haraçia (Më parë gjykuar nga Mentor Bajraktari)

**Prokuror/e:** Ramiz Buxhala

**Të akuzuar:** Islam Vrenezi; Januz Krasniqi; Jakup Shurdhaj; Besnik Krasniqi; Valdete Morina; Qlirim Karaqica; Remzi Mazreku

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Falsifikim i dokumentit zyrtar”; “Veprimtari e pandërgjegjshme ekonomike”

**Faza e procedurës:** Në proces.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **716 ditë**)

Prokuroria Themelore në Gjakovë, më 17 dhjetor 2019, kishte ngritur aktakuzë me të cilën, i akuzuari Remzi Mazreku po ngarkohet me veprën penale “veprimtari e pandërgjegjshme ekonomike” nga neni 285, paragrafi 1 të KPRK-së. Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, i akuzuari Remzi Mazreku gjatë muajit tetor të vitit 2018, në Malishevë, në cilësi të operatorit ekonomik N.T “Flamuri”, me dashje ka shkelur ligjin e afarizmit, duke vepruar në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit. Siç thuhet në aktakuzë, ai këtë e ka bërë në atë mënyrë që pasi që e ka fituar kontratën më 29 tetor 2018, nga Komuna e Malishevës për kryerjen e punimeve të kanalizimit në fshatin Balincë dhe lagjen “Veselaj” të Malishevës, nuk i kanë përmbushur kushtet e kërkuara sipas kontratës, duke mos i kryer punimet sipas kriterëve të kërkuara në kontratë, ashtu që janë vendosur gypa të plastikës, jo të brinjëzuara, nuk është mbuluar me dhe të gërmuar gypi PE/315 i vendosur dhe i përforcuar për betoni, në gjatësi 12 metra, puseta nuk është mbuluar me kapakë betoni, nuk janë vendosur kapakët metalikë gizës /600 me kapacitet 40 ton, nuk është bërë rregullimi i vendpunishtes pas përfundimit të punimeve, si dhe punë tjera të pakryera, me ç’rast Komunës së Malishevës i ka shkaktuar dëm në shumën prej 9,870.18 euro.

Sipas aktakuzës, më 16 nëntor 2018, në Malishevë, i akuzuari tjetër, Januz Krasniqi në cilësinë e kryetarit, ndërsa të akuzuarit Jakup Shurdhaj dhe Besnik Krasniqi në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për pranimin e punimeve në rrjetin e kanalizimit në fshatin Balincë dhe lagjen “Veselaj” të Malishevës, të caktuar sipas vendimit të kryetarit të Komunës së Malishevës të 15.11.2018, në dokumentin zyrtar- Raportin e Pranimi Teknik të 16.11.2018, kanë shënuar të dhëna të rreme duke vërtetuar se është përmbushur kontrata me operatorin ekonomik N.T “Flamuri”, sipas përmasave dhe kontratës së kontraktuar, dhe projekti i kanalizimit i plotëson kushtet për përdorim, sipas kriterëve të kërkuara me kontratën e lidhur në mes të Komunës së

Malishevës dhe N.T “Flamuri” edhe pse punët në vendpulishte nga operatori ekonomik nuk janë kryer siç janë përshkruar në dispozitivin një të aktakuzës. Për këtë, po akuzohen se kanë kryer veprën penale “falsifikimi i dokumentit zyrtar”, nga neni 434 parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, më 9 nëntor 2018 në Malishevë, i akuzuari Islam Vranezi në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Malishevës, dhe e akuzuara Valdete Morina, në cilësinë e menaxheres së projektit të kanalizimit në fshatin Balincë dhe lagjen “Veselaj”, në dokumentin zyrtar-Raportin e Kryerjes së Punimeve, kanë shënuar të dhëna të rreme duke vërtetuar se pas daljes në terren në fshatin Balincë dhe lagjen “Veselaj” janë realizuar punimet në bazë të projektit të kontratës dhe planit dinamik nga operatori ekonomik N.T “Flamuri”, duke rekomanduar që operatori ekonomik në fjalë t’i bëhet pagesa për realizimin e këtyre punimeve në shumën prej 9,870.18, edhe pse e pandehura Morina ishte në pushim vjetor nuk kishte dalë në vendpulishte edhe pse punët në terren nga operatori ekonomik nuk janë kryer siç janë përshkruar në dispozitivin një të aktakuzës. Për këtë, po akuzohen se kanë kryer veprën penale “falsifikim i dokumentit zyrtar”, nga neni 434, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Ndërsa, sipas aktakuzës, i akuzuari Qlirim Karaqica po akuzohet se më 12 shkurt 2018, në cilësinë e zyrtarit në Drejtorinë për Urbanizëm në Malishevë ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, duke i tejkaluar kompetencat e tij, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete dhe për të tjerët. Siç thuhet në aktakuzë, ai këtë e ka bërë në atë mënyrë që duke vepruar në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit për Prokurimin Publik, edhe pse ishte i obliguar që para se të bëjë paramasën dhe paralogarinë të del në terren dhe të shikojë terrenin ku do të kryhen punimet, i pandehuri e bën paramasën dhe paralogarinë për shpurje horizontale të rrugës për kalimin e gypit të kanalizimit apo të ujërave atmosferike në gjatësi prej 55 metra, duke bërë paralogarinë prej 3500 euro tek nënkalimi në vendin ku ka ekzistuar shpurja horizontale edhe më parë, me ç’rast Komunës së Malishevës i ka shkaktuar dëm material rreth 3500 euro. Për këtë, po akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafi 1 pika 2.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimi fillestar të mbajtur më 25 shkurt 2020, të gjithë të akuzuarit kishin mohuar akuzat me të cilat ngarkohen. Në këtë seancë, mbrojtësi i të akuzuarit Mazreku kishte propozuar që lënda për sa i përket të mbrojturit të tij të shkojë në procedurë të ndërmjetësimit mirëpo, një kërkesë e tillë ishte kundërshtuar nga ana e prokurorit Bajraktari me arsyetimin se vepra penale për të cilën akuzohet Mazreku, nuk hyn në kuadër të veprave penale për të cilat mund të shkohet në ndërmjetësim. Pas kundërshtimit të prokurorit, propozimi i mbrojtjes ishte refuzuar.<sup>47</sup>

## **Gjetjet e IKD-së lidhur me rastin trajtimin e rastit**

---

<sup>47</sup> “Drejtori i Urbanizmit në Malishevë dhe zyrtarët tjerë komunal mohojnë akuzat për korrupsion” Betimi për Drejtësi, 25 shkurt 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-i-urbanizmit-ne-malisheve-dhe-zyrtaret-e-tjere-komunale-mohojne-akuzat-per-korrupsion/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

Lidhur me këtë rast, Policia e Kosovës kishte ushtruar kallëzim penal më 29 mars 2019. Aktvendimi për fillim të hetimeve nga ana e prokurorisë ishte nxjerr më 21 maj 2019.

Prokurori Ramiz Buzhala, e kishte ngritur aktakuzën për këtë rast më 17 dhjetor 2019. Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 25 shkurt 2020, apo 39 ditë pas afatit ligjor prej 30 ditë brenda të cilit duhet të mbahet shqyrtimi fillestar pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë.

Kjo aktakuzë për korrupsion e ngritur ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Malishevës, Islam Vrenezi, dhe zyrtarëve komunalë, Januz Krasniqi, Jakup Shurdhaj, Besnik Krasniqi dhe Qlirim Karaqica, ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit, më 9 qershor 2020. Aktakuza është konfirmuar edhe ndaj të akuzuarit për veprimtari të pandërgjegjshme ekonomike, Remzi Mazreku. Apeli, pra kishte vërtetuar vendimin e nxjerrë në shkallë të parë me të cilat ishin refuzuar kërkesat për hedhje të aktakuzës.

Ndërkaq, kjo aktakuzë ishte hedhur poshtë sa i përket të akuzuarës për falsifikim të dokumentit zyrtar në bashkëkryerje, Valdete Morina, vendim ky i konfirmuar nga Apeli dhe nga Gjykata Supreme, me ç'rast kjo e fundit kishte refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.<sup>48</sup> Që nga konfirmimi i kësaj aktakuze në nëntor të vitit 2020 e deri më tani, kur kanë kaluar më shumë se një vit, Gjykata Themelore në Gjakovë nuk ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në këtë çështje penale. Fakti se për një periudhë kaq të gjatë kohore nuk është proceduar me trajtimin e kësaj lënde, përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të realizuar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Që nga janari i vitit 2021 kjo lëndë i është bartur gjykatësit Drilon Haraçia, i cili akoma nuk ka proceduar me shqyrtimin gjyqësor të kësaj çështje penale.

**Dëmi i pretenduar:** 13,370.18 euro

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka pasur kërkesë.

## **8. Rasti Vehbi Braha**

**Gjykata Themelore në Mitrovicë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.117/2018

**Kryetar/e i Trupit Gjyqësor:** Bekim Veliqi

**Prokuror/e:** Njazi Rexha

**Të akuzuar:** Vehbi Braha

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”;

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të dytë.

---

<sup>48</sup> “Konfirmohet aktakuza ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit në Malishevë dhe të tjerëve, hedhet poshtë për njëzën zyrtare”, Betimi për Drejtësi, 16 nëntor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizmit-ne-malisheve-dhe-te-tjereve-hedhet-poshte-per-njeren-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 2 mars 2021).

(Nga ngritja e aktakuzës deri në Aktgjykimin e GjA, kanë kaluar 598 ditë)

Prokuroria Themelore në Mitrovicë më 31 tetor 2018, kishte ngritur aktakuzë me të cilën Vehbi Braha, po akuzohet se në cilësinë e zyrtarit të lartë financiar në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit në Mitrovicë, ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në vazhdim.

Sipas aktakuzës, më 8 gusht 2014, në cilësinë e zyrtarit të lartë financiar në këtë kompani, ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, duke i lejuar Driton Abazit blerjen e dy gomave të brendshme të ekskavatorit dhe mjete të tjera në vlerë prej 1.784.00 euro në D.P.Z “Merovci” në Mitrovicë, pa procedurë të prokurimit, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, ku përcaktohet se furnizimet/shërbimet mund të paguhen më para të gatshme kur vlera e tyre nuk e tejkalon totalin prej 100 euro.

Ndërkaq, në pikën II të aktakuzës, ai akuzohet se më 15 korrik 2014, në cilësinë e njëjtë zyrtare, në bazë të kontratës për shërbime të telefonisë mobile të nënshkruar ndërmjet kompanisë “IPKO” dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit në Mitrovicë, si abonues, nga “IPKO” është bërë dorëzimi i gjashtë telefonave të llojit “Samsung Galaxy S4” dhe 200 telefona të llojit “Samsung E 1200” në vlerë totale prej 6.102.00 euro, në kuadër të marrëveshjes së arritur, pa procedurë të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik nr.04/L-42, ku përcaktohet se furnizimet/shërbimet mund të paguhen në para të gatshme kur vlera e tyre nuk e tejkalon totalin prej 100 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës më 15 shkurt 2016 kishte ushtruar kallëzim penal ndaj të akuzuarit Braha. Më 13 qershor 2018, prokuroria kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj tij. Kurse, më 31 tetor 2018, prokuroria kishte ngritur aktakuzën ndaj Brahës.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 17 janar 2019, apo 47 ditë pas afatit ligjor prej 30 ditë, brenda të cilit duhet të mbahet shqyrtimi fillestar pas ngritjes së aktakuzës.

Në këtë rast, prokurori Njazi Rexha, kishte rikualifikuar veprën penale nga dy vepra të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, në atë të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në vazhdim.

Pas mbajtjes së pesë (5) seancave gjyqësore, Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 13 janar 2020, e kishte shpallur fajtor dhe e kishte dënuar me 2,000 euro të akuzuarin Braha. Fillimisht, i akuzuari Braha ishte dënuar me gjashtë (6) muaj burg, mirëpo me kërkesën e tij, gjykata ia ka zëvendësuar dënimin me burg në dënim me gjobë.<sup>49</sup>

---

<sup>49</sup> “Ish-zyrtari në KRU “Mitrovica” dënohet me gjobë për dy kontrata të lidhura pa procedura tenderuese”, Betimi për Drejtësi, 13 janar 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zyrtari-ne-kru-mitrovica-denohet-me-gjobe-per-dy-kontrata-te-lidhura-pa-procedura-tenderuese/>). (Qasur për herë të fundit më 21.04.2021).

Ky dënim i shqiptuar në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, sipas vendimit të nxjerrë më 19 qershor 2020.

**Dëmi i pretenduar:** IPKO ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike, ndërsa K.R.U Mitrovica, është udhëzuar në kontest civil (nuk ka pasur saktësim të vlerës së dëmit)

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka pasur kërkesë.

## **9. Rasti Hasan Shala etj.**

**Gjykata Themelore në Mitrovicë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr. 82/16

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Beqir Halili

**Prokuror/e:** Ismet Ujkani

**Të akuzuar:** Hasan Shala dhe Sanije Ahmeti.

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Mashtrimi në detyrë”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të dytë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit kanë kaluar **1,436 ditë**)

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ngritur më 15 korrik 2016, Hasan Shala, në cilësinë e drejtorit të Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Skenderajt, si dhe Sanije Ahmeti si inxhinierë e arkitekturës në këtë drejtori, po akuzohen se duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar kanë tejkalluar kompetencat e tyre me qëllim që të përfitojë dobi pasurore personi tjetër dhe atë organizata e biznesit NNSH” ILEAA-GR”. Bazuar në aktakuzë, e akuzuara Sanije Ahmeti si mbikëqyrëse e punimeve të projektit për rregullimin e parkut “Te pishat” në Skenderaj më 28 shtator 2011, ka kërkuar nga zyra e prokurimit që të bëhet riformatimi- ndryshimi i pozicioneve të parapara me kontratën numër 643-11-033-521 të datës 21 korrik 2011. Kontratë, kjo e cila sipas aktakuzës, ishte e nënshkruar në mes Komunës së Skenderajt dhe kompanisë NNSH” ILEAA-GR” në Skenderaj, për rregullimin e pishave të parkut në Skenderaj në vlerë prej 88.004,00 euro.

Kurse, i akuzuari Hasan Shala, sipas aktakuzës, më 4 tetor 2011, ka marr vendim me anë të së cilit është aprovuar kërkesa, duke ndryshuar pozicionet e punës së rrethojës të parapara me kontratë me zëvendësimin e platosë më kubeja dhe murit mbrojtës për punime në terren edhe pse kompania NNSH” ILEAA-GR” kishte filluar realizimin e punëve sipas kontratës. Në vazhdim të aktakuzës, thuhet se ndryshimi i pozicioneve në paramasë nuk lejohet dhe se implementimi është dashur të bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me kontratën e nënshkruar dhe asnjë kusht i kontratës nuk duhej ndryshuar pas nënshkrimit të saj.

Me këtë organi i akuzës i ngarkon me veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar” nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, Sanije Ahmeti akuzohet edhe se si inxhinierë e arkitekturës në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në Komunën e Skenderajt, me qëllim të përfitimi të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo kompaninë NNSH” ILEAA-GR” në Skenderaj ka bërë prezantimin e rremë të raporteve të datës 12 dhjetor 2011, mbi përfundimin e punëve

në rregullimin e parkut te pishat në Skenderaj duke cekur se punët janë kryer ashtu siç është paraparë me kontratë. Në aktakuzë thuhet se e akuzuara në fjalë ka vënë në lajthim personat e autorizuar zyrtar në kryerjen e pagesave në shumën prej 80.190,00 euro, si dhe në shumën prej 7.814,00 euro edhe pse kompania NNSH “ILEAA-GR” nuk i kishte përfunduar punët ashtu siç ishte paraparë me kontratë. Me këtë, po akuzohet se ka kryer veprën penale “mashtrimi në detyrë”, nga neni 341, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës, në bashkim real me veprën penale si nën pikën 1 të dispozitivit.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Agjencia Kundër Korrupsion kishte ushtruar kallëzim penal në këtë rast më 23 prill 2013, kurse, prokuroria kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve më 30 mars 2015.

Aktakuza në gjykatë ishte ngritur në gjykatë më 18 korrik 2016.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 14 janar 2019, apo 879 ditë pas afatit ligjor prej 30 ditë brenda të cilit duhet të mbahet shqyrtimi fillestar pas ngritjes së aktakuzës.<sup>50</sup> Deri më tani, në këtë rast janë mbajtur edhe tri (3) seanca tjera, kurse një (1) kishte dështuar të mbahet për shkak të trajnimeve në të cilat kishin qenë të caktuar gjyqtarët.

Më 21 korrik 2020 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kishte përfunduar shqyrtimi gjyqësor ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit të komunës së Skenderajt, Hasan Shala, si dhe zyrtares së kësaj drejtorie, Sanije Ahmeti, të akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe mashtrim.<sup>51</sup> Ndërsa, tri ditë më pas, kjo gjykatë kishte nxjerrë aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve me arsyetimin se nuk kishte prova që vërtetonin se të pandehurit kishin kryer veprat penale që u ngarkoheshin.<sup>52</sup> Aktgjykimi lirues i nxjerrë në shkallë të parë ndaj Shalës dhe Ahmetit ishte vërtetuar nga Apeli më 18 janar 2021.<sup>53</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Nuk është saktësuar

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka kërkesë.

---

<sup>50</sup> “Ish-drejtori i Urbanizmit në Skënderaj dhe zyrtarja komunale deklarohen të pafajshëm për korrupsion”. Betimi për Drejtësi, 14 janar 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-urbanizmit-ne-skenderaj-dhe-zyrtarja-komunale-deklarohen-te-pafajshem-per-korrupsion/>) (Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020).

<sup>51</sup> “Përfundon gjykimi për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe mashtrim në detyrë ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit dhe zyrtares komunale të Skënderajt”, Betimi për Drejtësi, 21 korrik 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-gjykimi-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare-dhe-mashtrim-ne-detyre-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizmit-dhe-zyrtares-komunale-te-skenderajt/>). (Qasur për herë të fundit më 2 mars 2021).

<sup>52</sup> “Aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe mashtrim në detyrë ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit dhe zyrtares komunale të Skënderajt”, Betimi për Drejtësi, 24 korrik 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare-dhe-mashtrim-ne-detyre-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizmit-dhe-zyrtares-komunale-te-skenderajt/>). (Qasur për herë të fundit më 2 mars 2021).

<sup>53</sup> “Apeli vërteton aktgjykimin lirues ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit dhe zyrtares komunale të Skënderajt të akuzuar për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 22 mars 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-lirues-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizmit-dhe-zyrtares-komunale-te-skenderajt-te-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herën e fundit, 21 prill 2021).

## **10. Rasti Ahmet Bahtjari etj.**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.42/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Raima Elezi

**Prokuror/e:** Mehdi Sefa

**Të akuzuar:** Ahmet Bahtjari; Avni Nebiu; Selajdin Vehbi

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Konflikt interesi”

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **913 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prizren, më 3 qershor 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Avni Nebiu dhe Selajdin Vehbi, të cilët i ngarkon me veprën penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar, ndërsa Ahmet Bahtjarin, përveç për keqpërdorim të detyrës zyrtare, akuzohet edhe për konflikt të interesit. Sipas aktakuzës, Ahmet Bahtjari akuzohet se gjatë periudhës 2004, e deri më 2017, në cilësinë e Drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit, nuk i ka përmbushur detyrat apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për servisin “Menti”, pronar i të cilit është djali i tij, Armend Bahtjari.

Në aktakuzë thuhet se kjo ka ndodhur në atë mënyrë që i pandehuri Bahtjari, i ka mundësuar lidhjen e marrëveshjes me Kuvendin Komunal të Dragashit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, parcelën në sipërfaqe prej 122 m<sup>2</sup> dhe e nënshkruan urdhërpagesën e servisimit të automjeteve zyrtare në servis “Menti”, në bazë të faturave edhe pse Kuvendi Komunal i Dragashit, ka pasur kontratë me operatorin ekonomik për servisim “LML”, për rregullimin e automjeteve, kështu që i mundëson djali të tij dobi pasurore si pronar i servisit “Menti”, për vitin 2015, shumë prej 3069 euro, për vitin 2016, shumë prej 712 euro, dhe për vitin 2017, shumë prej 1532 euro, duke dëmtuar kështu operatorin ekonomik “LML”, e cila ka pasur kontratë për servisimin e automjeteve të Komunës së Dragashit.

Me këtë, akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së.

Gjithnjë sipas aktakuzës, Bahtjari akuzohet se në periudhën e njëjtë kohore, në cilësinë e drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit, personalisht merr pjesë në çështje zyrtare në të cilën anëtar i familjes-djali i tij, Armend Bahtjari ka interes financiar, në atë mënyrë që e nënshkruan urdhërpagesën e servisimit të automjeteve zyrtare në servis “Menti” dhe, kështu i mundëson djali të tij, dobi pasurore si pronar i servisit “Menti”, për vitin 2015, shumë prej 3069 euro, për vitin 2016, shumë prej 712 euro dhe për vitin 2017, shumë prej 1532 euro. Me këtë, akuzohet se ka kryer veprën penale “konflikt i interesit”, nga neni 424 paragraf 1 të KPRK.

Ndërsa, sipas aktakuzës, Avni Nebiu dhe Selajdin Vehbi, akuzohen se gjatë periudhës nëntor 2014, e deri në kohë të pacaktuar, në cilësi të personave zyrtar të Komunës së Dragashit, Avni Nebiu, zyrtar autorizues i pagesave, ndërsa Selajdin Vehbi, zyrtar certifikues, duke mos i përmbushur detyrat zyrtare apo autoritetin zyrtar, kanë tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për servis “Menti”, pronar i të cilit është djali i drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit.

Në aktakuzë thuhet se të pandehurit Avni Nebiu dhe Selajdin Vehbi, nënshkruajnë urdhërpagesat e servisimit të automjeteve zyrtare, në servisën “Menti”, në bazë të faturave edhe pse Kuvendi Komunal i Dragashit, ka pasur kontratë me operatorin ekonomik “LML” për rregullimin e automjeteve, kështu që i mundëson dobi pasurore pronarit të servisit “Menti”, për vitin 2015 shumë prej 3069 euro, për vitin 2016, shumë prej 712 euro dhe për vitin 2017, shumë prej 1532 euro, duke dëmtuar kështu operatorin ekonomik “LML”, e cila ka pasur kontratë për servisimin e automjeteve të Komunës së Dragash. Me këto veprime, ata akuzohen se kanë kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës kishte ushtruar kallëzim penale lidhur me këtë rast më 21 maj 2019. Kurse, aktakuza në gjykatë ishte ngritur më 3 qershor 2019.

Shqyrtimi fillestar ishte caktuar të mbahej fillimisht më 19 qershor 2019, brenda afatit të paraparë ligjor. Mirëpo, kjo seancë kishte dështuar të mbahet pasi që prokuroria kishte dështuar të furnizojë me shkresat e lëndës të akuzuarit.<sup>54</sup>

Pas kësaj, shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 16 korrik 2019, ku të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm lidhur me akuzat me të cilat ngarkohen.

Shqyrtimi i dytë ishte caktuar të mbahet më 19 shtator 2019, jashtë afatit të paraparë ligjor mirëpo edhe kjo seancë kishte dështuar pasi kishte munguar prokurori.<sup>55</sup> Ky shqyrtim ishte mbajtur pastaj me 26 shtator 2019. Në këtë seancë, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i rastit Mehdi Sefa, gjyqtarja Raime Elezi, kishte marrë vendim që të bëhet plotësimi aktakuzës. Në seancën e mbajtur më 7 tetor 2019, prokurori Sefa, kishte bërë plotësimin e aktakuzës duke thënë se sa i përket dispozitivit të parë dhe të tretë pas emrit Ahmet Bahtijari, shtohet “në kundërshtim me nenin 26 të Rregullores 01/2013 për shpenzimin e parasë publike”.

Pas konfirmimit të aktakuzës, lidhur me këtë rast ishin mbajtur edhe katër seanca të tjera gjyqësore, më 27 janar 6 mars dhe 1 dhjetor 2020 si dhe më 21 janar 2021, ku ka vazhduar administrimi i provave në gjykimin ndaj ish-drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit, Ahmet Bahtijari, si dhe dy zyrtarëve të tjerë të komunës, Avni Nebiu dhe Selajdin Vehbi, të cilët akuzohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe konflikt interesi. Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 21 janar 2021, gjykata kishte vazhduar me dëgjimin në cilësi të dëshmitarit të zyrtarit të zyrës së prokurimit në Komunën e Dragashit.<sup>56</sup> Seanca e radhës për

---

<sup>54</sup> “Dështon gjykimi për korrupsion ndaj ish-drejtorit dhe dy zyrtarëve të Komunës së Dragashit”, Betimi për Drejtësi, 19 qershor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-dhe-dy-zyrtareve-tjere-te-komunes-se-dragashit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>55</sup> “Mungon prokurori, dështon gjykimi për korrupsion ndaj ish-drejtorit dhe dy zyrtarëve tjerë të Komunës së Dragashit”. Betimi për Drejtësi, 19 shkurt 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurori-deshton-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-dhe-dy-zyrtareve-tjere-te-komunes-se-dragashit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>56</sup> “Provë e re në rastin ndaj ish-drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit, si dhe dy zyrtarëve të tjerë të komunës”, Betimi për Drejtësi, 21 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prove-e-re-ne-rastin->

këtë është caktuar afro 10 muaj më vonë, më 23 nëntor, pasi që gjatë kësaj periudhe kohore në këtë rast është realizuar një ekspertizë.

**Dëmi i pretenduar:** 5,313 euro.

**Konfiskim dhe sekuestrim:** Nuk ka kërkesë.

### **11. Rasti Almir Saiti etj.**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.26/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Xheladin Osmani

**Prokuror/e:** Genc Nixha

**Të akuzuar:** Almir Saiti; Muhamet Bajrami; Drenusha Behluli Mehmeti; Hatixhe Përzhella

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Në proces.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **961 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prizren, më 16 prill 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Almir Sahiti, Refki Muzbeg, Muhamet Bajrami, Hatixhe Përzhella dhe Drenusha Behluli-Mehmeti për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Sipas aktakuzës, Almir Saiti akuzohet se gjatë periudhës 2010, e deri më 22 tetor 2015, duke mos i përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veten apo për tjetrin, i shkakton dëm buxhetit të Komunës së Prizrenit.

Në aktakuzë thuhet se kjo ka ndodhur në atë mënyrë që i caktuar si menaxher-drejtor i projektit për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur, ku për fazën e parë ka qenë i përcaktuar operatori ekonomik “Alkom-Konstruksin” nga Prizreni, punime të cilat nuk janë kryer sipas pozicioneve të paracaktuar, pa mbajtur librin ndërtimor dhe pa pranimin e punimeve për punët e zbatuara, ka lejuar ekzekutimin e pagesave duke nënshkruar procesverbalet për lejimin e kryerjes së pagesave në gjashtë raste për këtë kompani, në shumë të përgjithshme prej 324.623.82 euro. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Saiti edhe pse është vërtetuar se pozicionet nuk janë punuar si duhet ashtu siç kanë qenë të parapara sipas kontratës edhe për fazën e dytë për të cilën ka qenë i kontraktuar operatori ekonomik “Elshani” nga fshati Metvec, Komuna e Prizrenit, punime të cilat nuk janë kryer sipas pozicioneve të paracaktuar, pa mbajtur librin ndërtimor dhe pa pranimin e punimeve për punët e zbatuara, ka lejuar ekzekutimin e pagesave duke nënshkruar procesverbalet për lejimin e kryerjes së pagesave në 15 raste për këtë kompani, në shumë të përgjithshme prej 573,154.90 euro, të përshkruar në hollësisht sikurse në ekspertizën financiare të ekspertit financiar Hamid Kastrati.

Ndërsa, sipas aktakuzës, Refki Musbeg akuzohet se gjatë periudhës 22 tetor 2009, e deri më 30 qershor 2011, duke mos i përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore

---

[ndaj-ish-drejtorit-te-financave-ne-komunen-e-dragashit-si-dhe-dy-zyrtareve-te-tjere-te-komunes/](#)). (Qasur për herë të fundit më 14 nëntor 2021).

për veten apo për tjetrin, i shkakton dëm buxhetit të Komunës së Prizrenit. Ai akuzohet se si person i caktuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si organ mbikëqyrës i projektit për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur, ku për fazën e parë ka qenë i përcaktuar operatori ekonomik “Alkom-Konstruksin” nga Prizreni, punime të cilat nuk janë kryer sipas pozicioneve të paracaktuar, pa mbajtur librin ndërtimor dhe pa pranimin e punimeve për punët e zbatuara, ka lejuar ekzekutimin e pagesave duke nënshkruar procesverbalet për lejimin e kryerjes së pagesave në gjashtë raste për këtë kompani, në shumë të përgjithshme prej 324,623.82 euro, të përshkruara më hollësisht sikurse në ekspertizën financiare të ekspertit financiar Hamid Kastrati,

Në aktakuzë thuhet se edhe pse është vërtetuar se punimet nuk ishin kryer si duhet dhe siç kanë qenë të parapara sipas kontratës dhe për faktin se pranimi teknik për këtë objekt nuk është bërë deri me datën e dorëzimit të ekspertizës më 1 mars 2019, i njëjti ka lejuar pagesat. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Muhamet Bajrami akuzohet se gjatë periudhës 24 dhjetor 2010 e deri më 22 tetor 2015, duke mos i përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veten apo për tjetrin, i shkakton dëm buxhetit të Komunës së Prizrenit. Ai akuzohet se si person i caktuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si organ mbikëqyrës i projektit për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur, ku për fazën e dytë për të cilën ka qenë i kontraktuar operatori ekonomik “Elshani” punime të cilat nuk janë kryer sipas pozicioneve të paracaktuar, pa mbajtur librin ndërtimor dhe pa pranimin e punimeve për punët e zbatuara, ka lejuar ekzekutimin e pagesave duke nënshkruar procesverbalet për lejimin e kryerjes së pagesave në 15 raste për këtë kompani, në shumë të përgjithshme prej 573,154.90 euro, të përshkruar në hollësisht sikurse në ekspertizën financiare të ekspertit financiar Hamid Kastrati.

Kurse, Hatixhe Përzhella akuzohet se periudhës dhjetor 2013, e deri më 27 maj 2014, duke mos i përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veten apo për tjetrin, i shkakton dëm buxhetit të Komunës së Prizrenit, ku si person i caktuar nga Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, si organ mbikëqyrës i projektit për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur, ku për fazën e tretë për të cilën ka qenë i kontraktuar operatori ekonomik “Kosova Erh-Kotori” nga Prizreni, punime të cilat nuk janë kryer sipas pozicioneve të paracaktuar, pa mbajtur librin ndërtimor dhe pa pranimin e punimeve për punët e zbatuara, ka lejuar ekzekutimin e pagesave duke nënshkruar procesverbalet për lejimin e kryerjes së pagesave në tre raste për këtë kompani, në shumë të përgjithshme prej 67,633.00 euro, të përshkruar në hollësisht sikurse në ekspertizën financiare të ekspertit financiar Hamid Kastrati.

Sipas prokurorisë për të njëjtën vepër penale akuzohet edhe Drenusha Behluli-Mehmeti, ku ajo akuzohet se periudhës 3 nëntor 2017, e deri më 12 dhjetor 2017, duke mos i përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veten apo për tjetrin, i shkakton dëm buxhetit të Komunës së Prizrenit, ku si person i caktuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbikëqyrjen e projektit për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur, ku për fazën e tretë për të cilën ka qenë i kontraktuar operatori ekonomik “NNT TONI” nga Malisheva, punime të cilat nuk janë kryer sipas pozicioneve të paracaktuar, pa mbajtur librin

ndërtimor dhe pa pranimin e punimeve për punët e zbatuara, ka lejuar ekzekutimin e pagesave duke nënshkruar procesverbalet për lejimin e kryerjes së pagesave në dy raste për këtë kompani, në shumë të përgjithshme prej 64,609.23 euro, të përshkruar në hollësisht sikurse në ekspertizën financiare të ekspertit financiar Hamid Kastrati.

Me këto veprime, të gjithë të akuzuarit ngarkohen se kanë kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 paragraf 1 të KPRK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës për këtë rast kishte ushtruar kallëzim penal më 22 shkurt 2016. Më 18 prill 2017, Prokuroria Themelore në Prizren kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve kurse më 16 prill 2019, kishte ngritur aktakuzën në gjykatë.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte caktuar të mbahet më 5 qershor 2019, apo 20 ditë pas afatit ligjor sipas të cilit, shqyrtimi fillestar mbahet brenda 30 dite pas ngritjes së aktakuzës. Mirëpo, edhe kjo seancë kishte dështuar të mbahet pasi kishte munguar një i akuzuar.<sup>57</sup> Ky shqyrtim ishte mbajtur pastaj më 9 korrik 2019, ku të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm lidhur me akuzat me të cilat ngarkohen.

Shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 15 gusht 2019, brenda afatit ligjor, ku të akuzuarit kishin kërkuar hudhjen e aktakuzës ndërsa prokuroria i kishte kundërshtuar këto kërkesa. Pas konfirmimit të aktakuzës, lidhur me këtë rast janë mbajtur edhe tri (3) seanca gjyqësore, më 10 tetor, 3 dhjetor dhe 20 janar 2020.

Në seancën e fundit, më 20 janar 2020, Gjykata Themelore në Prizren, e kishte pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit për keqpërdorim të pozitës zyrtare, Refki Muzbeg për shkak të parashkrimit relativ të veprës penale.<sup>58</sup> Në këtë rast, për arsye të ndryshme ligjore nuk kishin arritur të mbaheshin seancat e 2 korrikut, 8 shtatorit 2020, përderisa seanca e 20 tetorit ishte mbajtur. Seanca e 18 janarit 2021<sup>59</sup> dhe ajo e 15 prillit nuk kishin arritur që të mbaheshin, ndërsa për shkak se kishin kaluar më shumë se tre muaj nga seanca e fundit, më 1 korrik të

---

<sup>57</sup> “Dështon gjykimi ndaj të akuzuarve për keqpërdorime lidhur me ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në Zhur të Prizrenit”. Betimi për Drejtësi, 5 qershor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-ndaj-te-akuzuarve-per-keqperdorime-lidhur-me-ndertimin-e-shtepise-se-kultures-ne-zhur-te-prizrenit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>58</sup> “Gjykimi për keqpërdorime lidhur me ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në Zhur, pushon procedura për njërin të akuzuar”. Betimi për Drejtësi, 20 janar 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-keqperdorime-lidhur-me-ndertimin-e-shtepise-se-kultures-ne-zhur-pushon-procedura-per-njerin-te-akuzuar/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>59</sup> “Për të dytën herë me radhë dështon gjykimi për keqpërdorime lidhur me ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në Zhur”, Betimi për Drejtësi, 18 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-te-dyten-here-me-radhe-deshton-gjykimi-per-keqperdorime-lidhur-me-ndertimin-e-shtepise-se-kultures-ne-zhur/>). (Qasur për herë të fundit më 2 mars 2021).

këtij viti<sup>60</sup>, ky gjykim kishte filluar rishtazi. Seanca e radhës, ajo e 22 shtatorit<sup>61</sup> kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së anëtares së trupit gjykues, ndërsa ajo e 29 shtatorit, ishte mbajtur, ku është realizuar dalja në terren.

**Dëmi i pretenduar:** 1,030.019 euro.

**Konfiskim dhe sekuestrim:** Nuk ka kërkesë.

## **12. Rasti Nijazi Kryeziu**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.57/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Raime Elezi

**Prokuror/e:** Mehdi Sefa

**Të akuzuar:** Nijazi Kryeziu

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim lirues në shkallë të parë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në vendimin e shkallës së parë kanë kaluar **782 ditë**)

Prokuroria Themelore Prizren kishte ngritur më 2 gusht 2019 aktakuzën me të cilën i pandehuri Nijazi Kryeziu akuzohet për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Sipas aktakuzës, Nijazi Kryeziu, akuzohet se gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2015, në cilësinë e drejtorit të Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Prizrenit, nuk i ka përmbushur detyrat apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personat tjerë juridik, TV Opinion. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Kryeziu, duke mos e përmbushur detyrën e përcaktuar me ligj, pa ndonjë procedurë të tenderimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe Rregulloren e Thesarit, kishte lidhur kontratë për emetimin e spoteve reklamuese për nevojat e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës Prizrenit.

Sipas aktakuzës, Kryeziu, gjatë periudhës kohore 01 janar 2015, e deri më 31 dhjetor 2015, kishte lidhur kontratë me TV Opinionin, në vlerë prej 600 euro në muaj, dhe se për 12 muaj ka paguar 7200 euro. Me këtë, akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

---

<sup>60</sup> “Fillon rishtazi gjykimi për keqpërdorime lidhur me ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në Zhur, të akuzuarit serish deklarohen të pafajshëm”, Betimi për Drejtësi, 1 korrik 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fillon-rishtazi-gjykimi-per-keqperdorime-lidhur-me-ndertimin-e-shtepise-se-kultures-ne-zhur-te-akuzuarit-serish-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 14 nëntor 2021).

<sup>61</sup> “Mungon gjykatësja, shtyhet dalja në vendngjarje për keqpërdorime në ndërtimin e një objekti”, Betimi për Drejtësi, 22 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-gjykatesja-shtyhet-dalja-ne-vendngjarje-per-keqperdorime-ne-ndertimin-e-shtepise-se-kultures-ne-zhur/>). (Qasur për herë të fundit më 14 nëntor 2021).

Aktvendimi për fillim të hetimeve në këtë rast, ishte nxjerrë më 2 korrik 2019. Ndërsa, aktakuza në gjykatë ishte ngritur një muaj më vonë, më 2 gusht 2019.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur më 14 tetor 2019, apo 42 ditë pas afatit ligjor sipas të cilit, shqyrtimi fillestar mbahet brenda 30 dite pas ngritjes së aktakuzës. Në këtë seancë, Kryeziu ishte deklaruar i pafajshëm. Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte caktuar më 19 nëntor 2019, brenda afatit ligjor, me ç'rast i akuzuari kishte kundërshtuar aktakuzën e prokurorisë.<sup>62</sup> Kërkesën e mbrojtjes për hedhje të aktakuzës e kishte refuzuar Gjykata Themelore në Prizren.<sup>63</sup>

Gjatë vitit 2020 ishin mbajtur vetëm tri seanca në këtë rast, përderisa gjatë vitit 2021 ishin caktuar tetë seanca, nga të cilat dy ishin shtyrë, ndërsa gjashtë të tjera ishin mbajtur.

Ky proces gjyqësor mori epilog në shkallë të parë në shtator të këtij viti, me ç'rast ish-drejtori i Urbanizimit në Planifikimit Hapësinor në Prizren, Nijazi Kryeziu është liruar nga akuza për korrupsion sipas vendimit të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren, pasi nuk ishte vërtetuar me asnjë provë kryerja e veprës penale nga i akuzuari.<sup>64</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 7,200 euro.

**Konfiskim dhe sekuestrim:** Nuk ka kërkesë

### **13. Rasti Isa Osmankaj**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.37/19

**Kryetar/e i Trupit Gjyqësor:** Ajser Skenderi

**Prokuror/e:** Ervehe Gashi

**Të akuzuar:** Isa Osmankaj

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Në proces.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **927 ditë**)

Prokuroria Themelore Prizren kishte ngritur aktakuzë më 20 maj 2019, sipas të cilës i pandehuri Isa Osmankaj akuzohet për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Ai akuzohet se në periudhën kohore maj 2017, e deri në maj 2018, në cilësinë e shefit të zyrës së

---

<sup>62</sup> “Nijazi Kryeziu kundërshton aktakuzën ndaj tij, prokurori thotë se kishte shkelje në kontratën me televizionin lokal”. Betimi për Drejtësi, 5 dhjetor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nijazi-kryeziu-kundershton-aktakuzen-ndaj-tij-prokurori-thote-se-kishte-shkelje-ne-kontraten-me-televizionin-lokal/>). Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020)

<sup>63</sup> “Refuzohet kërkesa për hudhjen e aktakuzës ndaj ish-drejtorit të Urbanizimit në Prizren, Nijazi Kryeziu”. Betimi për Drejtësi, 18 dhjetor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohet-kerkesa-per-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizimit-ne-prizren-nijazi-kryeziu/>). Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>64</sup> “Lirohet nga akuza për korrupsion ish-drejtori i Urbanizimit në Prizren”, Betimi për Drejtësi, 21 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-ish-drejtori-i-urbanizimit-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 15 nëntor 2021).

prokurimit në Komunën e Prizrenit, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare apo autoritetin zyrtar, nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim të përfitimit të dobisë për tjetrin.

Në aktakuzë thuhet se i akuzuari vepron në kundërshtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik, lidhur me tenderin “Shenjzimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit”, e lidhur me ankesën e operatorit ekonomik NPTSH “Limit L&B”, me seli në Prizren, si tenderues i suksesshëm, refuzon ankesën duke pretenduar se “Deklarata nën betim” e parashtuesit “Boja SHPK” me seli në Sambor dhe marrëveshja me të njëjtin partner është e falsifikuar, kërkon nga PSHP që të bëjë diskualifikimin e këtij operatori, për shkak të dokumenteve të falsifikuara të ndërmerren masa për falsifikim sipas nenit 92 të LPP-së, me ç’rast PSHP, me vendim me nr.259 të 4 majit 2017, refuzon ankesën me arsyetim se nuk kanë gjetur prova për falsifikim.

Sipas aktakuzës, thuhet se i akuzuari më 19 qershor 2017, bënë njoftimin për dhënien e kontratës për operatorin ekonomik “Sinjalizimi” edhe pse ishte shpallur i papërgjegjshëm nga PSHP-ja, me këtë vendim nuk njofton operatorët e tjerë me qëllim që t’i shmang ankesat e operatorëve jo fitues, nuk njofton për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së ofertës dhe dorëzimin e garancisë së re, pa skaduar afati i ankesave. Në aktakuzë thuhet se ai e nënshkruan kontratën me operatorin “Sinjalizimi”, më 3 korrik 2017, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin 4.1 dhe 4.3 të nenit 20 të ligjit 4/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-042 për të cilat shkelje gjohet nga OSHP-ja, edhe për kundër faktit se ky operator është shpallur i papërgjegjshëm më 10 gusht 2017, përsëri e shpall fitues operatorin “Sinjalizimi”, me ankesën e të dëmtuarit me 21 shtator 2017, ky njoftim është anuluar dhe përsëri pas rivlerësimit për kontratë, i pandehuri rekomandon operatorin e njëjtë.

Gjithnjë sipas aktakuzës, thuhet se pas ankesës së operatorit ekonomik “LIMITI&BOJA&DRINI”, OSHP-ja më 19 tetor 2017, kërkon që të anulohet i gjithë aktiviteti i prokurimit, me ç’rast më 5 dhjetor 2017, i pandehuri e anulon njoftimin për dhënien e kontratës dhe njofton OPSH-në, ndërsa duke mos respektuar dispozitat ligjore të LPP-së lejon që Komuna e Prizrenit, në maj të vitit 2018, të fillojë zbatimin e kontratës së anuluar nga OSHP-ja. Me këto veprime, ai akuzohet se ka shkelur të drejtat e operatorit ekonomik “LIMIT L&B” dhe i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale, si dhe i ka mundësuar kompanisë “Sinjalizimi&Zmas” zbatimin e një kontrate joekzistente, në vlerë 358,039.06 euro, nga e cila kontratë deri me datën e kryerjes së ekspertizës janë realizuar punë në vlerë prej 163.257.72 euro. Me këtë, ai akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2.1 të KPRK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Aktivendimi për fillim të hetimeve në këtë rasti ishte nxjerr më 4 qershor 2017 kurse aktakuza ishte ngritur në gjykatë më 20 maj 2019.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 19 qershor 2019, brenda afatit ligjor. Në këtë seancë, i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm lidhur me akuzën e cila i vihet në barrë.<sup>65</sup>

Më 30 korrik 2019, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë ku i akuzuari e kishte kundërshtuar aktakuzën e prokurorisë, me këtë të fundit që kishte insistuar se ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit.<sup>66</sup>

Dy seanca gjyqësore që ishin caktuar të mbahen për këtë rast, më 9 tetor dhe 12 dhjetor 2019, kishin dështuar të mbahen pasi kishte munguar prokurorja e rastit.<sup>67</sup> Gjatë vitit 2020, konkretisht më 28 janar të vitit të kaluar kishte filluar shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, ku krahas fjalës hyrëse në këtë seancë ishte proceduar edhe me dëgjim të dëshmitarëve<sup>69</sup>, ndërsa seanca tjetër gjatë vitit 2020 ishte mbajtur më 22 qershor. Gjykimi ndaj shefit të Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit, Isa Osmankaj ka vazhduar së fundmi më 4 mars 2021, me ç'rast gjykata ka aprovuar propozimin e prokurorisë për super ekspertizë në këtë rast.<sup>70</sup> Seanca e radhës ishte mbajtur më 1 tetor, me ç'rast ekspertët kishin sqaruar super-ekspertizën e punuar në këtë çështje penale.<sup>71</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 358,039 euro.

**Konfiskim dhe sekuestrim:** Nuk ka kërkesë.

---

<sup>65</sup> “Shefi i zyrës së prokurimit në Prizren deklarohet i pafajshëm për dhënie të kundërligjshme të tenderit”. Betimi për Drejtësi, 19 qershor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shefi-i-zyres-se-prokurimit-ne-prizren-deklarohet-i-pafajshem-per-dhenie-te-kunderligjshme-te-tenderit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>66</sup> “Shefi i zyrës së prokurimit në Prizren kundërshton aktakuzën, prokuroria thotë se ka prova të mjaftueshme”. Betimi për Drejtësi, 30 korrik 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shefi-i-zyres-se-prokurimit-ne-prizren-kundershton-aktakuzen-prokuroria-thote-se-ka-prova-te-mjaftueshme/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>67</sup> “Mungon prokurorja, dështon gjykimi ndaj shefit të zyrës së prokurimit në Prizren për dhënie të kundërligjshme të tenderit”. Betimi për Drejtësi, 9 tetor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurorja-deshton-gjykimi-ndaj-shefit-te-zyres-se-prokurimit-ne-prizren-per-dhenie-te-kunderligjshme-te-tenderit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>68</sup> “Mungon prokurorja, dështon gjykimi ndaj shefit të zyrës së prokurimit në Prizren për dhënie të kundërligjshme të tenderit”. Betimi për Drejtësi, 12 dhjetor 2019 (<https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurorja-deshton-gjykimi-per-dhenie-te-kunderligjshme-te-tenderit-ndaj-shefit-te-prokurimit-ne-prizren/>)

<sup>69</sup> “Drejtori në Prizren thotë se kontratën për sinjalizimin në qytet e ka gjetur në zyrë të nënshkruar nga ish-kryetari Muja”, Betimi për Drejtësi, 28 janar 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-ne-prizren-thote-se-kontraten-per-sinjalizimin-ne-qytet-e-ka-gjetur-ne-zyre-te-nenshkuar-nga-ish-kryetari-muja/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>70</sup> “Aprovohet kërkesa e Prokurorisë për superekspertizë në gjykimin e Shefit të Zyrës së Prokurimit në Prizren”, Betimi për Drejtësi, 4 mars 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aprovohet-kerkesa-e-prokurorise-per-superekspertize-ne-gjykimin-e-shefit-te-zyres-se-prokurimit-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>71</sup> “Tre ekspertët sqarojnë superekspertizën e punuar në gjykimin e Shefit të Zyrës së Prokurimit në Prizren”, Betimi për Drejtësi, 1 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/3-ekspertet-sqarojne-superekspertizen-e-punuar-ne-gjykimin-e-shefit-te-zyres-se-prokurimit-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 15 nëntor 2021).

#### **14. Rasti Hadije Kasumi**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.107/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Ajser Skenderi

**Prokuror/e:** Mehdi Sefa

**Të akuzuar:** Hadije Kasumi

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim lirues në shkallë të dytë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në vendimin e shkallës së dytë kanë kaluar **693 ditë**)

Prokurorisë Themelore Prizren me 4 dhjetor 2019 kishte ngritur aktakuzë sipas të cilës Hadije Kasumi akuzohet se gjatë vitit 2018, në cilësinë e personit zyrtar, si zyrtare ligjore në MMPH, në Prishtinë, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare apo autoritetin zyrtar, nuk i përmbush detyrat zyrtare të saj me qëllim të përfitimit të dobisë për tjetrin.

Në aktakuzë thuhet se e akuzuara më 29 mars 2018, merr vendim me të cilin shfuqizon aktvendimin e datës 21 mars 2018 të Drejtorisë për Inspeksion të Ndërtimtarisë në Komunën e Prizrenit, me ç’rast gjatë vendosjes në shkallë të dytë, me ankesë të palës nga Drejtoria e Inspeksionit dhe Urbanizmit të Komunës së Prizrenit, nuk kërkon shkresat dhe dokumentacionin e vendosjes në shkallë të parë lidhur me mosdhënie të lejes për ndërtim qytetarit Luan Morina, me ç’rast kishte për të ardhur në përfundim se në çështjen konkrete nuk ka pasur heshtje administrative rreth kërkesës për leje-ndërtim siç pretendon Morina, në padinë e kompensimit të dëmit lidhur me rrënimin e objektit.

Sipas aktakuzës, pasi Komuna e Prizrenit -Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, më 30 gusht 2017, ka hudhur kërkesën për leje ndërtimore, e pandehura me marrjen e një vendimi në shkallë të dytë e aprovon ankesën e Luan Morinës dhe e kthen çështjen në rishqyrtim, duke u bazuar vetëm në shkresat e palës, e cila ka parashtruar ankesë, dhe kështu i mundëson Morinës, në kontestin civil të kërkojë kompensimin e dëmit në shumë prej 70.000 euro për rrënim të objektit, duke dëmtuar për këtë shumë Komunën e Prizrenit.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës me 3 gusht 2018 kishte ngritur kallëzim penal ndaj të akuzuarës Kasumi, kurse, aktvendimi për fillim të hetimeve nga ana e prokurorisë ishte nxjerr më 28 shkurt 2019. Aktakuza ndaj Kasumit ishte ngritur në gjykatë më 4 dhjetor 2019.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur më 23 dhjetor 2019, brenda afatit ligjor. Në këtë seancë, e akuzuar ishte deklaruar e pafajshme lidhur me akuzën me të cilën ngarkohet.<sup>72</sup>

---

<sup>72</sup> “Zyrtarja ligjore në MMPH mohon fajësinë se e dëmtoi për 70 mijë euro buxhetin e Komunës së Prizrenit” Betimi për Drejtësi, 23 dhjetor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtarja-ligjore-ne-mmph-mohon-fajesine-se-e-demtoi-per-70-mije-euro-buxhetin-e-komunes-se-prizrenit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

Shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 27 janar 2020, brenda afatit të paraparë sipas ligjit. Në këtë seancë, mbrojtja e të akuzuarës kishte kërkuar hudhjen poshtë të aktakuzës.<sup>73</sup> Pas konfirmimit të aktit akuzues ndaj Kasumit, shqyrtimi gjyqësor ndaj saj kishte filluar më 9 korrik 2020, për të vazhduar pastaj më 22 shtator, 29 tetor e 7 dhjetor 2020, ku gjatë këtyre seancave janë administruar prova të ndryshme ndaj të akuzuarës Kasumi.<sup>74</sup> Ndërsa, në vitin 2021, janë mbajtur dy seanca, ajo e 25 janarit<sup>75</sup> dhe 2 marsit 2021, me ç'rast në këtë seancë është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit zyrtari Komunal i Prizrenit, Refki Muzbegu.<sup>76</sup> Për shkak të mungesës së anëtarit të trupit gjykues dhe të akuzuarës Kasumi më 16 prill 2021 kishte dështuar të vazhdonte shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale. Më 3 Qershor 2021, Gjykata Themelore në Prizren kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj Kasumit, me arsyetimin se nuk ishte vërtetuar se e akuzuara kishte kryer veprën penale që i ngarkohej.<sup>77</sup> Aktgjykimi lirues i nxjerrë në shkallë të parë ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 26 tetor të këtij viti, derisa ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren ishte refuzuar si e pabazuar.

**Dëmi i pretenduar:** 70,000 euro.

**Konfiskim dhe sekuestrim:** Nuk ka kërkesë.

### **15. Rasti Ertan Simitqi dhe Zenel Ahmetaj**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.53/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Ajser Skenderi

**Prokuror/e:** Mehdi Sefa

**Të akuzuar:** Ertan Simitqi; Zenel Ahmetaj.

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të parë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në aktgjykimin e shkallës së parë kanë kaluar **538 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prizren, më 31 korrik 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Zenel Ahmetaj dhe Ertan Simitqi, të cilët i ngarkon me veprën penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar.

<sup>73</sup> “Mbrojtja kërkon të hudhet poshtë aktakuza për korrupsion ndaj zyrtares ligjore në MMPH” Betimi për Drejtësi, 27 janar 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-kerkon-te-hudhet-poshte-aktakuza-per-korrupsion-ndaj-zyrtares-ligjore-ne-mmph/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>74</sup> “Ka vazhduar seanca me procedurën e provave në rastin ku e akuzuar është zyrtarja ligjore e MMPH”, Betimi për Drejtësi, 7 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ka-vazhduar-seanca-me-proceduren-e-provave-ne-rastin-ku-e-akuzuar-eshte-zyrtarja-ligjore-e-mmph/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>75</sup> “Me aktvendim të gjykatës do të ftohet në cilësinë e dëshmitarit Refki Muzbeg në rastin ku po gjykohet për korrupsion zyrtarja ligjore e MMPH”, Betimi për Drejtësi, 25 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/me-aktvendim-te-gjykares-do-te-ftohet-ne-cilesine-e-deshmitarit-refki-muzbeg-ne-rastin-ku-po-gjykohet-per-korrupsion-zyrtarja-ligjore-e-mmph/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>77</sup> “Shpallet e pafajshme zyrtarja ligjore e MMPH-së, e akuzuar për korrupsion (Video)”, Betimi për Drejtësi, 3 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-e-pafajshme-zyrtarja-ligjore-e-mmph-se-e-akuzuar-per-korrupsion-video/>). (Qasur për herë të fundit më 15 nëntor 2021).

Sipas aktakuzës, Zenel Ahmetaj akuzohet se gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2015, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Financave në Komunën e Prizrenit, nuk i ka përmbushur detyrat apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personat tjerë juridik, TV Opinion, TV Besa, dhe TV Prizreni. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Ahmetaj, duke mos e përmbushur detyrën e përcaktuar me ligj, pa ndonjë procedurë të tenderimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe Rregulloren e Thesarit, kishte lidhur kontrata për emetimin e spoteve reklamuese për nevojat e Drejtorisë së Financave të Komunës Prizrenit.

Sipas aktakuzës, Ahmetaj gjatë periudhës kohore 25 janar 2015, e deri më 31 dhjetor 2015, kishte lidhur kontratë me TV Opinionin, në vlerë prej 300 euro në muaj, dhe se për 12 muaj ka paguar 3600 euro, ndërsa në periudhën 20 janar 2015, deri me 31 dhjetor 2015, me TV Besa, kishte lidhur kontratë prej 300 euro në muaj, që për 12 muaj arrin shumën 3600 euro, si dhe për të njëjtën periudhë dhe me shumë të njëjtë, kishte lidhur kontratë edhe me TV Prizrenin, ku për të tre televizionet arrin shuma prej 11.800 euro në vit. Me këtë, akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së.

Ndërsa, sipas aktakuzës, Ertan Simitqiu, akuzohet se gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2016, në cilësinë e drejtorit në Drejtorit të Financave në Komunën e Prizrenit, nuk i ka përmbushur detyrat apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personat tjerë juridik, TV Opinion, TV Besa, dhe TV Prizreni. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Simitqi, duke mos e përmbushur detyrën e përcaktuar me ligj, pa ndonjë procedurë të tenderimit në mënyrë të kundërligjshme kishte lidhur kontrata për emetimin e spoteve reklamuese lidhur me sensibilizimin e opinionit publik rreth pagesave të tatimit në pronë në Komunën Prizrenit.

Në aktakuzë thuhet se Simitqiu gjatë periudhës kohore 1 janar 2016 e deri me 31 dhjetor 2016 kishte lidhur kontratë me TV Opinionin, në vlerë prej 300 euro në muaj, dhe se për 12 muaj ka paguar 3600 euro, ndërsa në periudhën e njëjtë, kishte lidhur kontratat edhe me TV Besa dhe TV Prizreni, ku për të tre televizionet arrinte shuma prej 11.800 euro në vit. Me këto veprime, ai akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës me 26 qershor 2019 kishte ngritur kallëzim penal lidhur me këtë rast. Me 31 korrik 2019, prokuroria kishte ngritur aktakuzën ndaj Simitqit dhe Zenalajt.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur më 16 shtator 2019, apo 16 ditë pas afatit ligjor sipas të cilit, shqyrtimi fillestar mbahet brenda 30 dite pas ngritjes së aktakuzës. Në këtë seancë, të akuzuarit kishin mohuar akuzat e prokurorisë.<sup>78</sup>

---

<sup>78</sup> “Dy ish-drejtorët në Prizren mohojnë fajësinë për lidhjen e kontratave të kundërligjshme me televizionet lokale” Betimi për Drejtësi, 16 shtator 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dy-ish-drejtoret-ne-prizren->

Më 21 tetor 2019, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë në këtë rast, ku të akuzuarit kishin kërkuar që të hudhet poshtë aktakuza. Pas konfirmimit të aktakuzës ndaj tyre, shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte filluar më 28 shkurt 2020, për të vazhduar me seancat e mbajtura më 10 korrik, 24 shtator, 2 nëntor dhe 17 dhjetor 2020.

Në seancën e 17 dhjetorit të vitit të kaluar, dy ish-drejtorët komunal të Prizrenit, Zenel Ahmetaj dhe Ertan Simitqi, kishin dhënë edhe mbrojtjen e tyre.<sup>79</sup> Fjala përfundimtare në këtë rast ishte dhënë nga palët më 14 janar 2021, me ç'rast prokuroria kishte kërkuar dënim ndaj dy ish-drejtorëve komunal të akuzuar për korrupsion, ndërsa mbrojtja kishte kërkuar lirimin e të njëjtëve.<sup>80</sup>

Ndërsa, më 18 janar 2021, Gjykata Themelore në Prizren kishte shpallur aktgjykim dënues ndaj Zenel Ahmetaj dhe Ertan Simitqi, të akuzuar për korrupsion në kohën sa ishin drejtorë të Drejtorisë së Financave në Komunën e Prizrenit. Ndaj tyre kjo gjykatë kishte shqiptuar nga 6 muaj burgim me kusht, me periudhë verifikuese prej një viti për secilin prej tyre.<sup>81</sup> Kjo lëndë aktualisht ndodhet në Gjykatën e Apelit sipas procedurës ankimore.

**Dëmi i pretenduar:** 23,600.00 euro

**Konfiskim dhe sekuestrim:** Nuk ka kërkesë.

## **16. Rasti Xhemajl Syla**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.12/17

**Kryetar/e i Trupit Gjyqësor:** Medie Bytyqi (Më parë gjykuar nga Hamdi Ibrahim) i

**Prokuror/e:** Drita Hajdari

**Të akuzuar:** Xhemajl Syla

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i informatës zyrtare”

**Faza e procedurës:** Në proces.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1,786 ditë**)

---

[mohojne-fajesine-per-lidhjen-e-kontratave-te-kunderligjshme-me-televizionet-lokale/](#) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>79</sup> “Japin mbrojtjen e tyre Zenel Ahmetaj dhe Ertan Simitqi, të akuzuar për korrupsion në kohën sa ishin drejtorë të Drejtorisë së Financave në Komunën e Prizrenit”, Betimi për Drejtësi, 17 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/japin-mbrojtjen-e-tyre-zenel-ahmetaj-dhe-ertan-simitqi-te-akuzuar-per-korrupsion-ne-kohen-sa-ishin-drejto-re-te-drejtorise-se-financave-ne-komunen-e-prizrenit/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>80</sup> “Prokuroria kërkon dënimin, ndërsa mbrojtja kërkon lirimin e Zenel Ahmetaj dhe Ertan Simitqi të akuzuar për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 14 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denimin-ndersa-mbrojtja-kerkon-lirimin-e-zenel-ahmetaj-dhe-ertan-simitqi-te-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>81</sup> “Akuzoheshin për korrupsion, dënohen me burgim me kusht dy ish-drejtorët e Komunës së Prizrenit”, Betimi për Drejtësi, 18 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/akuzoheshin-per-korrupsion-denohen-me-burgim-me-kusht-dy-ish-drejto-ret-e-komunes-se-prizrenit/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

Sipas aktakuzës së ngritur nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), më 11 janar 2017, Xhemajl Sylja si udhëheqës i divizionit për mbështetje të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Luan Dalipi, drejtor në kompaninë “Management Development Association” (MDA), akuzoheshin se kanë shfrytëzuar detyrën e tyre zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë “MDA”. Kjo kompani, ka ofertuar në tenderin “Rritja e aftësisë konkurruese të sipërmarrjeve dhe promovimi i eksportit”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian, në vlerë prej dy milionë euro, në atë mënyrë që sipas marrëveshjes paraprake, pasi që është publikuar njoftimi për kontratë, të pandehurit gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator 2013, kanë shkëmbyer dokumente të brendshme të MTI-së, lidhur me kushtet dhe kriteret për tender. Sipas aktakuzës, më 4 tetor 2013, Xhemajl Sylja, ka dërguar informacione konfidenciale tek Dalipi, për procesin e vlerësimit të ofertave në këtë tender duke e njoftuar për përparësitë e kompanisë MDA, krahas kompanive tjera konkurruese në këtë proces.

Sipas pretendimeve të prokurorisë, Xhemajl Sylja ka vazhduar që t’i dërgojë informacione të njëjtë, të cilat Dalipi i kishte përdorur për përgatitjen e ofertës për procesin e përsëritur të prokurimit. Prokuroria, Xhemajl Sylajn e akuzon edhe për veprën penale “keqpërdorimi i informatës zyrtare”.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur më 25 prill 2017, jashtë afatit ligjor, sipas të cilit shqyrtimi fillestar mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 2 qershor 2017. Pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë, e kishte konfirmuar aktakuzën ndaj Sylajt dhe Dalipit, kishte qenë Gjykata e Apelit ajo e cila, në vitin 2017 kishte hudhur poshtë akuzën për Dalipin kurse e kishte konfirmuar për sa i përket të akuzuari Sylja. Pas kësaj Sylaj i ishte drejtuar me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Gjykatës Supreme, mirëpo kjo gjykatë e kishte refuzuar kërkesën e tij.

Më 6 dhjetor 2018, prokuroria e kishte ndryshuar aktakuzën, ashtu që tash Sylajn e ngarkon vetëm për veprën penale “keqpërdorim i informatës zyrtare”.

Aktualisht kjo lëndë i është ndarë në punë gjykatëse Medie Bytyqi. Gjykata Themelore në Prishtinë ka dështuar që të procedojë me efikasitet në trajtimin e këtij rasti, pasi që gjatë tërë vitit 2020 nuk është caktuar asnjë seancë gjyqësore për procedimin e kësaj çështjeje penale.

Gjatë vitit 2021, gjykata ka caktuar katër seanca gjyqësore për të trajtuar këtë rast, nga të cilat një e tillë kishte dështuar të mbahej<sup>82</sup>, ku po procedohet me dëgjim të dëshmitarëve.

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka informacion

---

<sup>82</sup> “Mungon mbrojtësi i të akuzuarit, dështon seanca ndaj ish-zyrtarit të MTI-së të akuzuar për keqpërdorim të informatës zyrtare”, Betimi për Drejtësi, 23 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/mungon-mbrojttesi-i-te-akuzuarit-deshton-seanca-ndaj-ish-zyrtarit-te-mti-se-te-akuzuar-per-keqperdorim-te-informates-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 15 nëntor 2021).

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion

### **17. Rasti Enver Hoxha**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.148/2018

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Medie Bytyqi (Më parë gjykuar nga Hamdi Ibrahim).

**Prokuror/e:** Merrushe Llugiqi

**Të akuzuar:** Enver Hoxha

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Në proces (Rigjykim)

(Nga ngritja e aktakuzës deri 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1823 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 5 dhjetor 2016 kishte ngritur aktakuzë sipas të cilës Enver Hoxha ngarkohet me veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar”.

Sipas prokurorisë, i lartcekuri në qershor të vitit 2013, në pozitën e projekt menaxherit të divizionit për prodhimin e qymyrit, në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) ka lejuar blerjen e 2,464 “maicave” nga operatori ekonomik “Ripten Engineering”, me seli në Prishtinë.

Sipas aktakuzës, këtë leje, Hoxha e kishte dhënë pa i përfillur procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik, duke vepruar kështu në kundërshtim edhe me kontratën në të cilën është thirrur. Sipas prokurorisë, me këto veprime i ka shkaktuar dëm KEK-ut, në shumë të përgjithshme prej 57.164,80 eurosh.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës më 24 dhjetor 2015 kishte ushtruar kallëzim penal ndaj Hoxhës, kurse prokuroria kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve lidhur me këtë rast më 2 qershor 2016.

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 5 dhjetor 2016. Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 20 shkurt 2017, apo 46 ditë pas afatit ligjor, sipas të cilit shqyrtimi fillestar mbahet brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 22 mars 2017, kurse deri në shpalljen e aktgjykimit ishin mbajtur gjashtë (6) seanca gjyqësore.

Më 23 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte liruar nga akuza Hoxhën.<sup>83</sup>Mirëpo, pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit më 17 maj 2018 e kishte kthyer rastin në rigjykim.

Kjo lëndë i është ndarë në punë gjykatëses Medie Bytyqi, e cila këtë vit është avancuar si gjyqtare në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Vlen të theksohet se gjatë vitit të kaluar gjykata nuk ka caktuar asnjë seancë gjyqësore për trajtimin e

---

<sup>83</sup> “Zyrtari i KEK-ut lirohet nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare” Betimi për Drejtësi, 23 janar 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtari-i-kek-ut-lirohet-nga-akuza-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

këtij rasti penal. Situatë e ngjashme paraqitet edhe gjatë vitit 2021, me ç'rast gjatë kësaj periudhe raportuese nuk rezulton të jetë caktuar seancë gjyqësore për trajtimin e këtij rasti.

**Dëmi i pretenduar:** 57,164.80 euro.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion

### **18. Rasti Musë Shala**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.760/2016

**Kryetar/e i Trupit Gjyqësor:** Alltën Murseli (Paraprakisht Hamdi Ibrahimimi)

**Prokuror/e:** Shkelzen Ibrahimimi (Paraprakisht Feti Tunuzliu)

**I akuzuar:** Musë Shala

**Veprat penale:** “Marrje ryshfeti”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim refuzues.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në parashkrimin e lëndës kanë kaluar **1619 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 19 dhjetor 2016 kishte ngritur aktakuzë sipas të cilës, Musa Shala si person zyrtar në mënyrë të drejtpërdrejt ka kërkuar dhe pranuar përfitim në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare. Ai akuzohet se ka kërkuar nga Nysret Berisha pesë mijë euro të cilat i ka pranuar në lokalin “Albana”. Ndër tjera, sipas aktakuzës, ai ka nënshkruar situacionin e dytë në vlerë prej 155,202.04 euro sipas raportit të pagesës. Me këtë, ai konsiderohet se ka kryer veprën penale “marrje ryshfeti” nga neni 343 paragrafi 1 i KPRK-së.

Aktakuza e ngarkon Musa Shalën edhe me veprën penale keqpërdorim të pozitës zyrtare . Sipas aktakuzës, ai si zyrtar i inspektimit të projekteve, përkatësisht projekt-menaxher në MASHT, në dosjen e tenderit për punë në vlerë të madhe, përgatitur më 14 gusht 2009 me titull Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme, pas lidhjes së kontratës mes autoritetit kontraktues përfaqësuar nga Xhemajl Buzuku dhe operatori ekonomik “Ndërtimtari” SH.P.K, përfaqësuar nga Avni Mustafa më 9 tetor 2009 në vlerë prej 2.226.064.30 euro dhe pasi që operatori ekonomik “Ndërtimtari” me bashkëpronarët Avni Mustafa dhe Mustaf Mustafa, i cili si porositës e ka përfaqësuar kontratën, garantuar nga Rafet Ibishi, e të cilët e kanë fituar këtë tender me çmimin e përmendur, operatori ekonomik “ Ndërtimtari” më 14 shkurt 2011 ka nën kontraktuar me “Con Inga” sh.p.k , pronë e bashkëpronarëve Nysret Berisha dhe tani të ndjerit Naser Preniqi.

Në aktakuzë thuhet se ai si zbatues i punimeve ka përfaqësuar kontratën duke lidhur kontratën për ndërtim në shumë prej 1.384.689.50 euro, me të cilën kontratë veç tjerash është parashikuar që përfundimi i këtij projekti do të bëhet brenda 150 ditëve të punës nga dita e fillimit të punimeve për çdo faturë lidhur me punët kryera në objekt, në vlerë prej 110 mijë eur,o pagesa do të bëhet në shumë prej 100 mijë euro pa llogaritur 10% që do të ndalet nga pagesa e çdo fature.

Për çka, sipas aktakuzës, ka qenë në dijeni Musa Shala, por me dashje për këtë nuk e ka njoftuar fare autoritetin kontraktues, ndonëse operatori ekonomik ka vepruar në kundërshtim me dy akte juridike, nenin 30 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr 04/L-237, 05/L-068 dhe nr.05/L-092 që ka parashikuar se tenderuesi ka dashtë të tregojë në tenderin e tij që ka për qëllim të nënkontrakttojë palët e treta.

Në vijim thuhet se rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim edhe me Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik të KRRPP, të janarit 2012, ku në pikën 17, titulluar “Dosja e tenderit”, nënpika 17.13 është paraparë që autoriteti kontraktues të deklarojë në dosjen e tenderit që operatorët ekonomik duhet të tregojnë në tenderin e tyre çdo pjesë të kontratës që operatorët ekonomik kanë për qëllim të nënkontrakttoj te palët e treta dhe se nën kontraktimi nuk bën të kalojë 40% ë vlerës totale të kontratës, si ka ndodhur në rastin konkret.

Ndërsa, i akuzuari Mustafë Mustafa, sipas aktakuzës, në cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit ligjor të kompanisë ndërtimore “Ndërtimtari” ka keqpërdorur pozitën e tij. Ai sipas aktakuzës, në emër të kësaj kompanie ka lidhur kontratë me autoritetin kontraktues në vlerë prej 2,226,063.20 euro, e më pas ka lidhur kontratë ndërtimi me të njëjtin autoritet kontraktues me çmim kontraktues tjetër, në vlerë prej 1.384,689,50 euro, duke nënkontraktuar mbi vlerën 40% të vlerës totale të kontratës, gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës lidhur me këtë rast kishte ushtruar kallëzim penal më 7 shkurt 2013, kurse prokuroria kishte ngritur aktakuzë ndaj dy të pandehurve më 19 dhjetor 2016.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 26 tetor 2017, apo 280 ditë pas kalimit të afatit ligjor, sipas të cilit, shqyrtimi fillestar duhet të mbahet brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Në këtë seancë, dy të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>84</sup>

Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte filluar më 20 mars 2019, ndërsa dy seanca që ishin caktuar për 29 maj dhe 15 korrik 2019 kishte dështuar të mbahen në mungesë së të akuzuarve. Në seancën e 15 korrikut 2019, gjykata kishte lëshuar urdhërese për sjellje me detyrim për dëshmitarët që kishin munguar.<sup>85</sup>

Pas avancimit në Gjykatën Supreme të gjykatësit Hamdi Ibrahim, kjo lënda tashmë i ka kaluar për gjykim gjykatëses Alltën Murseli. Nën udhëheqjen e gjyqtares Murseli, ishin tentuar të

---

<sup>84</sup> “Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për marrje ryshfeti dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare” Betimi për Drejtësi, 26 tetor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-marrje-ryshfeti-dhe-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>85</sup> “Lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim për dëshmitarët që munguan në gjykimin lidhur me ndërtimin e shkollës në Podujevë”, Betimi për Drejtësi, 15 korrik 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/leshohet-urdherese-per-sjellje-me-detyrim-per-deshmitaret-qe-munguan-ne-gjykimin-lidhur-me-ndertimin-e-shkolles-ne-podujeve/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

mbaheshin seancat e 9 dhjetorit 2020<sup>86</sup> dhe 13 janarit 2021<sup>87</sup>, si pasojë e mungesës së të akuzuarve.

Ndërkaq, në seancën e 23 shkurtit 2021, gjykatësja Murseli njoftoi se jashtë seancës, më 15 shkurt të këtij viti, kishte marr vendim me të cilin ishte hedhur poshtë aktakuza e PTH në Prishtinë, dhe ishte pushuar procedura penale ndaj Musa Shala dhe Mustaf Mustafa për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare. Kjo pasi sipas saj ndjekja penale për këtë veprë për të cilën janë akuzuar ka arritur parashkrimin me datë 14 shkurt 2021. Në rrethana të tilla, gjykimi ka vazhduar vetëm ndaj të akuzuarit Musa Shala, vetëm për veprën penale “marrje ryshfeti”.<sup>88</sup> Në seancën e 20 majit 2021, e cila kishte dështuar të mbahej, gjykatësja e rastit Alltën Murseli kishte njoftuar se për veprën penale marrja e ryshfetit parashkrimi absolut arrihej më 25 maj 2021.<sup>89</sup> Andaj, në rrethana të tilla e njëjta ka nxjerrë aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit Musa Shala.

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka informacion.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion.

## 19. Rasti Armend Selimi, Durim Ramadani, Zeqir Fetoshi

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.240/16

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Medie Bytyqi (Paraprakisht Kujtim Krasniqi dhe Hamdi Ibrahim)

**Prokuror/e:** Dulina Hamiti

**Të akuzuar:** Armend Selimi; Durim Ramadani; Zeqir Fetoshi

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”; “Mashttrim”; “Falsifikim i dokumenteve zyrtare”

**Faza e procedurës:** Në proces.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **2052 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 20 prill 2016, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Armend Selimi, akuzohet se në cilësinë e pronarit të firmës NTP “Friends” në Prishtinë, nga viti 2013,

<sup>86</sup> “Dështon gjykimi për korrupsion ndaj të akuzuarve lidhur me ndërtimin e shkollës në Podujevë”, Betimi për Drejtësi, 9 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-te-akuzuarve-lidhur-me-ndertimin-e-shkolles-ne-podujeve-2/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>87</sup> “Mungojnë të akuzuarit, dështon gjykimi për korrupsion lidhur me ndërtimin e shkollës në Podujevë”, Betimi për Drejtësi, 13 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-te-akuzuarit-deshton-gjykimi-per-korrupsion-lidhur-me-ndertimin-e-shkolles-ne-podujeve/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>88</sup> “Gjykimi lidhur me ndërtimin e shkollës në Podujevë, parashkruhet vepra penale për keqpërdorim të detyrës zyrtare për dy të akuzuarit, vazhdon gjykimi ndaj njërit të akuzuar për marrje ryshfeti”, Betimi për Drejtësi, 23 shkurt 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-lidhur-me-ndertimin-e-shkolles-ne-podujeve-parashkruhet-vepra-penale-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare-per-dy-te-akuzuarit-vazhdon-gjykimi-ndaj-njerit-te-akuzuar-per-marrje-ryshfeti/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>89</sup> “Mungon zyrtari i ministrisë i akuzuar për marrje ryshfeti, lënda i parashkruhet pas pesë ditësh”, Betimi për Drejtësi, 20 maj 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-zyrtari-i-ministrise-i-akuzuar-per-marrje-ryshfeti-lenda-i-parashkruhet-pas-pese-ditesh/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

deri në korrik të vitit 2014, me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka falsifikuar dokumentin më të cilin ka dashur që të fitoi një tender. Duke dashur të importojë produkte medicinale dhe të sigurojë autorizime nga ana e Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) thuhet se ka falsifikuar certifikatat e dorëzuara në AKPPM. Me këtë rast, ai konsiderohet se ka kryer veprat penale mashtrim dhe falsifikim, vepra të dënuara më Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, të akuzuarit Durim Ramadani dhe Zeqir Fetoshi, sipas aktakuzës, duke keqpërdorur pozitën apo autoritetin zyrtar dhe me qëllim që vetës t'i sjellin dobi pasurore, nuk kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare.

Ata thuhet se në cilësinë e ekspertëve të angazhuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk e kanë kryer punën e tyre në përputhje më ligjin, lidhur me tenderin për të cilin Armend Selimi, pretendohet se i kishte falsifikuar dokumentet.

Sipas Prokurorisë, ata kishin keqpërdorur pozitën e tyre lidhur me tenderin për "Furnizim me material shpenzues" nga lista esenciale nga Ministria e Shëndetësisë. Të njëjtin sipas aktakuzës kishin qenë në dijeni se autorizimi i lëshuar nga Korporata- Prodhuesi "Johnson & Friends" në Londër është i falsifikuar, dhe se këtë autorizim e kishte përfaqësuar i pandehuri Armend Selimi. Në bazë të kësaj, ata thuhet se e kanë ditur se këto dokumente janë të falsifikuara dhe kanë dhënë mendim dhe kanë konstatuar se dosja është origjinale. Në këtë formë, sipas aktakuzës, kompania "Friends" ka arritur ta fitojë tenderin nga Ministria e Shëndetësisë.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovë më 18 dhjetor 2014 kishte ushtruar kallëzim penal për këtë rast, kurse me 20 prill 2016, prokuroria kishte ngritur aktakuzë ndaj tre të akuzuarve.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte caktuar të mbahet më 12 qershor 2017, apo 388 ditë pas kalimit të afatit ligjor, sipas të cilit shqyrtimi fillestar mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Mirëpo, edhe kjo seancë kishte dështuar të mbahet pasi kishin munguar të akuzuarit.<sup>90</sup> Edhe seanca e tjetër e caktuar të mbahet më 27 qershor 2017 kishte dështuar të mbahet pasi kishte munguar prokurorja.<sup>91</sup> Përfundimisht, shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 28 gusht 2017, me ç'rast të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>92</sup>

---

<sup>90</sup> "Shtyhet seanca ndaj të akuzuarve për mashtrim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare" Betimi për Drejtësi, 12 qershor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-ndaj-te-akuzuarve-per-mashtrim-dhe-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>91</sup> "Mungon prokurorja, shtyhet seanca ndaj të akuzuarve për mashtrim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare" Betimi për Drejtësi, 27 qershor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurorja-shtyhet-seanca-ndaj-te-akuzuarve-per-mashtrim-dhe-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>92</sup> "Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për mashtrim dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare" Betimi për Drejtësi, 28 gusht 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-mashtrim-dhe-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte caktuar të mbahet më 30 janar 2018, mirëpo ishte shtyrë pasi kishte munguar prokurorja. Lidhur me këtë, gjykatësi i rastit kishte thënë se do të njoftohet edhe kryeprokurori.<sup>93</sup>

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 14 prill 2018, i kishte aprovuar kërkesat për hudhje të aktakuzës ndaj Durim Ramadanit dhe Zeqir Fetoshit, pasi që lidhur me kundërshtimet e tyre, për rreth gjashtë muaj nuk kishte dhënë përgjigje prokurorja e këtij rasti, Dulina Hamiti. Kjo kishte qenë arsyeja se pse kjo gjykatë e ka hudhur poshtë aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë për këta dy të akuzuar edhe pse sipas gjykatësit të rastit, gjykata katër herë kishte kërkuar nga prokuroria që të përgjigjet në kundërshtimet e bëra nga ana e mbrojtjes. Arsye tjetër e hudhjes së kësaj aktakuze, sipas këtij aktvendimi, është se nuk është vërtetuar se qysh të akuzuarit Ramadani e Fetoshi, i kanë kryer veprat penale të pretenduara nga Prokuroria. Ndërsa, për Armend Selimin, i akuzuar për mashtrim dhe falsifikim të dokumentit publik, gjykata ka vendosur që të mos hudh poshtë aktakuzën dhe shqyrtimi ndaj tij, do të caktohet më vonë.<sup>94</sup>

Mirëpo, pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit kishte vendosur se gjykimi në këtë rast duhet të vazhdojë për të gjithë të akuzuarit.<sup>95</sup>

Pas vendimit të Apelit, në këtë rast janë caktuar deri më tani pesë (5) seanca gjyqësore, mirëpo katër (4) prej tyre kanë dështuar të mbahen. Dy (2) nga to kishin dështuar shkak i mungesës së prokurores, një (1) shkak i mungesës së anëtarit të trupit gjykues dhe një (1) me kërkesë të avokatit të akuzuarit.

Ky rast tashmë është duke u gjykuar nga gjykatësi Kujtim Krasniqi, pas avancimit në Gjykatën Supreme të gjykatësit Hamdi Ibrahimit. Gjykatësi Krasniqi, pas marrjes në detyrë të kësaj lënde, kishte caktuar dy seanca gjyqësore, për datat 5 nëntor<sup>96</sup> dhe 3 dhjetor 2020<sup>97</sup>. Seanca e 5 nëntorit nuk ishte mbajtur për shkak se nuk prezantonte prokurorja e rastit, ndërsa në seancën e 3 dhjetorit 2020 shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte filluar rishtazi, si pasojë e ndryshimit

---

<sup>93</sup> “Mungon prokurorja Dulina Hamiti, gjykata thotë se për mungesën e saj do të njoftohet Kryeprokurori i Shtetit” Betimi për Drejtësi, 30 janar 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurorja-dulina-hamiti-gjykata-thote-se-per-mungesen-e-saj-do-te-njoftohet-kryeprokurori-i-shtetit/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>94</sup> “Gjykata hedh poshtë aktakuzën për korrupsion pasi prokurorja nuk përgjigjet në kundërshtimet e mbrojtjes” Betimi për Drejtësi, 29 prill 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-hedh-poshte-aktakuzen-per-korrupsion-pasi-prokurorja-nuk-pergjigjet-ne-kundershtimet-e-mbrojtjes/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>95</sup> “Apeli kërkon që të vazhdojë gjykimi kundër dy ish-ekspertëve të OSHP-së, ndaj të cilëve ishte hedhur aktakuza për korrupsion” Betimi për Drejtësi, 27 qershor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-kerkon-qe-te-vazhdoje-gjykimi-kunder-dy-ish-eksperteve-te-oshp-se-ndaj-te-cileve-ishte-hedhur-aktakuza-per-korrupsion/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>96</sup> “Dështon të mbahet gjykimi për korrupsion ndaj ish-ekspertëve të OSHP-së dhe të akuzuarit tjetër”, Betimi për Drejtësi, 5 nëntor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-te-mbahet-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-ish-eksperteve-te-oshp-se-dhe-te-akuzuarit-tjeter/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>97</sup> “Gjykimi ndaj ish-ekspertëve të OSHP-së, gjykata obligon prokurorinë që t’i përkthej provat në gjuhë shqipe”, Betimi për Drejtësi, 3 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-eksperteve-te-oshp-se-gjykata-obligon-prokurorine-qe-ti-perkthej-provat-ne-gjuhe-shqipe/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

të përbërjes së trupit gjykues. Aktualisht, në këtë rast gjykata në seancat e mbajtura më 3 shtator<sup>98</sup> dhe 11 tetor 2021<sup>99</sup>, ka bërë administrimin e provave materiale.

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka informacion.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion

## **20. Rasti Sadik Tahiraj**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.53/21

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Fatime Dërmaku (Paraprakisht Naime Krasniqi – Jashanica)

**Prokuror/e:** Dulina Hamiti

**Të akuzuar:** Sadik Tahiraj

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”;

**Faza e procedurës:** Rigjykim.

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1191 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 29 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzë sipas të cilës, Sadik Tahiraj në cilësinë e personit zyrtar, derisa ishte në pozitën e drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Drenas, ka shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar duke i tejkaluar kompetencat e tij. Në aktakuzë thuhet se këtë e ka bërë me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete ose për organizatën e biznesit “A&I Group” SH.P.K dhe “Al Trade” SH.P.K.

Sipas aktakuzës, që nga fillimi deri në përfundim të projekteve kapitale, ndërtimi i depos për dru dhe thëngjill në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Rasim Këçina” në Drenas dhe renovimi i kulmit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Rilindja” në Dobroshevc, janë kryer pa respektuar asnjë procedurë të prokurimit. Sipas aktit akuzues, për projektin për ndërtimin e depos për dru dhe thëngjill në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Rasim Këçina” në Drenas, që “Al Trade” SH.P.K. e ka furnizuar gjatë vitit 2015, me material ndërtimor është kryer pa respektuar asnjë procedurë të prokurimit, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit lidhur mes të pandehurit dhe firmës së lartcekur.

Aktakuza thotë se renovimi i kulmit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Rilindja” në Dobroshevc, ku “A&I Group SH.P.K i ka kryer punimet gjatë vitit 2016, është bërë pa u respektuar asnjë procedurë e prokurimit në marrëveshje gojore me të pandehurin. Akti akuzues, thotë se me këtë rast është dëmtuar Komuna e Drenasit dhe është dashur të paguaj përmes përmbaruesit privat shumë prej 17.043.50 euro. Ndërsa, për projektin për ndërtimin e depos

---

<sup>98</sup> “Administrohen provat materiale në gjykimin për korrupsion ndaj dy ekspertëve të OSHP-së dhe një biznesmeni”, Betimi për Drejtësi, 3 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/administrohen-provat-materiale-ne-gjykimin-per-korrupsion-ndaj-dy-eksperteve-te-oshp-se-dhe-nje-biznesmeni/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>99</sup> “Vazhdon administrimi i provave në gjykimin për korrupsion ndaj dy ekspertëve të OSHP-së dhe një biznesmeni”, Betimi për Drejtësi, 11 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-administrimi-i-provave-ne-gjykimin-per-korrupsion-ndaj-dy-eksperteve-te-oshp-se-dhe-nje-biznesmeni/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

për dru dhe thëngjill në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Rasim Kiçina” në Drenas, thuhet se është dashur të paguaj shumën prej 8.454.31 euro.

Ish-drejtori i Arsimit në Drenas, Sadik Tahiraj, ka qenë i akuzuar edhe në një rast tjetër, me ç’rast me 21 shtator 2018, ai ishte dënua me gjashtë muaj burgim me kusht, pasi ishte shpallur fajtor për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Ndërsa, në rastin tjetër ku i bashkakuzuar kishte qenë edhe ish-kryetari i Drenasit Nexhat Demaku, të dy të akuzuarit janë liruar nga akuza. Në këtë rast, Tahiraj akuzohej se në vitin 2014 ka keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, duke mos respektuar procedurat e prokurimit publik lidhur me furnizimin me vaj (antifiriz) për ngrohjen qendrore të shkollës “Rilindja” në fshatin Dobroshec të Komunës së Drenasit.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës kishte ngritur kallëzim penal ndaj Tahirajt më 18 korrik 2017, kurse, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë ndaj tij më 29 gusht 2018.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte caktuar të mbahet më 24 tetor 2018, apo 25 ditë pas kalimit të afatit ligjor, sipas të cilit, shqyrtimi fillestar mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Mirëpo, kjo seancë kishte dështuar të mbahet pasi kishte munguar prokurorja e rastit.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur pastaj më 29 nëntor 2018, ku i akuzuari Tahiraj ishte deklaruar i pafajshëm.<sup>100</sup>

Pas konfirmimit të aktakuzës, lidhur me këtë rast ishin mbajtur edhe pesë (5) seanca gjyqësore, derisa Tahiraj, më 5 mars 2020, ishte shpallur i pafajshëm.<sup>101</sup>

Ndërkaq, Gjykata e Apelit me vendimin e saj të nxjerrë më 8 shkurt 2021, kishte aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe sipas detyrës zyrtare e kishte anuluar vendimin për lirim nga akuza të të akuzuarit për korrupsion, Sadik Tahiraj. Apeli, të njëjtën çështje ia ka kthyer gjykatës në shkallë të parë në rivendosje. Pas kthimit të rastit në rigjykim, gjykata akoma nuk ka proceduar me trajtimin e këtij rasti.

**Dëmi i pretenduar:** 25,497 euro.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion

---

<sup>100</sup> “Ish-drejtori i Arsimit në Drenas deklarohet i pafajshëm për keqpërdorim detyre” Betimi për Drejtësi, 29 nëntor 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-arsimit-ne-drenas-deklarohet-i-pafajshem-per-keqperdorim-detyre/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>101</sup> “Ish-drejtori i Arsimit në Drenas lirohet nga akuza lidhur me investimet në dy shkolla” Betimi për Drejtësi, 5 mars 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-arsimit-ne-drenas-lirohet-nga-akuza-lidhur-me-investimet-ne-dy-shkolla/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

## **21. Rasti Xhelil Bekteshi dhe Besim Tahiri**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.16/18

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Fatime Dërmaku (Paraprakisht Naime Krasniqi – Jashanica)

**Prokuror/e:** Ibrahim Berisha

**Të akuzuar:** Xhelil Bekteshi; Besim Tahiri

**Veprat penale:** “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të parë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në Aktgjykimin e shkallës së parë kanë kaluar **1,285 ditë**)

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 29 janar 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj Xhelil Bekteshit dhe Besim Tahirit, me pretendimin se kishin kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe ndaj Naim Sallahut, për veprën penale “falsifikim i dokumentit”. Bekteshi, sipas kësaj aktakuze, thuhet se derisa ishte në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës (MI), kishte tejkaluar kompetencat tij si person zyrtar.

Sipas aktakuzës, ai kishte obliguar zyrtaren (arkivistin) Valentina Rexhepi që në librin e protokollit të regjistronte vendimin me të cilin ishte ndërruar kryetarja e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin “Zgjerimi i Rrugës Nacionale N-9” segmenti Gjurgjicë-Kijevë, duke regjistruar vendimin me datën 23.05.2016 në vend të datës reale 26.06.2016. Ky ndryshim i datave ishte bërë me qëllim që tenderi t’i jepej operatorit ekonomik N.N.T “Sallahu”, i cili ishte me çmim të lartë 991,418.19 euro, ndërsa operatorit tjetër ekonomik “Famis”, me çmim më të lirë prej 961.590.16 euro, i ishte pamundësuar fitimi i tenderit edhe pse ishte me oferte më të lirë.

Ndërsa, Besim Tahiri po akuzohet se në cilësinë e ushtruesit të detyrës së Drejtorit në Divizionin e Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës (MI), kishte tejkaluar kompetencat e tij duke ushtruar ndikim te kryetarja e komisionit Erza Arifi, që e njëjta ta ndërrojë raportin për vlerësimin e tenderit. Sipas prokurorisë, Tahiri e kishte obliguar Arifin që të paraqes kërkesë me shkrim për tërheqje nga komisioni në mënyrë që të bëhej ndryshimi i vendimit të marrë dhe tenderi t’i jepej operatorit ekonomik “Sallahu” edhe pse kishte çmim më të shtrenjtë.

Ndërsa, aktakuza të akuzuarin Naim Sallahu, pronar i kompanisë N.N.T “Sallahu”, e ngarkon me veprën penale “falsifikim të dokumentit” pasi që i njëjti thuhet se me rastin e paraqitjes së ofertës në MI lidhur me tenderin për zgjerimin e rrugës nacionale kishte paraqitur dokument të falsifikuar me vërtetim tatimor kinse ka kryer obligimet tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Sipas aktakuzës, i akuzuari Sallahu edhe pse e kishte ditur se një dokument i tillë nuk është i vërtetë dhe se nuk i kishte të shlyera detyrimet tatimore e kishte paraqitur si të vërtetë. Sallahu thuhet se edhe listën e punëtorëve e kishte paraqitur me 50 punëtorë, ndërsa në realitet kishte pasur vetëm 29 punëtorë.

Në këtë rast, bashkë me Bekteshin e Tahirin, është akuzuar edhe Naim Sallahu, por ai kishte bërë marrëveshje me Prokurorinë për pranimin e fajësisë dhe ishte dënuar me gjashtë muaj burgim, por që i ishte zëvendësuar në dënim me gjobë.

**Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës më 15 mars 2017 kishte ushtruar kallëzim penal ndaj të pandehurve, kurse me 29 janar 2018, prokuroria kishte ngritur aktakuzë ndaj të njëjtëve.

Shqyrtimi fillestar ishte caktuar fillimisht më 27 mars 2018, mirëpo, pasi që kishte munguar një i akuzuar, e njëjti ishte shtyrë. Në këtë seancë, gjykata kishte vendosur që të veçojë procedurën për të akuzuarin Sallahu, pasi ai kishte arritur marrëveshje për pranim të fajësisë me prokurorinë.<sup>102</sup> Edhe seanca tjetër e caktuar për 11 prill 2018 kishte dështuar të mbahet. Përfundimisht, shqyrtimi fillestar për të akuzuarit Bekteshi dhe Tahiri ishte mbajtur pastaj për 10 maj 2018, apo 71 ditë pas kalimit të afatit ligjor, sipas të cilit, shqyrtimi fillestar mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Në këtë seancë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.<sup>103</sup>

Ky rast është karakterizuar me zvarritje të shumta si pasojë e dështimit për mbajtjen e seancave gjyqësore. Gjatë vitit 2019, ishin mbajtur gjithsej tri seanca, ajo e 17 prillit, 20 majit dhe 20 nëntorit, ndërsa ishin shtyrë tri të tjera, ato të 17 qershorit, 30 korrikut e 27 shtatorit 2019. Ngjashëm, vitin 2020 ishte mbajtur vetëm një seancë, ajo e 2 marsit, ndërsa kishin dështuar të mbahen katër të tjera, seancat e 4 shkurtit, 3 korrikut, 24 korrikut e 2 shtatorit 2020. Pas degradimit të gjykatës Naime Krasniqi-Jashanica, kjo lëndë i kishte kaluar gjykatës Fatime Dërmaku. E njëjta, seancën në këtë rast e kishte caktuar më 18 shkurt 2021, por kjo seancë nuk ishte mbajtur, pasi prokurori nuk kishte qenë i njohur me lëndën.<sup>104</sup> Pas kësaj, gjykata ka caktuar edhe tri seanca të tjera gjyqësore më datat 8 mars, 12 mars dhe 13 prill 2021.

Në fund të këtij procesi gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë më 6 gusht 2021 ka shpallur aktgjykim dënues ndaj Bekteshit dhe Tahirit. Dy ish-zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), Xhelil Bekteshi dhe Besim Tahiri janë dënuar me nga 3 vite burgim efektiv për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Të njëjtëve iu shqiptua edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratë publike në kohëzgjatje prej dy vitesh. Bekteshi dhe Tahiri obligohen gjithashtu që Ministrisë së Infrastrukturës t’ia paguajnë 29,828 euro kompensim për dëmin e shkaktuar.<sup>105</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 29,828.00 euro

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion.

---

<sup>102</sup> “Veçohet procedura ndaj të pandehurit për falsifikim të dokumentit, në rastin ku të akuzuar janë dy edhe zyrtarë të MI-së” Betimi për Drejtësi, 27 mars 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/vecohet-procedura-ndaj-te-pandehurit-per-falsifikim-te-dokumentit-ne-rastin-ku-te-akuzuar-jane-dy-edhe-zyrtare-te-mi-se/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>103</sup> “Gjykimi për dallavere në tender, deklarohen të pafajshëm dy ish-zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës” Betimi për Drejtësi, 10 maj 2018 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-dallavere-ne-tender-deklarohen-te-pafajshem-dy-ish-zyrtaret-e-ministrise-se-infrastruktures/>) Qasur për herën e fundit, 8 maj 2020.

<sup>104</sup> “Prokurori thotë se nuk ka njohuri për aktakuzën që përfaqëson, dështon gjykimi për keqpërdorim detyre ndaj ish-zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës”, Betimi për Drejtësi, 18 shkurt 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-thote-se-nuk-ka-njohuri-per-aktakuzen-qe-perfaqeson-deshton-gjykimi-per-keqpedorim-detyre-ndaj-ish-zyrtareve-te-ministrise-se-infrastruktures/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>105</sup> “Dy ish-zyrtarët e MI-së dënohen me nga 3 vite burgim për korrupsion, obligohen t’i kthejnë afro 30 mijë euro”, Betimi për Drejtësi, 6 gusht 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-ish-zyrtaret-e-mi-se-denohen-me-nga-3-vite-burgim-per-korrupsion-obligohen-ti-kthejne-afro-30-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

## **22. Rasti Kujtim Gashi**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.111/19

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Raime Elezi

**Prokuror/e:** Mehdi Sefa

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Të akuzuar:** Kujtim Gashi

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të dytë.

(Nga ngritja e aktakuzës deri në Aktgjykimin e shkallës së dytë kanë kaluar 463 ditë)

Prokuroria Themelore në Prizren më 17 dhjetor 2019 kishte ngritur aktakuzë ndaj Kujtim Gashit, të cilin e akuzon se gjatë vitit 2015 e deri në tetor 2016, në cilësinë e kryesuesit të Asamblesë Komunale në Prizren, nuk i ka përmbushur detyrat apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personat tjerë juridik, “TV Besa” dhe “TV Opinion”. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Gashi, duke mos e përmbushur detyrën e përcaktuar me ligj, pa ndonjë procedurë të tenderimit, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe Rregulloren e Thesarit, kishte lidhur kontratë për ritransmetimin e seancave të Asamblesë Komunale në Prizren.

Sipas aktakuzës, Gashi, gjatë periudhës kohore 8 janar 2015, kishte lidhur kontratë me “TV Besa”, në vlerë prej 250 euro për çdo seancë, ndërsa pagesat për këto shërbime janë autorizuar gjatë vitit 2016 në shumën prej 1,750 euro. Tutje në aktakuzë thuhet se ai po ashtu, gjatë periudhës kohore 8 janar 2015, kishte lidhur kontratë me “TV Opinion”, në vlerë prej 400 euro, për ritransmetimin e seancave të Asamblesë Komunale në Prizren, ku pagesat sipas aktakuzës janë transferuar gjatë viteve 2015-2016 në shumën prej 6700 euro. Ndërsa sipas aktit akuzues, vlera e përgjithshme që Gashi ka autorizuar për këto dy televizione është 8450 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës kishte ushtruar kallëzim penal ndaj ish-ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi më 25 qershor 2019, kurse prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Mehdi Sefa, më 17 dhjetor 2019, kishte ngritur aktakuzën ndaj Gashit.

Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur më 3 janar 2020, brenda afatit ligjor. Në këtë seancë, Gashi nuk e kishte pranuar fajësinë.<sup>106</sup> Shqyrtimi i dytë për këtë rast ishte mbajtur më 5 shkurt 2020, ku Gashi kishte kërkuar që të hudhet poshtë aktakuza ndaj tij. Mirëpo, këtë kërkesë të mbrojtjes së Gashit e kishte refuzuar gjykata e shkallës së parë duke e lënë në fuqi aktakuzën ndaj Gashit.<sup>107</sup> Kundër vendimit të Themelores, mbrojtja e Gashit kishte ushtruar

---

<sup>106</sup> “Kujtim Gashi deklarohet i pafajshëm për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi, 3 janar 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kujtim-gashi-deklarohet-i-pafajshem-per-keqpërdorim-detyre/>) Qasur për herën e fundit, 18 maj 2020.

<sup>107</sup> “Gjykata refuzon kërkesën për hudhje të aktakuzës në rastin e ish-ministrit Kujtim Gashi”. Betimi për Drejtësi, 20 mars 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-refuzon-kerkesen-per-hudhje-te-aktakuzes-ne-rastin-e-ish-ministrit-kujtim-gashi/>) Qasur për herën e fundit më 18 maj 2020.

ankesë në Gjykatën e Apelit, mirëpo edhe kjo e fundit ka vendosur që të refuzojë kërkesën e mbrojtjes së Gashit, duke e lënë në fuqi aktakuzën.

Fjala përfundimtare në këtë rast ishte dhënë më 18 dhjetor 2020, me ç'rast prokurori i rastit kishte kërkuar shpalljen fajtorë dhe dënimin e të akuzuarit Gashi për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ndërsa mbrojtja ka kërkuar nga gjykata shqiptimin e aktgjykimit lirues.<sup>108</sup>

Ndërsa, Gjykata Themelore në Prizren, më 23 dhjetor 2020 ka liruar nga akuzat për korrupsion ish-ministrin e kulturës, Kujtim Gashi, nën arsyetimin se nuk ishte provuar se i akuzuari kishte kryer veprën penale që i ngarkohet.<sup>109</sup> Gjykata e Apelit me vendimin e saj të nxjerrë më 23 mars 2021 ka vërtetuar aktgjykimin lirues të nxjerrë në shkallë të parë ndaj Gashit.<sup>110</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 8,450 euro

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion

### **23. Rasti i Salih Kqiku etj.**

**Gjykata Themelore në Gjiilan**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.150/2020

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Agim Ademi.

**Prokuror/e:** Isuf Sadiku

**Të akuzuar:** Salih Kqiku, Valon Shefkiu, Izet Kurteshi, Ganimete Kastrati, kompania private “Zuka Commerc”, Sh.P.K, Muhadin Zuka, Kompania “El-Bau”, Sh.P.K, Fatlum Pireva dhe Suad Pireva.

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”; mashtrimi,

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **343 ditë**)

Prokuroria Themelore në Gjiilan më 24 dhjetor 2020 kishte ngritur aktakuzë ndaj Salih Kqiku, Valon Shefkiu me arsyetimin se më 14 dhjetor 2015, në Gjiilan, me dashje, si persona zyrtar kanë lidhur kontratë me operatorin ekonomik “Zuka Comerc”, për asfaltimin e katër rrugëve të reja në projektin Asfaltimi i rrugës në fshatin “Përlepnice deri te kompleksi Vali Ranch”, me vlerë të kontratës prej 245 mijë e 825 euro e 89 cent. Në aktin akuzues thuhet se në projekt ka qenë e paraparë që trashësia e asfaltit duhet të jetë 11.00 cm, ndërsa është implementuar 8.93

<sup>108</sup> “Jepen fjalët përfundimtare në rastin ku deputeti Kujtim Gashi akuzohet për korrupsion në kohën sa ishte kryesues i asamblesë komunale në Prizren”, Betimi për Drejtësi, 18 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/jepen-fjalet-perfundimtare-ne-rastin-ku-deputeti-kujtim-gashi-akuzohet-per-korrupsion-ne-kohen-sa-ishte-kryesues-i-asamblese-komunale-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>109</sup> “Deputeti Kujtim Gashi lirohet nga akuza për korrupsion”, Betimi për Drejtësi 23 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-kujtim-gashi-lirohet-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 7 mars 2021).

<sup>110</sup> “Apeli vërteton aktgjykimin lirues ndaj ish-Kryetarit të Kuvendit Komunal të Prizrenit Kujtim Gashit”, Betimi për Drejtësi, 22 prill 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-lirues-ndaj-ish-kryetarit-te-kuvendit-komunal-te-prizrenit-kujtim-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 22.04.2021).

cm, që do të thotë më pak se trashësia sipas projektit për 2.07 cm, çka do të thotë se janë shtruar më pak 684.44 ton asfalt e cila sasi do ta mbulonte sasinë e sipërfaqes prej 2.488.89 metra katror, duke i shkaktuar kështu dëm Komunës së Gjilanit në shumë prej 10 mijë e 702 euro e 23 cent.

Sipas aktit akuzues, thuhet se të pandehurit Salih Kqiku dhe Valon Shefkiu kanë tejkaluar kompetencat e tyre zyrtare, ashtu që kanë lidhur aneks kontratë me të cilën është kontraktuar për herë të dytë me operatorin ekonomik “Zuka Comerc”, duke theksuar se aneks kontrata është mbështetur në para, masa dhe parallogari tjetër, nga e cila rezulton se ndërtimi i urës ka përfshirë punët e dheut në vlerë prej 7 mijë e 881 euro e 16 cent si dhe objektin (urën) në vlerë prej 15 mijë e 239 euro e 39 cent, ashtu që për ndërtimin e kësaj ure ka munguar projekti i veçantë dhe se është bazuar një projekt tjetër, mbi bazën e të cilit është ndërtuar ura në Malësinë e Karadakut. Gjithsej kostoja e ndërtimit të urës është 36 mijë e 990 euro e 13 cent, ndërsa kosto faktike e ndërtimit të urës krahasuese është 22 mijë e 171 euro e 15 cent, ashtu që diferenca e kontraktuar dhe e paguar më tepër është 14 mijë e 818 euro e 98 cent.

Në dispozitivin e tretë të aktit akuzues, thuhet se të pandehurit Salih Kqiku, Izet Kurteshi dhe Ganimete Kastrati, më 2, 4, 11 dhe 19 shtator 2014, në Gjilan, në atë mënyrë që anëtarët e komisionit Valon Shefkiu, Arsim Ibrahimimi dhe Bashkim Bunjaku, përkundër vërejtjeve të tyre që i kanë paraqitur për punët e filluara dhe të kryera, kanë kërkuar nga zyra e prokurimit udhëzime dhe përgjigje se si të veprohet më tutje, mirëpo të njëjtit asnjë përgjigje nuk iu kanë dhënë, duke u sqaruar se nuk bartin përgjegjësi për punën e ekzekutuar duke mos prezantuar asnjë dokument për marrjen e masave ndaj punë kryerësit, duke i shkaktuar dëm autoritetit kontraktues, Komunës së Gjilanit në vlerë prej 3 mijë e 496 euro e 33 cent.

Në dispozitivin e katërt të aktakuzës, thuhet se kompania private “Zuka Comerc” SH.P.K me seli në Gjilan, në cilësi të personit juridik, më 15 korrik 2015, me dashje është përgjegjës për veprën e kryer nga personi përgjegjës, ngase është vërtetuar se veprimi i personit juridik ka qenë në kundërshtim me urdhrat, duke kryer punët joprofesionale ndërtimore në kundërshtim me standardet e parapara profesionale, me ç’rast shuma e përgjithshme në përfitimin material me qëllim përvetësimi për veten në dëm të Komunës kap vlerën prej 25 mijë e 521 euro e 21 cent.

Tutje, dispozitivi i pestë përfshin të pandehurin Muhadin Zuka, i cili më 15 korrik 2015 në Gjilan, si person fizik, përfaqësues i autorizuar i personit juridik “Zuka Comerc”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ka paraqitur fakte të rreme duke i fshehur të njëjtat, me qëllim përfitimi nga fondet publike, në rastin konkret Komunës së Gjilanit, ashtu që nuk ka realizuar rrugën sipas para masës dhe parallogarisë së kontratës “Asfaltimi i rrugës në fshatin Përlepnicë deri te kompleksi Vali Ranch”, me ç’rast Komunës së Gjilanit i është shkaktuar dëm në vlerë prej 25 mijë e 521 euro e 21 cent.

Në cilësinë e të pandehurit në dispozitivin e gjashtë të aktit akuzues është kompania private “El-Bau” SH.P.K me seli në Gjilan, pasi pretendohet se më 22 maj 2015 është vërtetuar se veprimi i personit juridik është në kundërshtim me urdhrat e personit juridik dhe se e njëjta është sajuar, duke kryer punët jo profesionale ndërtimore në kundërshtim me standardet e

parapara profesionale, duke mos iu përmbajtur kriterëve të parapara me paramasa dhe parametra, në kundërshtim me ligjin për përgjegjësinë e personave juridik, ka vënë në lajthim institucionet gjegjëse duke mashtruar kështu Komunën e Gjilanit, me çka nuk i është përmbajtur kontratës së paraparë, me ç'rast shuma e përgjithshme në përfitimin material me qëllim përvetësimi arrin vlerën prej 2 mijë e 662 euro e 26 cent.

Në dispozitivin e shtatë të saj, të pandehurit Fatlum dhe Suad Pireva, më 22 maj 2015, në Gjilan, me dashje si persona fizik dhe përfaqësues të autorizuar të personit juridik "El-Bau" SH.P.K, nuk kanë realizuar rrugën sipas paramasës dhe parallogarisë së kontratës "Asfaltimi i rrugëve në lagjen VIII-Motrat Qiriazhi dhe Hasan Tasini, kanalizimi në rrugën Riza Poliqka L-158 m, Malësia krahu nr. 2-L-161 m", ashtu që sipas llogarisë së kontratës, është paraparë që gjatësia e rrugës "Motrat Qiriazhi" të jetë L-857.30 m, kurse sipas raportit të ekspertit të ndërtimitarisë dhe inxhinierit të gjeodezisë, rruga është ndërtuar në gjatësi prej 847 m apo 10 m më pak.

Tutje sipas aktakuzës, trashësia e asfaltit është paraparë të jetë 7 cm, nga ekzaminimet e ekspertit në terren ka rezultuar se nga matjet në 10 pikë në rrugë, shtresa e bito zhavorrit është 6.1 cm që është 0.9 cm, më pak asfalt apo 515.57 metra katror më pak asfalt, ndërsa në rrugën "Riza Poliqka" trashësia e asfaltit është paraparë të jetë 7 cm kurse sipas raportit të ekspertit asfalti është shtruar me trashësi prej 6.38 cm apo 0.62 cm më pak asfalt, të kthyer në metër katror janë 105.84 metra katror më pak asfalt, ashtu që në bazë të mungesës së trashësisë së asfaltit në sipërfaqet e rrugëve, dëmi i shkaktuar Komunës së Gjilanit arrin vlerën prej 2 mijë e 662 euro e 26 cent, me qëllim përvetësimi për vete.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Policia e Kosovës më 21 prill 2020 kishte ushtruar kallëzim penal ndaj të pandehurve të lartcekur, ndërsa aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë nga Prokuroria e Gjilanit më 22 maj 2020.

Ndërsa, aktakuza në fjalë ishte ngritur më 24 dhjetor 2020 nga prokurori Agron Uka.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 27 janar 2021 në Gjykatën Themelore në Gjilan, në kundërshtim me nenin 242.4 të KPPK-së, i cili obligon mbajtjen e kësaj seance brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktit akuzues. Në këtë seancë, të akuzuarit e cekur si më lartë ishin deklaruar të pafajshëm lidhur me akuzat për korrupsion dhe mashtrim.<sup>111</sup> Shqyrtimi kryesor në këtë rast ka filluar më 9 qershor 2021, ku të akuzuarit sërish janë deklaruar të pafajshëm për këtë vepër penale.<sup>112</sup> Aktualisht, në këtë rast gjykata po procedon me

---

<sup>111</sup> "Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për korrupsion dhe mashtrim", Betimi për Drejtësi, 27 janar 2021 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-korrupsion-dhe-mashtrim/>). (Qasur për herë të fundit më 09.03.2021).

<sup>112</sup> "Zyrtarët e komunës së Gjilanit dhe pronarët e kompanive private deklarohen të pafajshëm për keqpërdorim detyre dhe mashtrim", Betimi për Drejtësi, 9 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtaret-e-komunes-se-gjilanit-dhe-pronaret-e-kompanive-private-deklarohen-te-pafajshem-per-keqpërdorim-detyre-dhe-mashtrim/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

administrimin e provave personale, ku në seancën e 4 nëntorit 2021 ka dhënë dëshminë e tij eksperti financiar.<sup>113</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 57,201.01 euro.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion.

#### **24. Rasti Nuro Ismaili**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.208/20

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Raima Elezi

**Prokuror/e:** Mehdi Sefa

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**I akuzuar:** Nuro Ismaili

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **367 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 30 nëntor 2020, nga Prokuroria Themelore e Prizrenit, i pandehuri Nuro Ismaili po akuzohet se nga 18 marsi 2019 e deri më 28 qershor 2019, si person përgjegjës-menaxher i zyrës së prokurimit në Komunën e Dragashit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitoj dobi pasurore për Operatorin Ekonomik “Avni Murtezi” B.I.

Siç thuhet në aktakuzë, i pandehuri Ismaili kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik nr.04/L-042, konkretisht në kundërshtim me nenin 57 paragrafi 1, ashtu që kishte dështuar të konfiskon sigurinë e tenderit të datës 05 maj 2019 në shumë prej 3000 euro për furnizim me dru dhe pelet nga Operatori ekonomik “Avni Murtezi” B.I. i cili nuk kishte arritur të siguronte një vërtetim nga ATK që ka paguar tatimin dhe nga Gjykata Ekonomike që nuk është gjykuar si person juridik, dhe kështu lidhet kontrata me operatorin më të shtrenjtë për 25,680 euro, duke dëmtuar buxhetin e Komunës.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës më 30 nëntor 2020 dhe pas pranimit të lëndës në gjykatë më 2 dhjetor 2020, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar më 29 dhjetor 2020, por kjo seancë kishte dështuar të mbahej në mungesë të të akuzuarit Ismaili.<sup>114</sup> Seanca fillestare kishte dështuar të

---

<sup>113</sup> “Gjykimi për korrupsion, eksperti konstaton se janë bërë pagesa më tepër në shumën afër 15 mijë euro”, Betimi për Drejtësi, 4 nëntor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-korrupsion-eksperti-konstaton-se-jane-bere-pagesa-me-teper-ne-shumen-afer-15-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>114</sup> “Ka dështuar të mbahet seanca fillestare ndaj menaxherit të prokurimit në Komunën e Dragashit, akuzohet për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”. Betimi për Drejtësi. 29 dhjetor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ka-deshtuar-te-mbahet-seanca-fillestare-ndaj-menaxherit-te-prokurimit-ne-komunen-e-dragashit-akuzohet-per-keqperdorim-te-pozites-apo-autorititet-zyrtar/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

mbahej edhe më 28 janar 2021, meqë aktakuza nuk kishte qenë e përkthyer në gjuhën amtare të të pandehurit, për çka, gjykatësja Elezi kishte ndërprerë shqyrtimin gjyqësor.<sup>115</sup>

Shqyrtimi fillestar ka arritur të mbahet 71 ditë pas ngritjes së aktakuzës, dhe atë, më 9 shkurt 2021<sup>116</sup>, në kundërshtim me afatin ligjor prej 30 ditës, të përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale.<sup>117</sup>

Ndërkaq, shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 9 mars 2021<sup>118</sup>, ku i pandehuri Ismaili ka kërkuar hudhjen e aktakuzës ndaj tij. Seanca e fundit në këtë rast, ajo e 26 tetorit, ku pritej të dëshmonte Shaban Shabani, kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së këtij të fundit.<sup>119</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 25,680 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka informacion.

## **25. Rasti Skender Boshtrakaj**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.845/20

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Alltën Murseli

**Prokuror/e:** Dulina Hamiti

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**I akuzuar:** Skender Boshtrakaj

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **456 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 2 shtator 2020, nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, i pandehuri Boshtrakaj, në cilësinë e personit zyrtar – drejtor i Muzeut të Kosovës, me dashje,

---

<sup>115</sup> “Ka dështuar përsëri të mbahet seanca fillestare ndaj menaxherit të prokurimit në Komunën e Dragashit, akuzohet për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”. Betimi për Drejtësi. 28 janar 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ka-deshtuar-perseri-te-mbahet-seanca-fillestare-ndaj-menaxherit-te-prokurimit-ne-komunen-e-dragashit-akuzohet-per-keqperdorim-te-pozites-apo-autorititet-zyrtar/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

<sup>116</sup> “Mbahet seanca fillestare ndaj menaxherit të prokurimit në Komunën e Dragashit, akuzohet për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”. Betimi për Drejtësi. 9 shkurt 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mbahet-seanca-fillestare-ndaj-menaxherit-te-prokurimit-ne-komunen-e-dragashit-akuzohet-per-keqperdorim-te-pozites-apo-autorititet-zyrtar/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

<sup>117</sup> Kodi nr.04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 242.4 (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

<sup>118</sup> “Shefi i zyrës së prokurimit në Dragash kërkon të hudhet poshtë aktakuza që e ngarkon për keqpërdorim të detyrës”. Betimi për Drejtësi. 9 mars 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shefi-i-zyres-se-prokurimit-ne-dragash-kerkon-te-hudhet-poshte-aktakuza-qe-e-ngarkon-per-keqperdorim-te-detyres/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

<sup>119</sup> “Mungon për shkaqe shëndetësore kryetari i Dragashit, dështon seanca ndaj Nuro Ismailit, i cili po akuzohet për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 26 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-per-shkaqe-shendetesore-kryetari-i-dragashit-deshton-seanca-ndaj-nuro-ismailit-i-cili-po-akuzohet-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar, me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i ka tejkaluar kompetencat e tij, me qëllim të mundësimit të përfitimit të dobisë pasurore për kompaninë “TIKI”, SH.P.K, e cila gjendet në Prishtinë.

Siç thuhet në aktakuzë, i pandehuri kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, duke anashkaluar të gjitha procedurat e prokurimit, ku me kompaninë e lartcekur ka lidhur kontrata për furnizim në shumë prej 208,894.00 euro, me datën 2 shkurt 2018, ka nënshkruar kontratën për furnizim në shumë prej 39,706.00 euro dhe me datën 23 prill 2018, ka nënshkruar kontratën për furnizim në shumë prej 20,840.00 euro, me vlerë totale prej 269,444.00 euro, me ç'rast buxhetit të dëmtuarës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ka shkaktuar dëm në vlerën e lartcekur.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës më 2 shtator 2020, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar më 26 tetor 2020, por për shkak të mos pajisjes së mbrojtjes me shkresa të lëndës, kjo seancë kishte dështuar të mbahej.<sup>120</sup>

Shqyrtimi fillestar ka arritur të mbahet 69 ditë pas ngritjes së aktakuzës, dhe atë, më 10 nëntor 2020, ku i pandehuri Boshtrakaj nuk e ka pranuar fajësinë.<sup>121</sup>

Ndryshe, Gjykata Themelore në Prishtinë me vendimin e saj të nxjerrë më 9 dhjetor 2020 kishte refuzuar kërkesat për hedhje të aktit akuzues dhe kundërshtim të provave të ushtruara nga mbrojtja e të akuzuarit. Ky vendim i nxjerrë nga shkalla e parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, më 21 dhjetor 2020, duke konfirmuar kështu këtë aktakuzë.

Për arsye subjektive, ky gjykim ka dështuar të mbahet më 15 shkurt<sup>122</sup>, ndërsa shqyrtimi gjyqësor ndaj të akuzuarit për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, Skender Boshtrakaj

---

<sup>120</sup> “Mbrojtja pa shkresa të lëndës, shtyhet gjykimi për keqpërdorim pozite ndaj ish-drejtorit të Muzeut të Kosovës”. Betimi për Drejtësi. 26 tetor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojttja-pa-shkresa-te-lendes-shtyhet-gjykimi-per-keqperdorim-pozite-ndaj-ish-drejtorit-te-muzeut-te-kosoves/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

<sup>121</sup> “Ish-drejtori i Muzeut të Kosovës deklarohet i pafajshëm për akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 10 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-muzeut-te-kosoves-deklarohet-i-pafajshem-per-akuza-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

<sup>122</sup> “Përfaqësuesja e MKRS-së pa autorizim për përfaqësim, dështon gjykimi ndaj ish-drejtorit të Muzeut të Kosovës”. Betimi për Drejtësi. 15 shkurt 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/perfaqesuesja-e-mkrs-se-pa-autorizim-per-perfaqesim-desh-ton-gjykimi-ndaj-ish-drejtorit-te-muzeut-te-kosoves/>). (Qasur për herë të fundit më 9 mars 2021)

ka nisur më 2 mars 2021. Në seancat e mbajtura më 4 qershor<sup>123</sup> dhe 23 shtator 2021<sup>124</sup>, gjykata kishte dëgjuar disa dëshmitarë dhe ekspertin e prokurimit.

**Dëmi i pretenduar:** 269,444.00 euro

**Sekuestrimit dhe Konfiskimi:** Nuk ka informacion.

## **26. Rasti Dhurata Hoxha etj.**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PS.nr.31/21

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Arben Hoti

**Prokuror/e:** Dren Paca

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

**Të akuzuar:** Dhurata Hoxha, Fitim Mustafa, Demush Shasha, Kushtrim Cukaj dhe Nuhi Osmani

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **148 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 7 korrik 2021, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Dhurata Hoxha, Kushtrim Cukaj dhe Fitim Mustafa po akuzohen se në vazhdimësi kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të KPRK-së. Kurse, Demush Shasha dhe Nuhi Osmani po akuzohen se kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, paragrafi 2 të KPRK-së.

Në aktakuzë thuhet se Hoxha në cilësinë e ministres së MIE-së, kishe tejkaluar kompetencat e saj me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore personit tjetër, respektivisht operatorëve ekonomik “Majorelle PR & Events” dhe “Madison Strategies LLC”.

Siç thuhet në aktin akuzues, Hoxha më 11 maj 2018 kishte kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MIE-së, Demush Shasha nisjen e procedurave të prokurimit për aktivitetin e prokurimit “Shërbime të konsulencës për nevojat e MIE-së”, duke përcaktuar procedurën që duhej aplikuar dhe emrin e “Majorelle PR & Events” me të cilin duhej lidhur kontrata. Sipas aktakuzës, e njëjta e bëri këtë edhe pse e kishte ditur se sipas ligjit këto nuk ishin në kompetencë të ministrit, me ç’rast ata i kanë mundësuar këtij operatori lidhjen e kontratës në vlerë 180 mijë euro dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore në këtë vlerë. Më pas, në aktakuzë thuhet se më 21

---

<sup>123</sup> “Dëshmitarët nuk e dinë pse nuk ishin iniciuar procedurat e prokurimit në rastin ku ish-drejtori i Muzeut po akuzohet për mbi 200 mijë euro dëm (Video)”, Betimi për Drejtësi, 4 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitaret-nuk-e-dine-pse-nuk-ishin-iniciuar-procedurat-e-prokurimit-ne-rastin-ku-ish-drejtori-i-muzeut-po-akuzohet-per-mbi-200-mije-euro-dem-video/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>124</sup> “Eksperti thotë se ish-drejtori i Muzeut, i akuzuar për korrupsion, nuk veproi sipas ligjit të prokurimit”, Betimi për Drejtësi, 23 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/eksperti-thote-se-ish-drejtori-i-muzeut-i-akuzuar-per-korrupsion-nuk-veproi-sipas-ligjit-te-prokurimit/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

shkurt 2019, Hoxha kishte kërkuar nga UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MIE-së, Kushtrim Cukaj vazhdimin e kontratës së lartcekur në bazë të procedurës së njëjtë, me këtë rast iaa ka mundësuar “Majorelle PR & Events” që të vazhdojë kontratën në vlerë prej 168 mijë euro dhe përfitimin e dobisë pasurore në këtë vlerë.

Po ashtu, në aktakuzë thuhet se Hoxha më 24 prill 2019, kishte kërkuar nga i akuzuari Cukaj që për aktivitetin e lartcekur të nis procedurat e prokurimit, duke përcaktuar procedurat që duhej aplikuar dhe emrin e operatorit ekonomik, “Madison Strategies LLC”, ku më 17 qershor 2019 është lidhur kontrata me këtë kompani në vlerë prej 152 mijë e 232 euro.

Mustafa akuzohet se në cilësinë e drejtorit të Divizionit të Prokurimit në MIE, i ishte drejtuar me kërkesë të akuzuarve Cakaj dhe Shasha, me anë të së cilës kishte kërkuar që kërkesat e parashtruara nga Hoxha për miratimin apo vazhdimin e këtyre kontratave të miratoheshin edhe pse i njëjti e dinte se janë në kundërshtim me ligjin.

Demush Shasha, në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm të MIE-së dhe Kushtrim Cukaj e Nuhi Osmani në cilësinë e UD-ve të kësaj pozite akuzohen nga PSRK-ja, se kishin aprovuar kërkesat e parashtruara nga i akuzuari Mustafa dhe kishin lejuar zbatimin e procedurës së prokurimit edhe pse e dinin se kërkesa e parashtruar ishte në kundërshtim me ligj.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Lajmi për ngritjen e aktakuzës ndaj ish-ministres së Integritimeve Europiane, Dhurata Hoxha, ish-sekretarit Kushtrim Cukaj dhe tre të tjerëve Fitim Mustafa, Demush Shasha dhe Nuhi Osmani, për vepra të korrupsionit, u bë i ditur përmes një komunikate për media të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Pas ngritjes së aktakuzës më 7 korrik 2021<sup>125</sup>, shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale ishte mbajtur më 1 shtator të këtij viti, apo 57 ditë pas ushtrimit të aktit akuzues në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Ndërkaq, Gjykata Themelore në Prishtinë me vendimin e saj të nxjerrë në tetor kishte refuzuar kërkesat për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave<sup>126</sup>.

**Dëmi i pretenduar:** 500,232.00 Euro

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka asnjë kërkesë.

---

<sup>125</sup> “Ish-ministrja Hoxha, ish-sekretari i Integritimeve Europiane dhe tre të tjerë akuzohen për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 7 korrik 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ministrja-hoxha-ish-sekretari-i-integritimeve-europiane-dhe-tre-te-tjere-akuzohen-per-korrupsion/>). (Qasar për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>126</sup> “Konfirmohet aktakuza për korrupsion ndaj ish-ministres Dhurata Hoxha dhe të tjerëve”, Betimi për Drejtësi, 27 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-per-korrupsion-ndaj-ish-ministres-dhurata-hoxha-dhe-te-tjereve/>). (Qasar për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

## **27. Rasti Lavdim Krasniqi etj.**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.484/21

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Alban Ajvazi

**Prokuror/e:** Zejnullah Gashi

**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Ushtrimi i ndikimit” etj.

**Të akuzuar:** Lavdim Krasniqi, Ardian Krasniqi, Marigona Berisha dhe Flora Doda

**Faza e procedurës:** Në proces

(Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **111 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 13 gusht 2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Lavdim Krasniqi në cilësinë e drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial (KPK) dhe Ardian Krasniqi në cilësinë e shoferit të tij personal akuzohen se nga janari i vitit 2018 e deri në fund të vitit 2019, në bashkëkryerje, në vazhdimësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, kanë kërkuar dhe pranuar të holla dhe dhurata për vete dhe për tjetrin nga Bashkim Mulolli.

Siç thuhet në aktakuzë, përmes të akuzuarit Ardian Krasniqi disa herë të njëjtit kanë pranuar të holla, duke arritur shifrën prej 40 mijë euro, si dhe dhuratë, një veturë në vlerë prej 25 mijë euro, për asistenten e të akuzuarit Lavdim Krasniqi, të akuzuarën Marigonë Berisha. E që këto përfitime sipas aktakuzës, janë pranuar nga të lartcekurit duke premtuar se do të ushtrorjnë ndikimin e tyre mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, në Kolegjin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për uljen e dënimit, sipas Kërkesës për Mbrojtje të ligjshmërisë, për të dënuarin Bashkim Mulolli, si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit për te njëjtin.

Me këto veprime prokuroria i ngarkon ata se në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, kanë kryer veprën penale “ushtrimi i ndikimit”.

Tutje, prokuroria i ngarkon Marigonë Berishën dhe Ardian Krasniqi se veç e veç kanë kryer veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Sipas aktit akuzues, e akuzuara Berisha më 16 dhjetor 2019 kishte falsifikuar dokumentin më të cilin ajo pretendonte se në zyrën e noterit Safadin Blakaj i ka paguar Bashkim Mulollit shumën prej 8 mijë e 400 euro dhe dënimet kundërvajtëse në vlerë 600 euro, e që më pas është konstatuar se nënshkrimi i Mulollit në këtë dokument nuk është i tij.

Ndërsa, Ardian Krasniqi po akuzohet se më 19 gusht 2020 kishte falsifikuar testin e Covidit me të dhënat e Bashkim Mulollit, se kinse ky i fundit kishte rezultuar pozitiv, më të cilin test do t’i mundësohej të njëjtit shtyrja e ekzekutimit të dënimit.

Tutje, aktakuza Lavdim dhe Ardian Krasniqin i ngarkon se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Në aktin akuzues thuhet se dy të akuzuarit Krasniqi, për shkak të obligimeve që kishin ndaj Bashkim Mulollit kishin keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, ashtu që kishin penguar arrestimin e Albi Mulollit i cili ishte i dyshuarit për kryerjen e vrasjes se rënde në tentative, duke ia

mundësuar këtij të fundit arratisjen nga Kosova për në Shqipëri më veturën zyrtare të akuzuarit Lavdim Krasniqi.

Gjithnjë sipas aktakuzës, Lavdim Krasniqi ngarkohet edhe për “keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar” në bashkëkryerje me Flora Dodën, pasi që në cilësinë e personave përgjegjës kishin shkelur procedurat dhe rregullat e prokurimit publik. Prokuroria pretendon se në muajin shkurt të vitit 2021, të akuzuarit Krasniqi dhe Doda, kanë predikuar fituesin dhe kanë diskriminuar operatorët e tjerë ekonomik, duke favorizuar operatorët ekonomik (OE) “Graniti Shpk” dhe “Solos Studios“ si dhe përkundër vendimit të Sekretariatit të KPK-së, në fillim të vitit kalendarik, i cili në kuadër planifikimit të prokurimit kontrata e KPK-së ka qenë e lidhur me OE, “Mobeland Shpk”. Të njëjtit kanë porositur dhe pranuar mobile në vlerë prej 9 mijë e 480 euro, e që pas disa ditësh është lidhur kontrata dhe janë zhvilluar procedura fiktive në kundërshtim me ligjin.

Gjithashtu, Lavdim Krasniqi akuzohet edhe për mos deklarim të pasurisë, pasi që sipas prokurorisë, i akuzuari Krasniqi më 31 mars 2020 në deklaratën për deklarim të pasurisë nuk ka përfshirë shumën e të hollave prej 40 mijë euro, të cilat i ka pranuar nga Fitim Arifi për shitjen e banesës, si dhe të hollat në shumën prej 10 mijë euro, të cilat ia ka dhënë mikut të tij Alush Zariqi, në emër të blerjes së dy banesave.

Krejt në fund prokuroria e ngarkon Marigonë Berishën edhe për veprën penale ”Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale”, sepse më 16 dhjetor 2019 e ka pranuar një veturë në vlerë prej 25 mijë euro nga Bashkim Mulolli edhe pse ka qenë e vetëdijshme se kjo veturë ishte fituar më vepër penale të shkaktuar nga Lavdim dhe Ardian Krasniqi

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës më 13 gusht 2021, shqyrtimi fillestar ndaj ish-drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Lavdim Krasniqi dhe tre të akuzuarve të tjerë, Ardian Krasniqi, Marigonë Berisha dhe Flora Doda ishte mbajtur më 6 tetor 2021, apo 55 ditë pas ushtrimit të aktit akuzues.<sup>127</sup>

Kjo lëndë i ishte ndarë në punë fillimisht gjykatësit Avni Syla, mirëpo ky i fundit kishte kërkuar nga kryetarja e gjykatës përjashtimin për shkak të lidhjeve farefisnore me mbrojtësin e njërit nga të akuzuarit e përfshirë në këtë rast.

Pas deklarimit lidhur me fajësinë, gjykatësi i rastit ka njoftuar të akuzuarit lidhur me mundësinë e paraqitjes së kërkesave për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

**Dëmi i pretenduar:** 74,480 Euro

---

<sup>127</sup> “Lavdim Krasniqi dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për korrupsion e vepra tjera”, Betimi për Drejtësi, 6 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lavdim-krasniqi-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-korrupsion-e-vepra-tjera/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Vetura në vlerë 25,000.00 Euro

## **28. Rasti Mefail Vogliqi**

**Gjykata Themelore në Gjilan**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.125/2021

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Aziz Shaqiri

**Prokuror/e:** Shaban Spahiu

**Vepra penale:** “Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurorim publik”

**Të akuzuar:** Mefail Vogliqi

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të parë.

(Nga ngritja e aktakuzës e deri në Aktgjykimin e shkallës së parë kanë kaluar **25 ditë**)

Sipas aktakuzës së ngritur më 28 qershor 2021, nga Prokuroria Themelore në Gjilan, Mefail Vogliqi po akuzohet se në cilësinë e pronarit të operatorit ekonomik Gërlica-Company-SHPK, me seli në fshatin Babush, Komuna e Ferizajit, me vetëdije ka shkelur rregullat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Sipas akuzës, me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe ndikimit tek autoritet kontraktues, ka paraqitur dokumentacion të rremë, përkatësisht pa autorizimin e Arben Kastratit-Inxhinier i Komunikacionit dhe të Agim Durgutit Inxhinier i Ndërtimtarisë, me të cilët kompania e tij nuk ka pas kurrfarë parakontrate apo kontratë të punës, ka përdorur të dhënat e tyre personale, përkatësisht dokumentet mbi përgatitjen e tyre profesionale si diplomat e tyre, për të plotësuar kriterin e dosjes së tenderit të shpallur nga komuna e Vitisë me datë 1 tetor 202, lidhur me projektin “Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaqanik, faza e dytë”.

Për këtë, ai akuzohet se ka kryer veprën penale “Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurorim publik”, nga neni 415, paragrafi 1 të KPRK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte tentuar të mbahej fillimisht më 14 korrik, e më pas edhe më 15 korrik, por për shkaqe të ndryshme ligjore ishte pamundësuar zhvillimi i atyre seancave.

Seanca fillestare në këtë rast ishte mbajtur më 22 korrik 2021, apo 25 ditë duke llogaritur ditën e ushtrimit të aktakuzës në gjykatë. Në këtë seancë i akuzuari Vogliqi ishte deklaruar fajtor për veprën penale që i ngarkohej. Si pasojë, Gjykata Themelore në Gjilan e ka dënuar Vogliqin me 6 muaj burgim dhe 1,500 euro, por me pëlqimin e të njëjtit, dënimi me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3,600 euro.<sup>128</sup>

---

<sup>128</sup> “5 mijë e 100 euro gjobë ndaj të akuzuarit që pranoi se ka paraqitur dokumentacion të rremë për të plotësuar kriteret për fitim të tenderit”, Betimi për Drejtësi, 22 korrik 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/5->

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka.

## **29. Rasti Naim Sallahu**

**Gjykata Themelore në Gjilan**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.144/2021

**Kryetar/e i Trupit Gjykues:** Naser Maliqi

**Prokuror/e:** Agron Uka

**Vepra penale:** “Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurorim publik”

**I akuzuar:** Naim Sallahu

**Faza e procedurës:** Hudhje e aktakuzës.

(Nga ngritja e aktakuzës e deri në hudhjen e aktakuzës kanë kaluar **70 ditë**)

Sipas aktakuzës së ushtruar më 25 gusht 2021, i pandehuri Naim Sallahu në cilësinë e pronarit të operatorit ekonomik “Sallahu” SHPK, më seli në fshatin Bicec në Kaçanik, me vetëdije i ka shkelur rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënie të kontratës së prokurimit publik.

Në aktakuzë thuhet se gjatë aktivitetit të prokurimit publik të shpallur nga Komuna e Vitisë, ndërtimi i rrugës Viti-Kërbiq-Kaçanik, “Deklaratë nën Betim” ka aplikuar duke ndërmarrë veprim të kundërligjshëm, më qëllim të ndikojë në vendimin e prokurimit publik të shpallur nga Komuna e Vitisë, në atë mënyrë që nuk ka paraqitur para autoritetit kontaktues aktgjykim dënues nga Gjykata Themelore në Prishtinë ku e ka pasur obligim sipas Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria Themelore në Gjilan, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 29 shtator, apo 36 ditë pas dorëzimit të kësaj aktakuze në gjykatë. Gjatë kësaj seance, i akuzuari për keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik, Naim Sallahu ishte deklaruar i pafajshëm për këtë veprë penale.<sup>129</sup>

Gjykata Themelore në Gjilan me vendimin e saj të nxjerrë më 2 nëntor 2021 ka aprovuar kërkesën për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarit Sallahu dhe ka pushuar këtë procedurë penale. Gjykata Themelore në Gjilan vendimin për hudhjen e kësaj aktakuze e ka arsyetuar me faktin se në veprimet e të akuzuarit

---

[mije-e-100-euro-gjobe-ndaj-te-akuzurit-qe-pranoi-se-ka-paraqitur-dokumentacion-te-rreme-per-te-plotesuar-kriteret-per-fitim-te-tenderit/](#). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>129</sup> “Deklarohet i pafajshëm se nuk e paraqiti para autoritetit kontraktues aktgjykimin dënues”, Betimi për Drejtësi, 29 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-se-nuk-e-paraqiti-para-autorititetit-kontraktues-aktgjykimin-denues/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

Sallahu nuk manifestohen elementet e veprës penale të keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik.<sup>130</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Nuk ka.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka.

### **30. Rasti Tahir Sopa**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.450/21

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Naser Foniqi

**Prokuror/e:** Dulina Hamiti

**Vepra penale:** “Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik”

**I akuzuar:** Tahir Sopa

**Faza e procedurës:** Në proces.

(Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **128 ditë**)

Sipas aktakuzës së përpiluar me 27 korrik 2021, Tahir Sopa me 12 dhjetor 2019, në cilësinë e përfaqësuesit të firmave “NBT ING SHPK” dhe “NPN Bajramaj”, po dyshohet se kishte prezantuar dokument të falsifikuar për të fituar tenderin në vlerë mbi 800 mijë euro, për rinovimin e objektit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Në aktakuzë thuhet se të dyja këto firma, përfaqësuesi i të cilave ka qenë i akuzuari Sopa kishin aplikuar në tenderin e shpallur nga Autoriteti Kontraktues Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe se njëra nga kushtet për përmbushjen e kontratës ka qenë një deklaratë që vërteton disponueshmërinë e 200,000 euro në llogarinë bankare, si vlerë për të siguruar tenderin.

Sipas aktakuzës, i akuzuari Sopa kishte prezantuar letërpërkrahje të lëshuar kinse nga NLB Bankë për përkrahjen e kompanisë “NBT ING SHPK” për garancion bankar në vlerë 200,000 euro, e cila letërpërkrahje ka rezultuar si e falsifikuar.

Për këto veprime, Sopa po dyshohet se me vetëdije kishte shkelur rregullat e prokurorimit publik duke paraqitur dokumentacion të rrejshëm, me anë të cilit është shpallur fitues i tenderit në vlerë 811,372.13 euro, me c’rast i kishte shkaktar dëm buxhetit të KPK-së.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

---

<sup>130</sup> “Gjykata e hedh poshtë aktakuzën për keqpërdorim dhe mashtrim në prokurimin publik në Gjilan”, Betimi për Drejtësi, 17 nëntor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-hedh-poshte-aktakuzen-per-keqpërdorim-dhe-mashtrim-ne-prokurimin-publik-ne-gjilan/>). (Qasur për herë të fundit më 17 nëntor 2021).

Pas ngritjes së aktakuzës më 27 korrik 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë më 3 gusht të këtij viti kishte mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ndaj të akuzuarit për keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik, Tahir Sopa.

Në këtë seancë Sopa ishte deklaruar i pafajshëm për këtë vepër penale. Seanca e shqyrtimit të dytë në këtë rast ishte mbajtur më 8 shtator, me ç'rast Sopa si përfaqësuesi i firmave NBT ING SHPK” dhe “NPN Bajramaj” e kishte kundërshtuar këtë aktakuzë.<sup>131</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 811,372.13 Euro.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion.

### **31. Rasti Vllaznim Mazreku**

**Gjykata Themelore në Gjakovë**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.118/21

**Kryetar/e i Trupit Gjykses:** Nikollë Komani

**Prokuror/e:** Ali Uka

**Vepra penale:** “Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik”

**I akuzuar:** Vllaznim Mazreku

**Faza e procedurës:** Aktgjykim në shkallë të parë.

(Nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e shkallës së parë kanë kaluar **73 ditë**)

Në aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë të ushtruar më 31 gusht 2021 thuhet se Vllaznim Mazreku, në periudhën kohore gjatë muajit nëntor të vitit 2020, në cilësi të drejtorit të kompanisë “Flamuri Sh.p.k”, me seli në Malishevë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm me vetëdije ka shkelur rregullat e prokurimit gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit, duke paraqitur dokumentacione të rreme, me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik të ndikimit në vendimin e autoritetit kontraktues, Komunës së Malishevës.

Tutje sipas aktakuzës, ai këtë e ka bërë në atë mënyrë që në tenderin “Asfaltimi i rrugëve të fshatrave të komunës së Malishevës, Loti-1, Bellanicë, Ngucat, Balincë, Bubel dhe Loti-2 Carrallukë, Turjakë dhe Burim”, pa dijeni dhe pa autorizimin e tij ka përdorur dokumentacionin e Arbnor Hetemit, inxhinier i hidroteknikës, si kontratë mbi projektin, listë e stafit profesional, CV, kopjen e diplomës master, autorizimin për këtë projekt, edhe pse nuk ishte pjesë e kompanisë tenderuese “Flamuri Sh.p.K”.

---

<sup>131</sup> “Kundërshton aktakuzën për falsifikim në tenderin e mbi 800 mijë eurove për rinovimin e objektit të Prokurorisë”, Betimi për Drejtësi, 8 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kundershton-aktakuzen-per-falsifikim-ne-tenderin-e-mbi-800-mije-eurove-per-rinovimin-e-objektit-te-prokurorise/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

## **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Pas ngritjes së aktakuzës më 31 gusht 2021, Gjykata Themelore në Gjakovë më 23 shtator kishte caktuar seancën, i akuzuari për keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik, Vllaznim Mazreku, përmes mbrojtësit të tij, avokatit Bajram Kryeziu, ka kërkuar që t'i mundësohet negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjakovë.<sup>132</sup>

Më 10 nëntor 2021 Gjykata Themelore në Gjakovë kishte aprovuar marrëveshjen për pranim fajësie të lidhur në mes të të akuzuarit për mashtrim në prokurim publik, Vllaznim Mazreku dhe Prokurorisë Themelore në Gjakovë.<sup>133</sup> Një ditë më pas, më 11 nëntor kjo gjykatë e kishte shpallur fajtorë Mazrekun për këtë vepër penale dhe ndaj tij kishte shqiptuar tre mijë euro gjobë. Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Nikollë Komani, i akuzuari Mazreku fillimisht është dënuar me 6 muaj burgim dhe 500 euro gjobë, por që edhe dënimi me burgim i është zëvendësuar me gjobë në shumën prej 2 mijë e 500 euro. daj të akuzuarit është shqiptuar edhe dënimi plotësues, ashtu që i ndalohet kompanisë “Flamuri Sh.p.k”, që të marrë pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik, me pronar të akuzuarin Mazreku, në afat prej 1 viti.<sup>134</sup>

**Dëmi i pretenduar:** Asnjë.

**Konfiskimi dhe sekuestrimi:** Nuk ka informacion.

---

<sup>132</sup> “I akuzuari për mashtrim në prokurim publik kërkon që të hyjë në negocim të marrëveshjes për pranim fajësie”, Betimi për Drejtësi, 23 shtator 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-mashtrim-ne-prokurim-publik-kerkon-qe-te-hyje-ne-negocim-te-marreveshjes-per-pranim-fajesie/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>133</sup> “Biznesmeni i akuzuar për mashtrim në prokurim publik arrin marrëveshje për pranim të fajësisë”, Betimi për Drejtësi, 10 nëntor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/biznesmeni-i-akuzuar-per-mashtrim-ne-prokurim-publik-arrin-marreveshje-per-pranim-te-fajesise/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).

<sup>134</sup> “Dënohet me 3 mijë euro gjobë biznesmeni i akuzuar për mashtrim në prokurim publik”, Betimi për Drejtësi, 11 nëntor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-3-mije-euro-gjobe-biznesmeni-i-akuzuar-per-mashtrim-ne-prokurim-publik/>). (Qasur për herë të fundit më 16 nëntor 2021).